

REPORTAZH

Në Korab, Olimpin e ShqipërisëNga **ENVER ROBELLI**

— Faqe 7

VËZHGIM

Ka shpresë për Lurën!

Natyrë po e merr veten ngadalë dhe nëse do të ndihmohet nga njeriu, ritmi i ringjalljes së natyrës në Lurë do të përshpejtohet.

Nga **ABDULLA DIKU**

— Faqe 6

DEBAT

Skavica, tradhti ndaj interesave të Dibrës dhe kombitNga **KADRI DAUTI**

— Faqe 8-9

PROFIL

Profesor Qazim Xhelili, një jetë në shërbim të arsimitNga **JONA OSMANI**

— Faqe 25

KALENDAR / RRUGA E ARBËRIT PËRMES PREMTIMEVE

Rruga e Arbrit, nuk ka transparencë për afatet dhe standardet e ndërtimit

Ministrja e Infrastruktursë: Në tunelin e madh kemi një ecuri hapje 3100 metra, të cilat janë të gjitha të armatuara, pra, kemi edhe 700 metra final që do të dorëzohet vepra. Te tuneli i emergjencave, deri më sot (22 korrik), janë hapur 3600 metra, pra, ka dhe 200 metra për t'u përfunduar.

Kur kryeministri Edi Rama prezantonte programin e qeverisë së tij në Parlament më 11 shtator 2013, duke folur për infrastrukturën, tha se “do ta nisim nga Rruga e Arbrit si prioritet...” Nëntë vjet më vonë, Edi Rama nuk flet më për Rugën e Arbrit. Nga prioriteti kryesor i infrastrukturës duket se tashmë është kthyer në një çështje të dorës së dytë në infrastrukturë. Segmente rugore që kanë nisur njëkohësisht apo më pas ose kanë përfunduar, ose janë në përfundim.

Në vend të kryeministrit tani është ministrja e Infrastruktursë dhe Energjisë Belinda Balliku, njëkohësisht edhe e deleguara e Partisë Socialiste në Qarkun e Dibrës, e cila ripërsërit takim pas takimi se vonesat në Rugën e Arbrit kanë ardhur për “shkak të problemeve gjeologjike”. Por ministrja nuk ka dhënë asnjë shpjegim se pse segmentet e tjera të këtij aksi nuk kanë mbaruar apo aq më keq, në segmentin e Planit të Bardhë nuk është punuar asnjë ditë që nga nisja zyrtarisht e punimeve. Ministrja nuk jep shpjegime se pse akset e tjera, si ai nga Ura e Brarit deri në Qafë të Tujanit apo segmenti nga Ura e Vashës deri në Qafë të Buallit nuk janë akoma funksionale.

Sot nuk ka asnjë shpjegim nga askush, as nga kompania dhe as nga qeveria se pse segmentet e kësaj rruge ku është lejuar qarkullimi nuk përmbushin asnjë standard sigurie, përveçse një vije të verdhë të pandërprerë, që më shumë se element i sigurisë në rrugë, është një pretekst për shkeljet e rregullave të qarkullimit dhe vendosjen e gjobave me program. Në rrugë aktualisht është e vështirë të qarkullosh, pasi sinjalistika për qarkullimin e sigurt mungon dhe gropat e hapura vazhdojnë të kthehen në një problem për drejtuesit e makinave. By-passi është kthyer në një stres të përditshëm për udhëtarët dhe herë pas here ka bllokime të trafikut për shkak të problemeve të rrugës dhe vështirësisë së manovrimit të mjeteve.

“Megjithatë është deklaruar disa herë për problematikat në formacionet gjeologjike të shfaqura, unë së bashku me disa kolegë të tjerë mbetemi të gatshëm të ndihmojmë në zgjidhjen e problemeve të hasura”, thotë për gazetën profesor Bashkim Lleshi. Ai është i sigurt se problematikat kanë ndodhur më shumë për shkak të rrethanave që nuk kanë të bëjnë me gjeologjinë e terrenit.

“Rreth 80% e gjatësisë së tunelit të Murrizit është e ndërtuar nga shkëmbinjtë gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinjtë mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor, Greqia, ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë-Selanik”, thotë profesor Lleshi.

(Lexo në faqen 2,3,4,5)

Rrugëtimi i një vajze dibrane nga Okshtuni, një fshat i thellë i Dibrës, deri në Mynih, pedanën e Kampionatit Europian të atletikës, si kampione dhe medaliste e artë.

Luiza Gega - flutura kuqezi

Nga **DEFRIM METHASANI**

— Faqe 17



Luiza Gega po çudit botën me shpejtësinë e saj

Luiza Gega: “Përgjatë garës hidhja sytë nga spektatorët në kërkim të flamurit tonë kombëtar, për të ditur nëse në këtë stadium të madh, ka dikush që e njeh dhe e mbështet atë”. Dhe një flamur ishte aty, për ti dhënë kurajo atletës sonë, e cila e ktheu shumëfish gëzimin te shqiptarët anëmbanë botës.

EKSKLUZIVE / Nga **ENELA SHEHU MARKJA**, Mynih

— Faqe 16

NË BRENDESI:

- Pse duhet të krijohet **Bashkia e Kalabardhës?**
- Bilanc i qeverisjes vendore: **Arritjet dhe sfidat** e 4 bashkive të qarkut të Dibrës
- **Maqellara**, perlë e natyrës shqiptare
- **Valle dibrane**
- **Petrit Bajra**, mësuesi i Dibrës së Madhe
- **Oda e Dibrës** - copëza nga krijimtaria e popullit
- **Skënderbeu** mitik
- Marketing me dhembjen?!
- Dasma
- Urrejtja - Tregim nga **Ramiz Gjini**
- “Pëllumbat nuk janë të qetë”, libri i ri poetik i **Naim Berishës**
- Poetja e drithërimave, ngjyrave dhe lirikave të shpirtit
- Mulla **Tafik Gjorllaku**
- **Rexha Rexha**, një jetë me stetoskop dhe zemër në dorë...
- Dy fjalë për **Nehat Dacin**, mikun tonë të hershëm dhe të vyer
- Kafja e fundit



Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Gazetë e pavarur. Nr. 7-8 (191-192).
Korrik - Gusht 2022
Gazeta doli nga shtypi, 24 gusht 2022.
Gjendet në treg deri në fund muajit shtator 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.
Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Abdulla DIKU
Enver ROBELLI
Kadri DAUTI
Xhafer MARTINI
Ramiz GJINI
Defrim METHASANI
Enela SHEHU MARKJA
Mikaela MINGA
Halil RAMA
Ismen BRIKA
Dukagjin HATA
Besnik LAMI
Jona DEMIRI
Fatbardh RUSTEMI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në goftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.
Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com.
Falënderojmë z. AGIM DEVA për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arbrit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. + 355 4 22 33 283
+ 355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Rruga e Arbrit, nuk ka

Nga BUJAR KAROSHI

Kur kryeministri Edi Rama prezantonte programin e qeverisë së tij në Parlament më 11 shtator 2013, duke folur për infrastrukturën, tha se “do ta nisim nga Rruga e Arbrit si prioritet...” Ky ishte premtimi më serioz pas zgjedhjeve, ndërsa gjatë fushatës elektorale u kishte thënë dibranëve se “Rruga e Arbrit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm, jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjesht, po garanton një zhvillim për një territor të tërë, që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike, që do ta çojmë përpara me shumë vullnet”.

Nëntë vjet më vonë, sidomos gjatë këtij viti, Edi Rama nuk flet më për Rugën e Arbrit. Nga prioriteti kryesor i infrastrukturës duket se tashmë është kthyer në një çështje të dorës së dytë në infrastrukturë. Segmente rrugore që kanë nisur njëkohësisht apo më pas ose kanë përfunduar, ose janë në përfundim.

Në vend të kryeministrit tani është ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balliku, njëkohësisht edhe e deleguara e Partisë Socialiste në Qarkun e Dibrës, e cila ripërsërit takim pas takimi se vonesat në Rugën e Arbrit kanë ardhur për “shkak të problemeve gjeologjike”.

Fjalët e Ballukut janë përsëritur disa herë vetëm këto dy muajt e fundit, duke filluar 7 korriku. Por ministria, e cila kohët e fundit ka filluar të theksojë se është edhe “mbesë Dibre” nuk ka dhënë asnjë shpjegim se pse segmentet e tjera të këtij aksi nuk kanë mbaruar apo aq më keq, në segmentin e Planit të Bardhë nuk është punuar asnjë ditë që nga nisja zyrtarisht e punimeve. Ministria nuk jep shpjegime se pse akset e tjera, si ai nga Ura e Brarit deri në Qafë të Tujanit apo segmenti nga Ura e Vashës deri në Qafë të Buallit nuk janë akoma funksionale.

Persona që kanë kontakte me kompaninë thonë për gazetën se “këto segmente, pra, ajo përgjatë Planit të Bardhë apo luginës së lumit të Tiranës, nuk janë përfshirë në kontratën e koncesionit”, gjë e cila është e pavërtetë. Shtojca 10 e kontratës së Koncesionit/PPP të Rugës së Arbrit të firmosur mes qeverisë shqiptare dhe kompanisë në fillim të vitit 2018, këto dy segmente i njeh si “Segmenti 2 dhe 4”, përkatësisht 5.46 km dhe 9.715 km. Vetëm segmenti Bulqizë - Ura e Çerenecit, i gjatë 20.12 km, konsiderohet i përfunduar në vitet 2009/2011 dhe nuk është i përfshirë në kontratë.

Sot nuk ka asnjë shpjegim nga askush, as nga kompania dhe as nga qeveria se pse segmentet e kësaj rruge ku është lejuar qarkullimi nuk përmbushin asnjë standard sigurie, përveçse një vije të verdhë të pandërprerë, që më shumë se element i sigurisë në rrugë, është një pretekst për shkeljet e rregullave të qarkullimit dhe vendosjen e gjobave me program. Në rrugë aktualisht është e vështirë të qarkullosh, pasi sinjalistika për qarkullimin e sigurt mungon dhe gropat e hapura vazhdojnë të kthehen në një problem për drejtuesit e makinave. By-passi është kthyer në një stres të përditshëm për udhëtarët dhe herë pas here ka bllokime të trafikut për shkak të problemeve të rrugës dhe vështirësisë së manovrimit të mjeteve.

Kur në rrugë nisën zyrtarisht punimet u premtua se afati i nisjes së qarkullimit do



Pamje nga Tuneli i Murrizit, shembur në maj 2019. Ky kantier është braktisur. Shembja që duket në foto është bërë për shkaqe sigurie.

të ishte në pranverën e vitit 2021, ndërsa afati i përfundimit të punimeve u deklarua nëntor i vitit 2021.

Në fund të prillit 2020, gjatë një vizite në kantier, ministria Balluku pati folur për herë të parë për “problemet gjeologjike” të tunelit të Murrizit.

“Ura e Vashës përfundoi, por Tuneli i Murrizit duket se nuk do të mbarojë në afat. Ndaj lind nevoja e ndërtimit të një by-passi, i cili nuk është parashikuar në kontratë, gjë e cila do të bëjë të mundur që rruga të hapet për trafikun në pranverën e vitit 2021”, i thoshte Balluku kryeministrit Rama, në praninë e presidentit të kompanisë “Gjoka Konstruksion”, Rrok Gjoka dhe inxhinierëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

“Punimet kanë ecur mirë, pavarësisht se ndodhemi në muajin e 22-të, fiks në mes të kontratës (kontrata parashikon 44 muaj punime), punimet kanë ecur dhe janë shumë të avancuara, edhe përtej grafikut të parashikuar që kemi pasur” - theksonte në atë kohë Balluku.

Kjo kronikë e 28 prillit, e publikuar në faqen e kryeministrit, ishte sinjali i parë se punimet në Rugën e Arbrit do të zgjasnin përtej parashikimeve.

“Me këto ritme, tuneli i Murrizit, që është edhe vepra më e rëndësishme e Rugës së Arbrit, nuk mbaron dot në 22 muajt e ardhshëm të parashikuar në kontratë. Ndaj, del e nevojshme një zgjidhje tjetër”, theksohej nga autoritetet në atë kohë. Dhe zgjidhja u gjet ndërtimi i një by-passi, i cili “nuk do t’i kushtonte” asnjë cent buxhetit të shtetit dhe do të arrihej që rruga të hapej në kohë.

Gënjeshtrat për afatin e mbarimit të punimeve vazhdonin edhe kur kontrata për zgjatjen e afatit ishte firmosur. Në mars të vitit 2021, ministria Balluku theksonte në emisionin “Absolut 4” në televizionin A2CNN se “Rruga e Arbrit ka edhe 18 muaj për të vazhduar punimet... Në kontratën e saj ajo ka afat përfundimin fundin e vitit 2022”.

Ndërsa në interpelancën parlamentare të 7 korrikut 2022, theksonte se “është kërkuar kohë shtesë prej 17 muajsh..., duke e çuar periudhën e ndërtimit në 61 muaj”. Sipas Ballukut, korriku i vitit 2022 është përkon me muajin e 46 të kontratës.

Më 14 prill 2021 ishte kryeministri Edi Rama që kaloi për herë të parë në Rugën e Arbrit në ndërtim. Ai tha në mitingun elektorale në Peshkopi se “sot pata mundësinë që ta shikoj gjatë gjithë gjatësisë rrugën e Arbrit, cila është drejt përfundimit, por tanimë është një aks i lidhur”. Gjatë fus-

hatës elektorale u përsërit disa herë se në korrik rruga do të ishte e kalueshme për të gjithë, por kjo nuk ndodhi. Ajo ishte e kalueshme vetëm për zyrtarët e qeverisë dhe për qytetarët që paguanin rojet të çdo trarë të vendosur në rrugë.

Premtimet se rruga do të ishte e hapur në pranverë 2021 u harruan.

STANDARDET SI JUSTIFIKIM

Bashkë me premtimet për Rugën e Arbrit ishin edhe premtimet për një rrugë me standarde europiane. Tashmë rruga do të ndërtohej në standardet C2, duke rritur kryesisht elementët e sigurisë në qarkullim.

Kur rruga u hap për qarkullim më 29 nëntor 2021, kryeministri Edi Rama dhe ministria Balluku, së bashku me deputetët e zonës mburreshin për faktin se nisi qarkullimi në rrugë.

“Shumë herë e nisur, por asnjëherë e bitisur, me projekte të lëna në mes dhe punime gjysmake, rruga mbeti për vite të tëra, peng i mentalitetit “shkel e shko”. Sot, kjo rrugë është premtim i mbajtur nga qeveria, që shërben, jo vetëm si aks i brendshëm, por edhe si pjesë e rëndësishme e një korridori ekonomik në rajon”, thuhej në një njoftim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Infrastrukturës.

“Kontrata ka afat dorëzimi fundin e prillit 2022 dhe do të bëjmë të pamundurën për të dorëzuar gjithçka në kohën e duhur” – u shpreh ministria Balluku më 29 nëntor 2021, teksa tha se “problematike mbetet gjeologjia e veçantë e tunelit të Murrizit, që ka vonuar edhe punimet”.

SHQETËSIMET QË NUK U DËGJUAN

Kur Partia Socialiste erdhi në pushtet, prof. dr. Bashkim Lleshi, botoi një shkrim në gazetën “Rruga e Arbërit” (korrik 2013), ku kërkonte rishikimin e projektit të rrugës, i cili ishte ndryshuar disa herë për shkak të ndërhyrjeve politike.

Lleshi vuri në dukje katër probleme kryesore të projektit që ishin tunelet e Qafës së Buallit, Gurit të Bardhë dhe të Murrizit, si dhe Urës së Vashës.

Shqetësimet e profesorit të gjeologjisë, Bashkim Lleshi, u riformuluan sërish në një letër ky drejtuesit e dy shoqatave, “Lidhja e Intelktualëve Dibranë” dhe “Nisma Dibrane” i shkruajnë në Mars 2014 Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe gjashtë deputetëve të Dibrës.

Asnjë nga qeveritarët dhe deputetët nuk shpehu interesim për letrën. Sot që po

transparencë për afatet dhe standardet

PROF. BASHKIM LLESHI: JA KU KËRKOHEJ RISHIKIM I PROJEKTIT

TUNELI I QAFË BUALLIT

Tuneli i Qafës së Buallit është vendosur në pozicionin më të keq të mundshëm, aty ku kalon prishja e madhe tektonike nga lugina e Planit të Bardhë në Qafë Buall dhe vazhdon në luginën e Vajkalit deri në Fushë Bulqizë... Në kushtet e krijuara për të hapur 400 ml. tunel aty ku kanë filluar përgatitjet, shpenzimet do të shkojnë sa për të hapur 850ml., tunel aty ku duhet të fillojë hapja e tunelit...”

URA E VASHËS

Pas një studimi të tillë gjeologo-inxhinjerik, si ka mundësi që aksi ku do të ndërtohet ura, të mos caktohet aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, për të dalë ura më e shkurtër, pra mbi Urën e vjetër të Vashës, por zbritet më poshtë, aty ku lugina është gati dyfish më e gjerë, duke dyfishuar shpenzimet për ndërtimin e Urës.

TUNELI I GURIT TË BARDHË

Me paratë e kursyera nga Ura e Vashës, mund të parashikohet që Tuneli i Gurit të Bardhë të ishte më i gjatë, të kalonte në formacione po të qëndrueshme në të cilat punohet më kollaj për hapjen e tunelit, më afër fshatit turistik të Gurit të Bardhë, përball kalasë së Petralbës historike, duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e rrugës.

TUNELI I MURRIZËS

Për tunelin e Murrizës nuk ka asnjë argument teknik që të bëhet pengesë për hapjen e tij. Rreth 80% e gjatësisë së tunelit është e ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinj mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor (Greqia) ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë-Selanik.

përballen me probleme, të gjithë bëjnë të paditurin.

“Megjithatë është deklaruar disa herë për problematikat në formacionet gjeologjike të shfaqura, unë së bashku me disa kolegë të tjerë mbetemi të gatshëm të ndihmojmë në zgjidhjen e problemeve të hasura”, thotë për gazetën profesor Bashkim Lleshi. Ai është i sigurt se problematikat kanë ndodhur më shumë për shkak të rrethanave që nuk kanë të bëjnë me gjeologjinë e terrenit.

“Rreth 80% e gjatësisë së tunelit të Murrizit është e ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinj mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor, Greqia, ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë-Selanik”, thotë profesor Lleshi.



Balluku: Kontratës së Rrugës së Arbrit nuk i është shtuar asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit

Më 2 gusht 2022, gjatë prezantimit të Korridorit Adriatiko-Jonian, Milot-Fier, Ministria Belinda Balluku u ndal edhe të problematikat e shfaqura në Rrugën e Arbrit.

“Do të ndalem një moment, pa dashur të marr kohë nga ky projekt i rëndësishëm, për të cilin nisim sot garën ndërkombëtare nga Korridori blu, do të ndalem vetëm një moment te rruga e Arbrit, e cila në nëntor të vitit të kaluar u bë e aksesueshme në një pjesë të saj, por sigurisht mbeten disa pjesë shumë të rëndësishme për t’u dorëzuar, siç është pjesa e tunelit të Murizit, një tunel ky i cili na ka vendosur përpara një vështirësie shumë të madhe për sa i përket gjeologjisë dhe na është dashur që rishikohej i gjithë projekti dhe të lëvizet hyrja veriore me disa metra, me 120 metra duke e bërë kështu që të shtyhet dhe afati kontraktual i kësaj pjese të veprës së rrugës së Arbrit, duke i dhënë dhe 17 muaj kohë deri në përfundim.

Duhet thënë se një pjesë e mirë e kilometrave të atij tuneli ku nga 3.2 që ishte në fillim i projektuar sot me ndryshimet që janë përsa i përket lëvizjes për të gjetur një formacion më të mirë, ka shkuar në 3.8 dhe ka edhe gërmimin e një tuneli ndihmës që është 3.6 km që

është i detyrueshëm sipas të gjitha kriterëve për çdo tunel mbi 500 metra. Kështu që si tuneli kryesor 3.8 km si tuneli ndihmës vazhdon me ritme të avashta jo ashtu siç po ecim në Llogara fatkeqësisht, por në mënyrë konstante edhe ne besojmë që brenda 17 muajve edhe tuneli i Murrizit do t’i dorëzohet të gjithë qytetarëve dhe drejtuesve të automjeteve për përdorim.

Megjithatë, nuk duhet harruar që kësaj kontrate, kontratës së Rrugës së Arbrit, nuk i është shtuar asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit, vazhdojmë sot dhe kësaj dite dhe operojmë me të njëjtën sasi parash siç është nënshkruar kontrata, edhe bypassi i Murrizit është financuar nga vetë koncesionari pa shtuar asnjë qindarkë në kontratë. Ndaloja pak më gjatë, pasi shpeshherë kemi pyetje për tunelin e Murrizit, por duke qenë se përmenda tunelin e Llogarasë dhe duke qenë që përmenda se sa shpejt kanë ecur punimet aty për t’iu treguar se formacioni gjeologjik luan një rol shumë të rëndësishëm, por rëndësi ka që ne i kemi adresuar të gjitha problemet teknike duke marrë padyshim tryeza të rëndësishme teknike qoftë nga këshilli teknik i ARSH, qoftë nga supervizori që ndjek projektin dhe nga vetë koncesionari.”

KALENDAR / RRUGA E ARBËRIT PËRMES PREMTIMEVE

4 janar 1996: 46 intelektualë të shoqatës “Nisma Dibrane” hartojnë një peticion, i pari zyrtarisht, ku i kërkohet qeverisë hapja e Rrugës së Dibrës.

2003: Qeveria akordoi fondin prej 11 milionë lekësh për studimin e fizibilitetit.

25 korrik 2004: Këshilli Kombëtar i Rrugëve miratoi Studimin e Fizibilitetit

Korrik 2005: Nisin punimet formalisht në Fushë Bulqizë, pa një projekt.

Tetor 2007: zhvillohet tenderi për segmentin Bulqizë - Ura e Çerenecit.

Janar 2008: Filluan zyrtarisht punimet në Fushë Bulqizë

Qershor 2009: Hapet tenderi për segmentin Bulqiza te Ura e Vashës. Punimet fillojnë në vitin 2011. Ky segment akoma nuk ka mbaruar.

Maj 2011: Fillojnë punimet në segmentin Ura e Brarit - Shkalla e Tujanit.

Mars 2013: Nis një peticion online për Rrugën e Arbrit. Qëllimi është depolitizmi i çështjes dhe presioni ndaj qeverisë për të nisur punimet sa më shpejt.

Dhjetor 2014: Firmoset Memorandum Bashkëpunimi me Chinese Exim Bank për financimin e Rrugës së Arbrit.

16 Prill 2015: Kuvendi i Shqipërisë me 89 vota “Pro”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miraton një ligj të posaçëm për dhënien e ndërtimit të rrugës së Arbrit me koncension kompanisë kineze “China State Construction Company”.

Shtator 2015: Koha e kontratës së miratuar nga Kuvendi mbaroi. Asnjë informacion



Pamje nga Tuneli i Murrizit, Xiber. Foto, qershor 2022

mbi dështimin e marrëveshjes. Deputetet e Dibrës: Çdo gjë sipas parashikimit.

Gusht 2016, Edi Rama në Peshkopi: Unë kam barrën që të bëj gjërat që dëshirojnë të gjithë anëtarët e koalicionit, – kjo është detyra ime dhe unë nuk ankoem për këtë detyrë, sepse e kam marrë me dëshirë dhe

vullnet të madh, – por unë po ju them këtu, që unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit, pa bërë Rrugën e Arbrit.”

Tetor 2016: Bëhet publik propozimi i përkërkuar i kompanisë “Gjoka Konstruktsion”

(Vijon në faqen 4)

Megjithëse punimet në Rugën e Arbërit filluan në Dhjetor 2017, katër muaj përpara se parlamenti të miratonte kontratën e koncesionit me “Gjoka Konstruksion”, punimet nuk arritën të mbarohen në afat. Sot, asnjë segment i rrugës, megjithëse qarkullojnë makinat, nuk plotëson asnjë standard të sigurisë rrugore.

KALENDAR / RRUGA E ARBËRIT PËRMES PREMTIMEVE

(Vijon nga faqja 3)

12 prill 2017: Qeveria vendos miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Gjoka konstruksion”, sh.a., për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat për kompletimin dhe ndërtimin e Rugës së Arbrit.

Gusht 2017: Hapet tenderi për ndërtimin e Rugës së Arbrit në të gjithë gjatësinë e saj, 69 km.

11 gusht 2017: Edi Rama: “Rruga e Arbrit çel programin “1 Miliardë për Rindërtim. Drejt finalizimit një proces i stërzgatur në vite që do të kurorëzohet, siç është premtuar brenda vjeshtës me nisjen e punimeve. Është çelur procedura finale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rugës së Arbrit, me një vlerë prej 33,6 mld lekë të reja. Ofertat do të priten deri në datë 2 tetor 2017 dhe komisioni do të shpallë fituesin brenda 60 ditëve nga data e mbylljes së ofertës”.

2 tetor 2017: Pas hapjes së dokumentacionit të tenderit rezultoi se kompania e vetme që ka plotësuar dokumentacionin dhe ka dhënë një ofertë financiare është “Gjoka Konstruksion”. Shuma: 33,6 miliardë lekë. Në tender marrin pjesë tre kompani, njëra rezultat fikside dhe tjetra nuk paraqet ofertën.

Nëntor 2017: Kryeministri Rama prezanton në Dibrë projektin. “Me Rugën e Arbrit Dibra do të kthehet në kopshtin e pasmë të Tiranës”.

Dhjetor 2017: Kompania “Gjoka Konstruksion” akoma nuk e ka hedhur firmën mbi kontratën me qeverinë shqiptare për ndërtimin e Rugës së Arbrit, por përmes nënkotraktorit të saj, “Selami Sh.p.k.” ka nisur punimet në vendin e quajtur Ura e Çerenecit në drejtim të Maqellarës.

28 mars 2018: Qeveria shqiptarë miratoi kontratën e koncesionit/PPP, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe shoqërisë “Gjoka Konstruksion”, sh.a., për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rugës së Arbrit.

Prill 2018: Parlamentin miratoi kontratën me “Gjoka Konstruksion” për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rugës së Arbrit.

15 qershor 2018, kryeministri Edi Rama në FB: “Çdo dibran që më ka telenditur në FB me sharje e tallje për Rugën e Arbrit, i ka hallall të gjitha, po erdhi të dielën në Peshkopi e në Klos për fillimin e punimeve të pritura 100 vjet. Fjalët mbrapsht kush nuk çon të paktën një buzëqeshje në FB në pamundësi për të ardhur”.

17 qershor 2018: Tymi i kuq shpërtheu në mesditë në një tunel në Klos, që shënoi nisjen e punimeve në Rugën e Arbrit, në segmentin krejtësisht të ri prej 26.2 km, që do të bëjë bashkë Dibrën dhe Tiranën.

17 qershor 2018: Presidenti i kompanisë “Gjoka Konstruksion”, Rrok Gjoka, tha në ceremoninë e nisjes së punimeve në Klos, se pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj (rreth 4 vite), ai theksoi se ato do të mbaronin për dy vite.

18 korrik 2018: Kryeministri Edi Rama njofton përmes një video prej 3 minutash në faqen e tij zyrtare në FB vazhdimin e punimeve në Rugën e Arbërit përgjatë lumit në Zall Bastar, si dhe nisjen e punimeve në Tunelin e Murrizit, më i madhi dhe më i rëndësishmi në këtë aks rrugor. Në video njoftohet me titra se Tuneli i Murrizit ka avancuar 20 metra, ndërsa dy tunelet e tjerë në fshatin Fshat në Klos kanë avancuar përkatësisht 90 dhe 281 metra.

13 gusht 2018: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë hapi një tender publik për “shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare/PPP për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit” me një vlerë 446 218 904 lekë, ose përafërsisht 3.5 milionë Euro.

15 gusht 2018: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjinkuri, përmes një postimi me disa foto në FB dha lajmin se një ditë më parë “u shënua dhe hapja e tunelit T5 që është 500 metër i gjatë dhe ndodhet në fshatin Fshat të Klosit. Përtej këtij tuneli do të fillojë ndërtimi i Urës së Vashës, e cila do të kryejë lidhjen me anën tjetër të rrugës në drejtim të Bulqizës”. Gjinkuri njoftonte se në kantier janë mbi 450 makineri në punë.

24 gusht 2018: Kryeministri Edi Rama u tha “Mirëmëngjes” dhe u uroj një ditë të mbarë ndjekësve të tij në FB me një videoinformacion nga kantieri i Rugës së Arbrit, ku sipas tij, “punimet vijnë me cilësi e ritëm të lartë sipas planit”.

5 dhjetor 2018: Kryeministri përcolli një foto nga ura mbi lumin Drin në Gjoricë kushkruan: “Një kartolinë me një përqafim nga larg për ata që përqeshnin 3D e Rugës së Arbërit: Kjo është ura e re mbi Drin, në Gjoricë/Maqellarë, pjesë e shtratit të Rugës së Arbërit, ku po punohet me ritme e cilësi të lartë, nën supervizionin e një kompanie të specializuar gjermane, të kontraktuar nga shteti shqiptar për mbikqyrjen e punimeve”.

15 dhjetor 2018: Kryeministri Edi Rama publikon në mëngjes në FB një video 80 sekondëshe ku jepen pamje nga punimet në urën e Vashës dhe në urat mbi lumin Drin dhe Zallin e Bulqizës. “Me këto pamje nga kantieri i rrugës së Arbrit ku pas hapjes së tre tuneleve po punohet intensivisht edhe për Urën e Vashës, ju uroj një ditë të mbarë”.

Shkurt 2019: Balluku: “Rruga e Arbrit është një vepër shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të zonës. Gjëja më e



rëndësishme është që duhet të përfundojë në kohë, duhet të përfundojë me cilësi... E gjithë pjesa e rrugës së Arbrit që ka mbetur për t’u ndërtuar është 54 km, në të cilën konçensionari ka realizuar më shumë se 28% të punimeve”

11 shkurt 2019: Kryeministri Edi Rama mëngjesin e 11 shkurtit përcolli një video nga punimet e deritanishme në Rugën e Arbrit me shënimin “... me këto pamje që s’kanë nevojë për koment nga kantieri i Rugës së Arbërit, duke ju siguruar të gjithë se sa më shumë të lehin qentë aq më të frymëzuar e të vendosur jemi për ta bërë Shqipërinë që duam”.

16 maj 2019: Kryeministri Edi Rama postoi një video nga punimet në Rugën e Arbërit. Në sekondën e 25-të të videos shfaqen pamje të punimeve të njërit nga tunelet e Murrizit, ndërkohë që në brendësi të tunelit tjetër, që është edhe kryesori, ka ndodhur një shembje.

Qershor 2019: Më 1 qershor shumica e mediave të Tiranës, kryesisht online, treguan disa foto nga shembja e tunelit, pa specifikuar se për cilin tunel bëhej fjalë. “Shembja ka ndodhur në brendësi të tunelit kryesor, në një segment të izoluar prej 15 metra, por kjo nuk është aq problematike saç shkruanin mediat.”



15 qershor 2018, kryeministri Edi Rama në FB: “Çdo dibran që më ka telenditur në FB me sharje e tallje për Rugën e Arbrit, i ka hallall të gjitha, po erdhi të dielën në Peshkopi e në Klos për fillimin e punimeve të pritura 100 vjet. Fjalët mbrapsht kush nuk çon të paktën një buzëqeshje në FB në pamundësi për të ardhur”.

17 qershor 2018: Presidenti i kompanisë “Gjoka Konstruksion”, Rrok Gjoka, tha në ceremoninë e nisjes së punimeve në Klos, se pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj (rreth 4 vite), ai theksoi se ato do të mbaronin për dy vite.

30 korrik 2019: Kryeministri Edi Rama deklaroi: “Janë realizuar 40% e punimeve në Rugën e Arbërit. Është një progres shumë i kënaqshëm dhe falë partneritetit publik, privat, një termi të kriminalizuar si rezultat i shfrenimit propagandistik, shumë shpejt, Dibra dhe gjithë ajo zonë e izoluar prej dekadash, për të mos thënë shekujsh, do të jetë e lidhur me kryeqytetin dhe do të jetë faktikisht një territor i ri, që do të zbulohet në sytë tanë, një jastëk i gjelbër i Tiranës, në një aks me bukuri përrallore dhe me potenciale fantastike”.

2 gusht 2019: Ministria Balluku inspekton punimet në dalje të Tunelit të Murrizit, në anën e Klosit, në Xibër. Presidenti i Kompanisë “Gjoka”, Rrok Gjoka, bëri një panoramë të vështirësive të punimeve që kur ato kanë nisur. “Që në fillimet e para kur kemi filluar punën vumë re që nuk ishte e njëjta situatë siç ishte parashikuar... Besoj se shumë shpejt, punë ditësh, do t’i dalim Ministrisë me propozim e një apo dy variante, të cilat do të vlerësohen se si mund të zgjidhen pass rrëshqitjes, por për momentin nuk kemi akoma një përgjigje përfundimtare. Fjalën e fundit do ta thonë specialistët dhe inxhinierët që po merren me këtë punë. Por, gjithsesi, tuneli do të bëhet.”

Prill 2020: “Ura e Vashës përfundoi, por Tuneli i Murrizit duket se nuk do të mbarojë në afat. Ndaj lind nevoja e ndërtimit të një by-passi, i cili nuk është parashikuar në kontratë, gjë e cila do të bëjë të mundur që rruga të hapet për trafikun në pranverën e vitit 2021”.

Tetor 2020, Belinda Balluku në analizën vjetore të MEL: Mes rrugëve që duhen përfunduar gjatë 2021 është Rruga e Arbërit, e cila do të përfundojë përpara afatit të parashikuar.

Dhjetor 2020: Belinda Balluku tha në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese se “Rruga e Arbërit pritet të jetë në funksion në mars të vitit 2021... Është një projekt që na bën krenarë të gjithëve”.

21 Tetor 2020: “Mes rrugëve që duhen përfunduar gjatë 2021 është Rruga e Arbërit, e cila do të përfundojë përpara afatit të parashikuar”, tha Ministria e Infrastrukturës Belinda Balluku, gjatë një analize vjetore mbi Infrastrukturën.

25 nëntor 2020: Dy harqet e Urës së Lezës në fshatin Fshat u bashkuan.

Mars 2021. Balluku në A2CNN: “Rruga është e kalueshme, por afati i punimeve mbaron pas 18 muajsh”.

14 prill 2021: Kryeministri Edi Rama kalon për herë të parë në trasenë e Rugës së Arbërit për të zhvilluar takimet elektorale në Burrel dhe Peshkopi.

29 nëntor 2021: Nisin zyrtarisht qarkullimi makinave në segmentin krejtësisht të ri nga Tirana në Klos, 35 km.

Prill 2022: Ndërsa pritej përfundimi i punimeve, njoftohet zgjatja e afatit.

“Dibra si qark është e interesuar për shkolla profesionale të Hoteleri-Turizmit, shkolla bujqësore dhe gjithçka tjetër, por sidomos shkollat teknike, e cila do të arrijnë të prodhojnë teknikë që do t’i përgjigjen kërkesës së ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës, ku është ofruar edhe Bechteli për të dhënë ekspertizën, por edhe financim për ngritjen e këtyre shkollave. Sipas saj, këto investime qeveria duhet t’i ketë në fokus dhe është një lajm shumë i mirë për gjithë qarkun.

Balluku: Tuneli i Murrizit është në 700 metrat e fundit

“Rruga e Arbërit, e cila është hapur pjesërisht gjatë muajit nëntor të vitit të kaluar, ka pasur një impakt shumë të madh për shkak të shkurtimit të minutave që duhen për të ardhur nga Tirana deri në Dibër dhe anasjelltas”, tha Belinda Balluku, ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht edhe e deleguar e Partisë Socialiste në Dibër, gjatë një takimi me kryebashkiakët e qarkut të Dibrës më 22 korrik në Pogradec.

Gjatë këtij takimi, ajo u ndal te problematikat e shfaqura në Tunelin e Murrizit, të cilat kanë bërë që të shtyhet afati i mbarimit të punimeve në fund të vitit 2023.

“Problematika ka ardhur për shkak të situatës gjeologjike që kemi hasur në tunelin e Murrizit dhe afati i kontratës për dorëzim ka qenë fundi i prillit të vitit 2022, por kjo kontratë është shtuar me 17 muaj në bazë të një vendimi të marrë nga këshilli teknik, i cili pasi ka marrë parasysh të gjitha faktet gjeologjike dhe teknike të tunelit të Murrizit, ndryshoi edhe një pjesë të drejtimit të këtij tuneli. Pra, tuneli ishte parashikuar në kontratën fillestare të ishte 3.2 km, ndërkohë që sot tuneli do të jetë 3.8 km gjatësi, duke u mundur të anashkalojë një pjesë gjeologjike me shtresë argjilore dhe për shkak të baseneve ujore që zona ka, bëhej e pamundur hapja dhe armatimi i tunelit”, theksoi Balluku.

Më tej Ministria e Infrastrukturës tha se “ecuria ka qenë e mirë kohët e fundit, pasi në tunelin e madh, pra ai që quhet tuneli kryesor i lëvizjes, kemi një ecuri prej hapje 3100 metra, të cilat janë të gjitha të armatuara, pra kemi edhe 700 metra final që do të dorëzohet vepra. Megjithatë duhet të kuptuar që këto 700 metra marrin kohë të konsiderueshme ndryshe nga se jemi mësuar me tunelet e tjera”.

Duke folur për tunelin e vogël, atë të emergjencave, Balluku tha se ndërtimi i tij është një detyrim për shkak të sigurisë rrugore, ku në çdo 500 metra tunel kryesor lëvizje, duhet të kemi patjetër një tunel ndihmës. Sipas Ballukut, deri më sot (22 korrik), janë hapur 3600 metra, pra ka dhe 200 metra për t’u përfunduar.

Duke justifikuar vonesat në ndërtimin e tunelit, Balluku bëri një krahasim me tunelin e Llogarasë, ku nga 14 nëntor 2021 ku nisi punën deri më sot, janë hapur më shumë se 2400 metra vetëm në 7 muaj.

Sipas Ballukut, të dy tunelet kanë kosto të shtuara që po përballohen nga kompania. “Në Llogara, për shkak të gjeologjisë së mirë, është gur gëlqeror, nuk kemi pasur problematika, madje është edhe një zonë ku ka mungesë të ujit dhe për të thënë të drejtën duke qenë se uji është i domosdoshëm nëpër kantierë ka edhe kosto të shtuara si projekt, por që nuk do të reflektohen në kostot finale dhe mbahen nga vetë kompanitë për të sjellë ujin në atë zonë”.

“Ndërkohë që në tunelin e Murrizit, pa varësisht se punohet në mënyrë intensive, për shkak të gjeologjisë argjilore që kemi hasur në atë zonë dhe burimeve të shumta nëntokësore që ka zona, detyrimisht ecet me hapa më të avashta, por çfarë është më e rëndësishme për ne është siguria qoftë e ndërtimit të tunelit dhe më pas siguria rrugore”.

Balluku tha se në pjesët e tjera vazhdon puna dhe brenda 17 muajve, sipas të gjitha gjasave dhe gjithë të dhënave nga këshilli teknik dhe nga supervizori i punimeve, kjo vepër do të jetë e dorëzuar.

“Duhet të theksoj diçka, pasi ka pasur shpeshherë aludime politike dhe propagandë të pastër mbi këtë projekt. Ky është një projekt i cili është i kyçur në një kontratë me çelësa në dorë, nuk ka asnjë shtesë fondesh,



■ “Në tunelin kryesor kemi një ecuri prej hapje 3100 metra, të cilat janë të gjitha të armatuara, pra kemi edhe 700 metra final që do të dorëzohet vepra. Megjithatë duhet të kuptuar që këto 700 metra marrin kohë të konsiderueshme. Deri më sot (22 korrik), te tuneli i emergjencave janë hapur 3600 metra, pra ka dhe 200 metra për t’u përfunduar”

Pamje nga punimet në Tunelin e Murrizit.
Foto: FB/GJOKA-Konstruksion

■ **Rruga e Arbrit “është një projekt i cili është i kyçur në një kontratë me çelësa në dorë, nuk ka asnjë shtesë fondesh, nuk ka pasur asnjëherë gjatë këtyre viteve shtesa fondesh. Është detyrimi i koncensionarit që në këto 13 vite që kontrata do të zgjasë nga ndërtimi dhe deri tek mirëmbajtja, të qëndrojnë në të njëjtat fonde financiare të cilat janë vendosur nga fillimi”.**

nuk ka pasur asnjëherë gjatë këtyre viteve shtesa fondesh. Është detyrimi i koncensionarit që në këto 13 vite që kontrata do të zgjasë nga ndërtimi dhe deri tek mirëmbajtja, të qëndrojnë në të njëjtat fonde financiare të cilat janë vendosur nga fillimi”.

BALLUKU: PËRMES SKAVICËS NE DO TË BALANCOJMË TË GJITHA BURIMET ENERGJETIKE

Gjatë takimit me kryebashkiakët e qarkut të Dibrës, Balluku u ndal edhe te çështje e ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës.

“Skavica është një nga projektet më të rëndësishme, i cili prek qarkun e Dibrës, jo vetëm për sa i përket rëndësisë që ka, se tashmë këtë e dinë gjithë shqiptarët dhe e kemi thënë. Sidomos, për sa i përket gjendjes

aktuale të energjisë, e cila nuk duket të jetë e mirë, as në vitet në vazhdim, pasi përveç konfliktit gjeopolitik që ka tashmë Ukraina dhe Rusia që kanë ndikuar direkt në sektorin energjetik. Ky është një vit që po përballët e gjithë Europa me një thatësirë të paparashikuar përveçse të pahasur më parë dhe sigurisht vendet Mesdheut janë ato që po e ndjejnë më shumë thatësirën. E thënë kjo, Skavica merr një rëndësi akoma dhe më të madhe jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin, pasi Skavica nuk do të jetë thjesht një vlerë e shtuar në sistemin tonë energjetik për sa i përket sasive që do të prodhojë, por mbi të gjitha Skavica është depozita jonë natyrore e prodhimit energjetik”.

“Përmes Skavicës ne do të fillojmë të balancojmë të gjitha burimet e tjera energjetike, edhe ato që po shtojmë, për sa i përket parqeve fotovoltaike apo parqeve të erës, pra ato eolike do t’i balancojmë në basenin e liqenit të Skavicës duke optimizuar kështu të gjithë kaskadën e Drinit me të katër hidrocentralet të cilët janë parashikuar për t’u ndërtuar atje”.

Gjatë këtij takimi, Balluku është ndalur

edhe në investimet e tjera që priten të bëhen në qarkun e Dibrës.

“Fakti që Bechtel, përmes studimit të fizibilitetit, gjatë periudhës së ndërtimit dhe periudhës së operimit në këtë projekt, pra në projektin e Skavicës do të angazhohen më shumë se 3200 punonjës, të cilët duhet të jenë të gjithë të trajnuar, duke e nisur nga detyrat më bazike siç mund të jenë drejtuesit e automjeteve dhe deri tek inxhinierët, bën të nevojshme që në zonë të kemi një fokus për sa i përket rritjes së shkollave profesionale”, tha Balluku.

Sipas Ballukut, Dibra si qark është e interesuar për shkolla profesionale të Hoteleri-Turizmit, shkolla bujqësore dhe gjithçka tjetër, por sidomos shkollat teknike, e cila do të arrijnë të prodhojnë teknikë që do t’i përgjigjen kërkesës së ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës, ku është ofruar edhe Bechteli për të dhënë ekspertizën, por edhe financim për ngritjen e këtyre shkollave. Sipas saj, këto investime qeveria duhet t’i ketë në fokus dhe është një lajm shumë i mirë për gjithë qarkun.

Korresp. Rr.A.

■ **“Fakti që Bechtel, përmes studimit të fizibilitetit, gjatë periudhës së ndërtimit dhe periudhës së operimit në këtë projekt, pra në projektin e Skavicës do të angazhohen më shumë se 3200 punonjës, të cilët duhet të jenë të gjithë të trajnuar, duke e nisur nga detyrat më bazike siç mund të jenë drejtuesit e automjeteve dhe deri tek inxhinierët, bën të nevojshme që në zonë të kemi një fokus për sa i përket rritjes së shkollave profesionale”, tha Balluku.**

LETËR FALËNDERIMI AMBASADORES YURI KIM: NDALENI “BECHTEL” TË NDËRTOJË SKAVICËN!

Gjatë muajve të fundit ka një rritje të veprimtarive të aktivistëve kundër planeve për ndërtimin e HEC të Skavicës. Ndërsa në kantier vazhdon puna për studimet gjeologjike, ditët e fundit është folur për një tërheqje të makinerive nga kantieri.

Lidhur me këto lajme, Nazmi Drizi, kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, më 18 gusht 2022, i ka nisur një letër ambasadores së SHBA në Tiranë, znj. Yuri Kim.

Drizi i shkruan Ambasadores se “ka dalë një informacion që Bechtel” është tërhequr nga ndërtimi i Skavicës”.

Ai i kërkon ambasadores së SHBA që të ndërhyjë në këtë proces dhe të ndalojë punimet e kompanisë amerikane, pasi ajo nuk “duhet të bëhet pjesë e financimit të pa pasqyruar realisht”.

Drizi i ankohet ambasadores se qeveria shqiptare nuk është treguar transparente me banorë.

“Lugina e Drinit të Zi është e veçantë në llojin e saj, nga resurset që ka, - shkruan Drizi në letrën e bërë publike në Facebook, - ndaj shpresojmë që zëri jonë të jetë bërë pjesë e ndërgjegjes tuaj dhe e SHBA-ve, përfaqësues të së cilës jeni”.



Pamje nga protestat kundër ndërtimit të Skavicës

Ka shpresë për Lurën!

Prerja e pyjeve nuk ka qenë e keqja më e madhe në Lurë. E keqja më e madhe kanë qenë zjarret e njëpasnjëshme, të cilët kanë shkatërruar në një pjesë të konsiderueshme të territorit, të gjithë drurët e mbetur atje. Kjo ka bërë që në shumë zona të mos ketë drurë, të cilët mund të hedhin farat e tyre në tokë për të krijuar një gjeneratë të re pylli. Djegia ka bërë, gjithashtu, që të shkatërrohet lënda organike e tokës dhe lëndët e tjera ushqyese, të cilat bëjnë të mundur rritjen e filizave të rinj. Pra, përveçse toka është djegur, ajo edhe është varfëruar shumë, gjë që e bën të vështirë që edhe ato pak fara që arrijnë të mbijnë në tokë të zhvillohen.

Nga **ABDULLA DIKU**

Parku Kombëtar i Lurës ngjan si shumë pjesë të tjera të territorit të vendit që janë djegur e shkatërruar nga prerjet e zjarret këto 30 vitet e fundit. Veçse në Lurë dëmi duket më i madh për shkak të hijeshisë së pakrah-sueshme që pyjet dhe liqenet akullna-jore ofronin për syrin dhe ekosistemin, duke e bërë atë një peizazh unik në shkallë vendi.

Të kuptohemi, prerja e pyjeve nuk ka qenë e keqja më e madhe në Lurë. E keqja më e madhe kanë qenë zjarret e njëpasnjëshme, të cilët kanë shkatërruar në një pjesë të konsiderueshme të terri-torit, të gjithë drurët e mbetur atje. Kjo ka bërë që në shumë zona të mos ketë drurë, të cilët mund të hedhin farat e tyre në tokë për të krijuar një gjeneratë të re pylli. Djegia ka bërë, gjithashtu, që të shkatërrohet lënda organike e tokës dhe lëndët e tjera ushqyese, të cilat bëjnë të mundur rritjen e filizave të rinj. Pra, përveçse toka është djegur, ajo edhe është varfëruar shumë, gjë që e bën të vështirë që edhe ato pak fara që arrijnë të mbijnë në tokë të zhvillohen.

Lura, vetëm prej asaj se çfarë është shkruar për të, ka krijuar një audiencë të madhe dashamirëse ndaj sajë. Persona që nuk kanë qenë asnjëherë në Lurë shprehen tejet të pikëlluar teksa shohin a dëgjojnë për shkatërrimin që i është bërë këtij parku të famshëm.

Prej shumë vitesh janë bërë tenta-tiva e ndërmarrë nisma (ndonjëherë edhe serioze) për ta ringjallur Lurën. Ndoshta për të dhënë një mesazh se pas çdo shkatërrimi, nëse do, mendja dhe vepra njerëzore mund të bëjë mirë me natyrën, mund të ndihmojë në ring-jalljen e sajë.

Së fundmi isha në Lurë dhe pashë përreth dy liqeneve të fundit (liqeni i Luleve dhe Kallabës) fidanë pyjorë të mbjellë dhe që ishin në gjendje të mirë. Janë fidanë të mbjellë në vitin 2016



Prej shumë vitesh janë bërë tentativa e ndërmarrë nisma (ndonjëherë edhe serioze) për ta ringjallur Lurën. Ndoshta për të dhënë një mesazh se pas çdo shkatërrimi, nëse do, mendja dhe vepra njerëzore mund të bëjë mirë me natyrën, mund të ndihmojë në ringjalljen e sajë.

nga Alb garden me Pishë të zezë dhe pak Hartinë. Peizazhi, aty që dikur i ngjante një poligoni testesh bërthamore, kishte filluar të marrë ngjyrën e jetës, të gjelbër.

Përshtypja e jashtëzakonshëm!

Fidanë të mbjellë në 2016, të cilët në disa raste i kanë kaluar dy metra dhe pothuajse asnjë fidan i tharë.

Kujt ja merrte mendja se pas atij shkatërrimi masiv, do kishte sërish shpresë për jetë në Lurë?


Kësaj shtate optimiste i shtohet edhe fakti që, prej vitesh, nuk ka më zjarre në Lurë. Fidanët e rinj të mbjellë nga njeriu apo vetë natyra nuk po digjen nga zjarre të pakuptimta. Ato pak fidanë të mbjellë janë mbrojtur mirë deri tani nga ato që kujdesen për parkun, por dhe nga komuniteti.

Natyra po e merr veten shumë ngadalë dhe nëse do ndihmohet nga njeriu, ritmi i ringjalljes së natyrës në Lurë do të përshpejtohet.

Gjithashtu, është e rëndësishme të thuhet se edhe komuniteti në Lurë duket që ka një tjetër qasje për të ardhmen atje. Nuk shihen pyjet si burim fitimi, por turizmi. Dhe ata e dinë se pa pyje nuk ka turizëm, nuk ka të ardhme as për to e as për natyrën. Ndaj ka shpresë për Lurën.

Sigurisht që ka gjëra që mund dhe duhej të bëheshin më mirë edhe në këtë rast pyllëzimesh duke mbjellë më shumë lloje (duheshin mbjellë edhe bredh të bardhë, arnen, rrobull, nuk duhej mbjellë në skemë të rregullt etj.), por gjithësesi, ai objekt i vogël pyllëzimesh aty, është një shenjë që edhe për Lurën ka shpresë të madhe. Duhet që të vazhdohet me pyllëzime apo mbështetje të rigjenerimit natyror atje, pasi ka shumë sipërfaqe që duhet pyllëzuar, ndryshe "shpresa" mbetet vetëm një fjalë.

Me rëndësi jetike është që investimet në pyllëzime të bëhen prioritet në nivel kombëtar, për ta ringjallur dhe njëherë natyrën. Për ti dhënë idenë e shpresës gjeneratave të reja që do ta gëzojnë këtë tokë pas nesh. Nuk duhet të lëmë vetëm tokë të djegur pas, sepse përveç natyrës, mallkimi i brezave do të na ndjekë edhe nën tokë, pasi ta kemi lënë këtë botë. Duhet të lëmë natyrën siç e kishim ne, dhe duhet të lëmë mbi të gjitha shumë shpresë. Dhe ai shembull i vogël në liqenet e Lurës ofron shpresë se gjërat nëse duam, mundet dhe dimë ti bëjmë mirë.



Me rëndësi jetike është që investimet në pyllëzime të bëhen prioritet në nivel kombëtar, për ta ringjallur dhe njëherë natyrën. Për ti dhënë idenë e shpresës gjeneratave të reja që do ta gëzojnë këtë tokë pas nesh. Nuk duhet të lëmë vetëm tokë të djegur pas, sepse përveç natyrës, mallkimi i brezave do të na ndjekë edhe nën tokë

reportazh

Në Korab, Olimpin e Shqipërisë

Nga ENVER ROBELLI

Herën e fundit kur kisha kaluar nëpër Kukës me veturë, ende nuk ishte hapur autostrada, që quhet “Rruga e kombit”. Në qendër të Kukësit dominonte një reklamë: “Ngjyemë lesh”. Kjo informatë tregonte se ky rajon jeton e mbijeton nga blegtoia dhe bujqësia. Reklama është zhdukur, Kukësi është bërë me aeroport dhe në rrethinë, sidomos në drejtim të Qarkut të Dibrës, po zhvillohet turizmi malor. Po vijnë turistë nga Spanja, Belgjika, Gjermania e vende të tjera, disa ngjiten në kodrën e Korabit, disa zbulojnë bukuritë e trevës me biçikletë.

Të shtunën në orën 06:00 bashkë me Granit Temajn dhe Mentor Latifin u nisëm nga Prishtina për në fshatin Radomirë, ku fillon shtegu drejt Korabit, me 2764 metra lartësi mbidetare maja më e lartë e Republikës së Shqipërisë. Haxhi Hima dhe i biri i tij Agroni kanë hapur në Radomirë një bujtinë - bash përballë tabelës me mbishkrimin “Rruga Turistike në Malin e Korabit”. Aty parkuam veturën, bekuam këmbët dhe morëm malin.

Shtegu është shumë i bukur dhe me plot kontraste. Në orën e parë të ecjes shpesh kalon nëpër pyje, pastaj shfaqen fusha të bukura, rrethuar nga një panoramë impozante kodrash. Ndërsa në horizont dukej qafa e fundit para ngjitjes në kodrën e Korabit, drejt nesh po vinte një burrë mbi kalë, pas tij një kalë tjetër, para tyre një qen që dukej si luan. “Nuk ju han, nuk ju han”, jehoi zëri i kalorësit, i cili na tregoi se atje lart ka një stan. Pastaj tha se kishte jetuar në Greqi e Angli e shumë vende të tjera të Europës, ndërsa tani merrej me blegtoia.

Pas tij u ndeshëm me dy bjeshkatarë fjalëpakë gjermanë, mandej, afër qafës së malit, drejt Radomirit zbriste një grup turistësh spanjollë, shoqëruar nga një vajzë shqiptare, e cila doli të ishte udhërrëfyesja e tyre. “Kam qenë me ta edhe në Kosovë, në Gjeravicë”, tregoi ajo, duke përmendur me humor temën e pashmangshme se Spanja nuk e pranon pavarësinë e Kosovës. Në qafën e malit po priste një kalë i lidhur me sixhim për dy gurë (pak më poshtë do të shpjegoj se përse ky kalë ishte ngjitur atje lart).

Tashmë në fushëpamjen tonë të gjerë shihej flamuri me shqiponjën dykrerëshe mbi Korab. Shtegu shpie nëpër vijën kufitare mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Në anën e majtë duket gati gjysma e Shqipërisë, në anën e djathtë liqeni i Mavrovës, bjeshkët e Radikës dhe treva deri në Gostivar.

Nën Korabin e famshëm një qen edhe më i madh se ai tjetri që pamë poshtë, një tufë me dele – dhe një bari. “Jam nga Librazhdi”, tha ai, “siç po e shihni: çoban. Dalim në bjeshkë në qershor dhe rrimë deri në nëntor. I kam 400 krerë dele”. Pyetja se “çfarë bëni me qumështin e deleve, si e transportoni në luginë, në Radomirë” duket se e habiti pak bariun. “Nuk i mjelem delet”, shpjegoi ai. “Qengjat i thithin. Pronari i shet delet e qengjat për mish”. Shqiptarët janë popull mishngrënës.

Në majën e Korabit së pari takuam tre djem nga Dibra e Shqipërisë. “E patë një njeri me dy kuaj gjatë rrugës”, pyeti njëri nga dibranët.

“Po”.

“Atij i morëm kalin e tretë me qira për 20 euro sepse ky djali s’mund të ecte”, tha dibrani duke bërë me gisht nga një dibran tjetër me kapelë kauboji. (Kur njeriu atërron



Shtegu është shumë i bukur dhe me plot kontraste. Në orën e parë të ecjes shpesh kalon nëpër pyje, pastaj shfaqen fusha të bukura, rrethuar nga një panoramë impozante kodrash. Në horizont dukej qafa e fundit para ngjitjes në kodrën e Korabit...



në Aeroportin e Prishtinës më së shumti të bien në sy reklamën “rent a car”, rrugës për në Korab kjo është përkthyer në “rent a kalë”).

Një bjeshkatar kroati tregoi se ishte ngjitur në Korab nga ana e Maqedonisë (nga fshati Strezimir i Rekës së Epërme). “S’jam njeri i detit unë”, tha kroati dhe tregoi se do të vazhdojë me veturë për në Bullgari, ku do ngjitej në Musala, me 2925 metra kodra më e lartë e siudhësës së Ballkanit.

Dy bjeshkatarë flisnin polonisht (ndoshta çekisht, mund të ishte edhe sllovakisht), por s’qemë aq të interesuar t’i pyesnim sepse kishim një prioritet tjetër: fjetëm rreth një orë në majën e kodrës së Korabit, herë pas here të penguar nga një këlysh që vraponte pas ushqimit që ia hidhnim. (Gjatë zbritjes ky këlysh

do na shoqëronte një copë të mirë të shtegut, gjë që na nxitte të mendojmë sa sinonime i kemi në dialektet shqip për këlyshin: bubi, qenush, kutë. Ndoshta fjalë kutë rrjedh nga gjermanishtja: Köter i thonë qenit të vogël).

Si alpinist me përvojë Granit Temaj kishte paraparë që zbritjen të mos e bënim nëpër shtegun e njëjtë, por t’i silleshim kodrës rreth e rrotull. Sërish e takuam çobanin nga Librazhdi që po i çonte delet drejt stanit. Nën majën e Korabit gjendet Fusha e Panairit (në Radomirë banorët treguan se i thonë Fusha e Punait). Një faqe në Facebook me emrin “Visit Diber” shpjegon se Gropa (fusha) e Panairit gjendet në 2115 metra mbi nivelin e detit, është 800 metra e gjatë dhe deri në 230 metra e gjerë dhe ka formën e një amfiteatri të madh. Një shpjegim të logjikshëm mbi toponimin Fusha e Panairit ndoshta mund të ofrojnë ekspertët e gjeografisë dhe toponomastikës. E sigurt është se në këtë trevë dominon delja e racës rudë, të cilës i kushtohet edhe një këngë e bukur popullore (një ndër interpretimet më të bukura është ai i Elina Dunit).

Fusha tjetër që na pret gjatë rrugës është Fusha e Korabit. Edhe kësaj fushe i këndohet një këngë: e famshmja “Moj Fusha e Korabit” (ndër interpretimet më të bukura është ai i Liri Rashës). Kënga përshkruan vuajtjen e vajzës së dashuruar për bariun që kalon me muaj të tërë në stane duke ruajtur delet.

Katër vargje sa për të ilustruar përmbajtjen: “S’asht një ditë a dy – e, oj, mjera un-o, Janë gjashtë muej të zi - e, oj, mjera un-o! (...)

Kur t’ vijshë n’Fushë të Matit, oj mjera un-o, Lëshoja frenat atit, oj, mjera un-o!”

(Më vonë një banor i fshatit Radomirë do përpiquej të na bindte se kënga për Fushën e Korabit ka të bëjë me luftë, me patriotizëm e me betejë. Por atij i ndërhyri pronari i bujtinës Haxhi Hima duke i thënë: “Leje, o

burrë, se nuk është punë lufte...”). Edhe më bukur: punë dashnie!

Zbritja nga Fusha e Korabit deri në Radomirë zgjat e duket se s’po përfundon kurrë. Duhet durim. Për të motivuar veten dëgjoj një kapitull nga libri “Orient-Express” të shkrimtarit amerikan John Dos Passos. Një udhëpërshkrim mahnitës. Kapitulli tregon me hollësi ecjen e John Dos Passos nëpër Persi (Irani i sotëm), fshatrat e qytetet, dinjitarët fetarë, adetet dhe një kalë me jete e bisht të ngjyrosur me shafran.

Në hyrje të Radomirit befas kalërojnë drejt kodrës disa bujq. Mbi samarët e kuajve dhe mushkave ata kanë ngarkuar edhe disa kusi të thella me kapak. “Po dalim të marrim qumështin e lopëve, kthehem nesër në mëngjes”, tha njëri. Një kalorës mezi e mbante drejtpeshimin duke shtrënguar një gjë që dukej si dërrasë e mbështjellë me një cohë. Na tregoi se ishte panel solar, “nga java tjetër do të kemi rrymë atje lart”, tha ai dhe i bërtiti kalit me krejt fuqinë e zërit që kishte.

Pas 10 orë ecjeje, 1600 metra ngjitjeje dhe rreth 22 kilometrave të kaluara, pas qindra përshtypjeve, përjetimeve e pamjeve ndjellamirë – arritëm te bujtina “Korabi” e Haxhi dhe Agron Himës.

E kishim ndërmend që menjëherë të hiqim djersët nën currilat e dushit, por planin e ndryshoi pak Jani, një arsimtar gjeografie dhe historie nga Belgjika. Jani po e eksploronte Shqipërinë me biçikletë. Kishte aterruar në Korfuz dhe nga Saranda përpjetë dyrratëshi e kishte sjellë gjithandej nëpër Shqipëri, Maqedoni e Kosovë. Jani kishte arritur në Radomirë dhe na la gojëhapur duke treguar se ka ecur me biçikletë në Iran, në Afrikë, nga Sllovenia në Shqipëri (vitin e kaluar), në Gjeorgji, në Armeni, në Turqinë lindore. Dhe në Taxhikistan. “Taxhikistani është vendi më i bukur në botë”, tha Jani. “Armenia më kujton Shqipërinë”, tregoi ai.

Dikur, të freskuar e pastruar nga uji i bekuar i dushit, u ngjitëm për tavolinën ku Agroni na kishte shtruar darkën: supë, sallatë, djathë, patate, kos deleje, byrek, jufka me mish qengji. Të gjitha shumë të shijshme!

Pastaj, rreth orës 21:30, na përkundi në gjumë gurgullima e lumit që kalonte afër bujtinës. Pas 10 orë ecjeje gati 10 orë gjumë. Dita filloi rreth orës 08:00 me vezë të fër-guara, djathë, kos me boronica, mjaltë, reçel e çaj mali. Para se të niseshim, Agroni hyri në lokal me një kusi. “Erdhi qumështi”, tha ai. Dhe ne u nisëm drejt Prishtinës - pafundësisht të lumtur nga përvoja e kësaj ecjeje. Pjesën tjetër të këtij rrëfimi e ilustrojnë fotografitë. (Jani, ai belgu me biçikletë, kishte thënë se të dielën do të ngjitet në Korab – pa biçikletë).

*Marrë nga profili në Facebook i autorit. Titulli është i redaksisë. Titulli original: “Në Olimpin e Shqipërisë: Korab, 2764 metra lartësi mbidetare”. Fotot janë të autorit.



HEC-i i Skavicës - tradhti ndaj Dibrës

Në territorin e Dibrës janë ndërtuar dhjetëra hidrocentrale të vegjël si ai i Setës, i Okshtunit, i Lladimericës, i Tuçepit, i Ostrenit të Vogël, i Trebishtit, i Strikcanit, Krajkës etj., që padyshim ka dëmtuar faunën e florën e kësaj treve, ka prishur ekuilibrat mjedisorë. Shkurt, ndërtimi i HEC-it të Skavicës është shkatërrimi i Dibrës.

30 vitet e fundit nga treva e Dibrës është shpërngulur rreth 45% e popullsisë dhe po të shpërngulen edhe 30 mijë banorë të tjerë do të thotë që Dibra çpopullohet. Atë që nuk e kanë bërë armiq të po e bëjnë pushtetarët tanë. E kujt i shërben kjo? Vetëm antishqiptarëve.



Pamje nga punimet në Skavicë. Foto: Majlinda Hoxha

Nga **KADRI DAUTI**

HEC-i i Skavicës ka një histori mbi 60 vjeçare mjaft të debatuar. Ideja për këtë projekt ka nisur që në 1957 dhe sot përbën një çështje serioze për Dibrën dhe interesat kombëtare. Lidhur me të janë dy palë: njëra anë qëndron qeveria, që niset vetëm nga interesi i ditës dhe nga ana tjetër populli dibran, atdhetar e patriotik, autokton, i mbron me shpirt trojet e veta, historinë, etnokulturën e krahinës dhe interesin kombëtar.

HEC-I I SKAVICËS ËSHTË I DOBISHËM

Nisja e punimeve më 2 tetor 2021 për ndërtimin e HEC-it të Skavicës nga kompania amerikane "Bechtel" fakton qëndrimin antikombëtar të qeverisë së sotme, qartësisht e korruptuar dhe e papërgjegjshme. Pavarësisht kundërshtive dhe protestave të shumta e të herëpashershme të popullsisë së zonës dhe të dibranëve, pavarësisht petitionit të drejtuar nga dibranët, kompania vazhdon punimet për ndërtimin e HEC-it.

Projekti lidhet me shumë probleme ekonomike, shoqërore, sociale, mjedisore, historike, kulturore, gjeopolitike, interesat kombëtare etj. Por siç duket për qeverinë nuk kanë asnjë rëndësi këto probleme të mëdha për Dibrën, popullsinë e fshatrave që përmyt liqeni i këtij HEC-i dhe fshatrat përreth. Për kryeministrin Rama nuk kanë asnjë rëndësi se zhduken 34 fshatra dibrane, gjurmët arkeologjike të vendbanimeve të lashta, varrezave të të parëve të banorëve të këtyre fshatrave, pyjet, shpërngulen të paktën 15 mijë banorëve, humbasin 12-15 mijë ha tokë bujqësore që do prodhonte të paktën 100 milionë euro në vit, pa llogaritur të tjerat. Ramës i intereson vetëm teka, egoizmi i tij dhe qoka që duhet t'i bëjë kompanisë "Bechtel" dhe ndoshta ndonjë qeveritar që mbush xhepat.

Nuk ka një studim tekniko-ekonomik, nuk ka një kosto të vërtetë ekonomike për projektin e HEC-it, sepse nuk i intereson kjo

një qeverie antikombëtare. Sidoqoftë, asnjë kosto nuk ka vlerë para kostos historike, arkeologjike, etnologjike, kulturore të kësaj treve. Më kot mundohen pushtetarët që të japin shifra përfitimi. Asgjë nuk përfitohet, veçse humbet gjithçka. Humbet Dibra, humbet Shqipëria.

Projekti zyrtar i aprovuar me vendim qeverie të vitit 1961 dhe i ratifikuar në 2 marrëveshjet e ujërave me Jugosllavinë të vitit 1956 dhe 1961, nuk u ndërtua nga regjimi i atyre viteve, për arsyen se ishte i padobishëm ekonomikisht dhe gjeopolitikisht. Qeveria e asaj kohe, e përgjegjshme për misionin e saj në shërbim të vendit, të interesave kombëtare dhe të popullit, nuk e miratoi ndërtimin e këtij hidrocentrali se dëmtonte rëndë historinë, etnokulturën, mjedisin, shkatëron Dibrën.

Dëmi më i madh shkaktohet jo në planin ekonomik, por atë gjeopolitik, historik e etnokulturor. Sepse do shpërbëhej Dibra si trevë etnokulturore; Dibra e Poshtme nuk do ekzistonte më. Dibrën e sakatoi Konferenca e Londrës duke e ndarë në dy pjesë në 1913. Ajo ndau Dibrën e Sipërme nga trungu amë, duke lënë pjesën juglindore të Dibrës në Maqedoni. Ndërtimi i HEC-it do bëjë që të mos "kishte më as Dibrë dhe as Nantë Malet e Dibrës të traditës së hershme etnike." Do shuhet kështu një trevë që ka qenë historikisht në qendër të historisë dhe trashëgimisë së kombit shqiptar. Tani u dashka ta zhduk qeveria e vetë, njëllon si të ishte armikja e Dibrës dhe Shqipërisë. Duke ndërtuar HEC-in e Skavicës, Dibra do të zhdukej, lugina e Drinit të Zi do të zhdukej përgjithmonë. Nga 149 km gjatësi e përgjithshme e luginës mbi 92 km ose mbi 62% e saj (nga 30% që është tani) do mbytej nga uji dhe gradualisht do tjetërsohej.

Në anën e Maqedonisë, dy hidrocentralet e ndërtuara kanë mbytur përgjithmonë toka të shumta dhe objekte historike si urën e Spiles (e njohur si Ura e Vezirit), e njohur për arkitekturën e saj dhe luftërat heroike të dibranëve kundër pushtuesve osman dhe serb.

Kujtojmë se qeveria maqedonase, për interesat kombëtare të atij shteti, ndërtoi kanale për të marrë ujë e Radikës së Sipërme dhe dërguar në liqenin e Mavrovës duke dëmtuar të prurjet e të lumit Drini i Zi. Ndërsa qeveria shqiptare thajse nuk reagoi ndaj kësaj padrejtësie jo vetëm ekologjike, por edhe ndaj interesave kombëtare shqiptare.

Për projektin e HEC-it të Skavicës nuk është bërë as studimi i fizibilitetit, që të argumentohet dobia e tij. Ose më saktë, nuk duhet bërë sot, se e kanë bërë specialistët në vitet 80-të dhe ka rezultuar projekt i padobishëm, sepse siç argumentojnë ekspertët, "ndërtimi i një rezervuari kaq të madh do të sillte pasoja të rënda në mjedis dhe në ekosistem, ndërsa popullata e zhvendosur do të vuajë pasojat sociale". Pretendimet e qeverisë se HEC-i i Skavicës se "ai e shlyen vlerën e investimit brenda dekadës së parë pas vënies në funksionim" apo "do të ketë ndikim në operimin e të gjithë kaskadës" janë vetëm justifikime, propagandë për qëllime përfitimi të vetë qeverisë dhe kompanisë amerikane. Aq sa të turpshme argumente të tilla se do ketë punësim, do zhvillohen sektorë të tjerë të ekonomisë, si turizmi apo peshkimin, një infrastrukturë të përmirësuar.

Është cinike dhe fyerje e rëndë për dibranët dhe shkodranët e Lezhianët kur thuhet se do reduktohen përmytjet në zonën e Nën-Shkodrës dhe Lezhës. Pra, Dibra kurban për Shkodrën e Lezhën. Argumenti për mos përmytjen e Shkodrës dhe Lezhës është një tjetër justifikim bajat, se në kohën e sistemit një partiak të njëjtat prurje të Drinit të Zi ishin dhe ato nuk përmytreshin.

Në territorin e Dibrës janë ndërtuar dhjetëra hidrocentrale të vegjël si ai i Setës, i Okshtunit, i Lladimericës, i Tuçepit, i Ostrenit të Vogël, i Trebishtit, i Strikcanit, Krajkës etj., që padyshim ka dëmtuar faunën e florën e kësaj treve, ka prishur ekuilibrat mjedisorë. Shkurt, ndërtimi i HEC-it të Skavicës është shkatërrimi i Dibrës.

30 vitet e fundit nga treva e Dibrës është

shpërngulur rreth 45% e popullsisë dhe po të shpërngulen edhe 30 mijë banorë të tjerë do të thotë që Dibra çpopullohet. Atë që nuk e kanë bërë armiq të po e bëjnë pushtetarët tanë. E kujt i shërben kjo? Vetëm antishqiptarëve.

Projekti për ndërtimin e HEC-it të Skavicës nuk është projekt me interes kombëtar. Ndërtimi i HEC-it përmyt një nga vendbanimet më domethënëse të historisë tonë kombëtare, vendlindjen e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeut. Qeveritarët shqiptarë nuk duan ta dinë se ndërtimi i HEC-it të Skavicës zhduk rrënojat historike të krahinës, vendbanim që nga koha e Neolitit të hershëm. Kjo është e pamoralshme, e papranueshme.

MARRËVESHJA PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT ANTI-KUSHTETUESE, ANTIKOMBËTARE

Ndonëse HEC-i i Skavicës është realisht i padobishëm ekonomikisht dhe shumë i dëmshëm historikisht e etnokulturalisht, më 3 tetor 2020, qeveria shqiptare ka nënshkruar një marrëveshje me kompaninë amerikane "Bechtel" për ndërtimin e HEC-it të Skavicës. Duket hapur se qeveria nuk mbron interesat e vendit, ndaj dhe procedurat e kryera për këtë janë jotransparente, më saktë korruptive. Po të ketë vërtet qeveria vullnet të mirë, po të ndërtohen projekte efektive për shfrytëzimin e potencialeve të vendit të energjisë diellore dhe të erës në Shqipëri mund të ndërtoheshin vepra prodhimi energjie që jo vetëm do sigurohen nevojat e vendit por do eksportohej jashtë. Duket hapur që qeveria nuk e ka hallin vërtet te prodhimi i energjisë. Asaj i intereson tenderi.

Nuk është marrë mendimi i popullit të Dibrës, as dakordësia e banorëve të fshatrave që përmyten, që u mohohet vendlindja, shtëpia, prona e tyre, që është një shkelje e hapur e të drejtave të tyre kushtetuese. Ka dy dekada që dibranët protestojnë me të drejtë kundër ndërtimit të HEC-it. Por zëri i tyre bie në vesh të

dhe interesave kombëtare

Projekti për ndërtimin e HEC-it të Skavicës nuk është projekt me interes kombëtar. Çdo dibran i ndershem e atdhetar, çdo shqiptar duhet të ngrihet në mbrojtje të luginës së Drinit të Zi, kundër ndërtimit të HEC-it të Skavicës, kundër marrëveshjes së 3 tetorit 2020. Indiferentizmi, heshtja ndaj kësaj çështje është vrasare për Dibrën dhe Shqipërinë. Drini i Zi duhet të mbetet ashtu natyror siç është të paktën tani. Ai nuk është vetëm i dibranëve, por i gjithë shqiptarëve. Lumi Drini i Zi është lumi krenar i trojeve shqiptare, që e kemi trashëgim nga paraardhësit tanë ilirët, arbërit. Ndaj mbrojtja e kësaj pasurie është detyrë e çdo shqiptari atdhetar.

shurdhër për shkak të interesave të dikujt në pushtet dhe me të cilën qeveria shqiptare ka nënshkruar një marrëveshje më 3 tetor 2020 për ndërtimin e HEC-it të Skavicës. Sikurse është shprehur Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi në një petition drejtuar institucioneve më të larta shtetërore e Ambasadës Amerikane, "Marrëveshja ... është krejtësisht e paligjshme, antishqiptare dhe antikombëtare. Marrëveshja bie ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë edhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut", e cila theksohet se "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ...". Marrëveshje të tilla mund të lidh vetëm një qeveri antishqiptare, antikombëtare; një qeveri që nuk është besnike ndaj vendit dhe interesave kombëtare.

Në këtë drejtim qeveria përdor dy standarde. Para lidhjes së kësaj marrëveshjeje, qeveria ka miratuar një vendim për mbrojtjen e lumit Vjosa si park natyror dhe e ka axhendë që ta shpall park kombëtar. Përse nuk ndodh kështu edhe me lumin Drini i Zi, që është lumi më i madh dhe më i pasur në histori, etnologji, arkeologji dhe gjeografi në Shqipëri?

Qeveria e vitit 2008 nuk e lejoi ndërtimin e këtij hidrocentrali. Por edhe në vitin 2017, në emër të qeverisë, Gjijnuri u tha dibranëve se "nuk do të ndërtohet hidrocentrali i Skavicës", sepse kuptoi dëmin e madh që i bëhej Dibrës dhe Shqipërisë



nga ndërtimi i kësaj vepre, pa vullnetin e popullit dibran.

ÇDO SHQIPTAR NË KËMBË PËR MBROJTJEN E LUGINËS SË DRINIT TË ZI

Projekti për ndërtimin e HEC-it të Skavicës nuk është projekt me interes kombëtar. Çdo dibran i ndershem e atdhetar, çdo shqiptar duhet të ngrihet në mbrojtje të luginës së Drinit të Zi, kundër ndërtimit të HEC-it të Skavicës, kundër marrëveshjes së 3 tetorit 2020. Indiferentizmi, heshtja ndaj kësaj çështje është vrasare për Dibrën dhe Shqipërinë. Drini i Zi duhet të mbetet ashtu natyror siç është të paktën tani. Ai nuk është vetëm i dibranëve, por i gjithë shqiptarëve. Lumi Drini i Zi është lumi krenar i trojeve shqiptare, që e kemi trashëgim nga paraardhësit tanë ilirët, arbërit. Ndaj mbrojtja e kësaj pasurie është detyrë e çdo shqiptari atdhetar.

Çështja nuk shtrohet kush do fitojë në këtë betejë: populli i Dibrës apo qeveria. Interesi kombëtar është mbi gjithçka. Më shumë se energjia, Shqipërisë i duhet Dibra dhe dibranët. Energjia fitohet, por Dibra asnjëherë më. Dibranëve nuk mund tu mohohet e drejta e tyre themelore: të jetojnë në truallin dhe të gëzojnë trashëgiminë e tyre historike e etnokulturore. Prandaj, në këtë betejë duhet dhe do fitojnë dibranët.

Pushtetarët tanë janë të pandershëm, nuk janë patriotë, që të mbrojnë interesat tona të mëdha, kombëtare. Këta të korruptuar, të papërgjegjshëm, që nuk i vret ndërgjegjja për asgjë, nuk do të marrin nëpër këmbë dot Dibrën dhe dibranët.

Propaganda e tyre, fryt i reminishencave të natyrës së tyre djallëzore, kërkon t'a mashtrorjnë opinion publik, duke theksuar djallëzisht aspektin ekonomik; synon të përligj aferën e tyre korruptive dhe të padobishme. Por dibranët, që kanë mbrojtur me gjakun e jetën e tyre trojet e të parëve të tyre, do bashkohen dhe do dinë ta mbrojnë edhe nga pushtetarët tanë keqbërës.

Qeveritë janë të përkohshme dhe kanë interesat e ditës e të forcës politike që përfaqëson, jo interesat e përhershme kombëtare. Qeveria shqiptare nuk mund të injorojë dhe sakrifikojë trevën e Dibrës, këtë pasuri gjeopolitike, historike dhe etno-kulturore e rëndësishme të kombit shqiptar, me kontribute të mëdha. Nuk ka të drejtën legjitime të nëpërkëmbë vlerat e Dibrës në historinë e çështjet kombëtare. Se energjia elektrike mund të përfitohet në forma të tjera që janë të bollshme në Shqipëri: energji diellore, të erës apo gjeotermike. Kjo vepër do ketë një jetëgjatësi deri në 100 vite dhe vdes, nuk prodhon më energji. Porse Dibra dhe Shqipëria do të ekzistojnë përjetë. Dhe nëse shpërbëhet treva e Dibrës humb një herë e përgjithmonë gjithë kjo trashëgimi e madhe kombëtare, humb Dibra, humb Shqipëria. E çfarë u lemë pastaj brezave që do vijnë?!

Reagimet, deklaratat, protestat e popullit, aktivistëve, intelektualëve, shoqatave dibrane, OJQ-të apo organizatave mjedisore në mbrojtje të Drinit të kanë qenë të vijueshme, por duket se nuk kanë dhënë efektin e duhur për pezullimin e ndërtimit të HEC-it. Qeveria duket moskokëçarëse ndaj këtij problemi madhor, sepse nuk është pezulluar vendimi i qeverisë për të. Duhet një reagim më i ashpër domosdo, më shumë veprim. Është imperative kalimi në revoltë popullore për kauzën e tyre deri në anulimin e vendimit të qeverisë dhe ndalimin e ndërtimit të HEC-it të Skavicës. Për këtë kauzë të kërkohej mbështetja nga organizatat ndërkombëtare si Riverwatch, EuroNatur, WWF Adria, Westland International Europe, International Rivers dhe The Nature Conservancy etj., të cilët kanë mbështetur edhe mbrojtjen e lumit Vjosa.

Format e veprimit duhen të gjithanshme, deri të paditja e këtij vendimi në gjykatën kushtetuese, si një vendim që shkel interesat kombëtare dhe shkel të drejtat e qytetarëve, të popullit dibran për jetën dhe pronën. Në mbështetje të Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi duhet të mblidhen gjithë dibranët, shoqatat atdhetare dibrane e shqiptare.

Drini i Zi duhet mbrojtur medoemos. Për vlerat natyrore, arkeologjike, historike, etnike e kulturore që mbart luginë e Drinit të Zi, ajo duhet të shpallet "Par Kombëtar", sikurse lumi Vjosa. Dibra duhet mbrojtur me çdo kusht nga sipërmarrja antikombëtare e qeverisë. Kështu i shërbejmë Dibrës, interesave kombëtare dhe brezave që do vijnë. Ky është një status ndërkombëtar që e mbron përfundimisht luginën e Drinit të Zi dhe Dibrën nga dëmtimet që mund t'i bëjnë qeveritë e sotme dhe ato ardhme apo bizneset kushdo qofshin.

Le tua lemë brezave tanë këtë luginë të bukur dhe këtë pasuri të vyer, këtë trevë fisnike e të çmuar të kombit, të historisë, etnisë dhe kulturës tonë kombëtare.

Jemi shtet demokratik.

Jo HEC-it të Skavicës! Po Dibrës!

Tiranë, më 03 gusht 2022

Ngjasime

Diga e Skavicës – gjëja e fundit që i duhet Shqipërisë



Një pjesë e zonës që do të përmyte nga hidrocentrali i Skavicës. Foto: Andrey Ralev, bankwatch.org

Projekti i hidrocentralit të Skavicës përfshin një digë të madhe të ndërtuar në një grykë të pacenuar me shkëmbinj të lartë pranë fshatit Skavicë në bashkinë e Kukësit. Ndikimet më të theksuara do të ishin në bashkinë Dibrë. Rezervuari i madh do të ndikojë, sipas bashkisë, deri në 15,138 hektarë (58 mijë katrorë) tokë, kryesisht tokë bujqësore dhe pyje, por edhe 41 fshatra. Me disa mijëra njerëz të zhvendosur, Skavica mund të ketë ndikimet më të këqija sociale nga çdo digë e ndërtuar në Evropë në shekullin e 21-të.

Deri më tani, nuk ka asnjë informacion zyrtar për projektin dhe vendndodhjen e digës, pasi vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) pritet të përfundojë në fund të vitit 2022. Por sipas promotorit të projektit, Korporata Energjetike Shqiptare (KESH), diga ndoshta do të jetë 147 metra e lart.

Lexo shkrimin e plotë në lidhjen më poshtë ose skano QR Code: <https://www.bul-qizaima.al/diga-e-skavices-gjeja-e-fundit-qe-i-duhet-shqiperise/>



Mbytja e Dibrës si harresë që vret



Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

A e din Konventa e Bërnës ku bie Dibra që mbytet e zhduket përgjithmonë?

Sigurisht nuk e din dhe dibranët nuk kanë as gojë që të flasë e bërtasë e as laps që të shkruaj dhe të tregojë se në qendër të hartës së shqiptarëve autoktonë në mijëvjeçarë ka një krahinë që quhet DIBRA, krahinë që u tha pushtuesve osmanë "deri këtu ishte hapi i juaj", krahinë që e mbrojti vendin e vogël evropian me tehun e shpatës në 18 beteja nga 24 beteja fitimtare të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, krahinë ku me pushkë hodhi në Drin pushtuesin serbo-jugosllav në një betejë epike 101 vjet të shkuara, më 26,27,28 tetor 1921, në Lanë të Lurës. Krahinë me luginën më të bukur e pjellore të lumenjve të Shqipërisë, Luginën e Drinit të Zi që mbante me bukë e me barut banorët punëtorë e trima që në histori ndërtuan Stambollin por Stambolli nuk ndërtoi asgjë.

Lexo shkrimin e plotë në lidhjen më poshtë ose skano QR Code: <https://bulevard-ionline.com/mbytja-e-dibres-si-harrese-qe-vret-perditesim/>



Pse duhet të krijohet Bashkia e Kalabardhës?

Nga Kadri DAUTI

1. SFONDI HISTORIK

Kalabardha (e njohur si Golloborda) është një krahinë entnokulturore më vete, shumë e njohur në rajonin e Dibrës dhe gjithë Shqipërinë për karakteristikat e saj kulturore, gjuhësore, etnografike, historike etj. Ajo ka qenë e banuar që në kohërat e lashta antike iliro-romake, të cilën e tregojnë dhe rrënojat arkeologjike të qytetërimeve antike. Sidomos në periudhën e mesjetës, kjo krahinë ka pasur një popullsi shumë të madhe, falë dhe zhvillimit ekonomiko-social që kishte lugina e Drinit të Zi e lidhur me Selanikun, Ohrin, Dibrën, Prizrenin, Shkodrën etj.

Kalabardha, për vetë pozicionin e rëndësishëm dhe hapësirën e saj gjeografike të madhe, ka qenë historikisht njësi administrative më vete. Ajo ka qenë pjesë e rëndësishme e shtetit të Arbrit. Në vitin 1467, Kalabardha bënte pjesë në Dibër të Sipërme dhe ishte vilajet më vete; që në shekujt 15-16-të, Kalabardha ishte njësi administrative e Sanxhakut të Dibrës, sikurse edhe Dibra e Sipërme dhe Dibra e Poshtme; në vitin 1583, Kalabardha ishte nahije e kazasë së Dibrës, sikurse edhe Dibra e Sipërme, Dibra e Poshtme dhe Reka; në shekullin e 19-të, pas reformave osmane, Trebishti ka qenë pothuaj kryeqendra e zonës, në të përfshiheshin fshatrat e Kalabardhës deri në Bulqizë; në fund të shekullit 19-të dhe fillim të shekullit 20-të, Klenja, që përfaqësonte Kalabardhën, ishte nahije e kazasë së Dibrës së Sipërme; në vitin 1912, Kalabardha përbëhej nga tre nahi të kazasë së Dibrës së Sipërme: Ostreni i Madh, me qendër Ostrenin e Madh; Sebishti, me qendër Sebishtin; Trebishti, me qendër Trebishtin; në periudhën nëntor 1918-1921, Kalabardha u organizua nënprefekturë (rreth), me seli në Trebisht, në përbërje të prefekturës Ohër, me 41 vendbanime, 15 000 banorë, ndahej në 5 komuna: Trebisht, Klenjë, Ostren i Vogël, Gjoricë, Zerqan, e cila shtrihet deri në fshatrat Zerqan, Godvi, Krajë, Velikardhë dhe Peladhi; pas 1947, shkrihen prefekturat, kur krijohen krijohen rrethet dhe lokalitetet, Kalabardha bënte pjesë në rrethin e Shupenzës, me 6 lokalitetet e saj: Gjorica e Sipërme, Lladimerica, Trebisht-Muçina, Klenja, Ostreni i Madh dhe Okshtuni i Madh, pas vitit 1955, Kalabardha kishte dy lokalitete: Klenjë dhe Ostren; pas shkurtit 1967, me riorganizimiin e ri, ku krijohen “Fshatrat e Bashkuar”, Kalabardha kishte dy lokalitete: Klenjë, me 11 fshatra dhe lokaliteti Ostren, me 13 fshatra etj.

Kalabardha është shumë e pasur me vlerat e saj kulturore dhe artistike. Doket, zakonet, kostumet popullore janë një pasuri e madhe e kësaj zone. Kështu, banorët e Kalabardhës kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e artit, pikturës, shkencës, arsimit, sportit, gazetarisë në rajonin e Dibrës e gjithë Shqipërisë. Mbrojtja dhe mbajtja e kësaj kulture tradicionale të krahinës, si vlerë të shtuar në kulturën tonë kombëtare, kërkon angazhim dhe veprimtari konkrete të institucioneve lokale e vendore.

Banorët e Kalabardhës shquhen për mjeshtërinë e tyre në ndërtimtari, si mjeshtërit më të mirë në gjithë vendin. Kjo ka bërë që karakteristike për banorët e Kalabardhës të jetë dhe migrimi dhe emigrimi që nga qytetet më të mëdha të Shqipërisë si Tirana, Elbasani, Durrësi, Fieri, Lezha, Peshkopia, por dhe në Greqi, Bullgari, Turqi, Itali, Angli etj., duke punuar në veçanti në fushën e ndërtimit.



Një propozim - dy qëndrime

Shoqata Atdhetares Kulturore Artistike “Hazis Lila” i ka dërguar një shkresë Kuvendit të Shqipërisë ku i kërkon, që në kuadrin e rishikimit të reformës territoriale, të marrë parasysh edhe krijimin e një bashkie të re në Qarkun e Dibrës, të cilën ata e quajnë “Bashkia e Kalabardhës”.

Sipas kryetarit të kësaj shoqate, z. Kadri Dauti, kjo bashki duhet të krijohet nga njësitë administrative Ostren, Trebisht dhe Steblevë. Qendra e kësaj njësie administrative, sipas Dautit dhe shoqatës që ai përfaqëson, duhet të jetë Ostreni i Madh.

Dauti thotë se kjo nismë vjen pas një sërë konsultimesh me banorët e krahinës së Gollobordës, në kuadrin e reformës territoriale që po ndërmerret, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar dhe traditës etnokulturore, zhvillimin ekonomik të zonës dhe përmirësim të kushteve social-ekonomike e kulturore për popullsinë.

Emërtimi i kësaj Bashkie me emrin e Kalabardhës, është një rikthim në historinë që i takon kësaj krahine.

Dauti e argumenton qëndrimin e tij në shkrimin shoqëruar të gazetës. Por, ndërkohë që ky numër i gazetës ishte duke u përgatitur për botim, dy shoqatat e tjera të kësaj krahine, “shoqata “Golloborda” dhe Shoqata për Zhvillimin e Steblevës, kërkojnë krijimin e një bashkie të re në qarkun Dibër, atë të Gollobordës, me pretendimin e përkatësisë etnike të banorëve të zonës”, njofton media online bulqiza.al.

“Një kërkesë e tillë është depozituar në Komisionin për Reformën Territoriale dhe pak ditë më parë përfaqësuesit e këtyre dy shoqatave dhanë edhe sqarimet përkatëse para deputetëve. Për formimin e kësaj bashkie është kërkuar që të bashkohen tre njësi administrative; Ostren, Trebisht që sot janë pjesë e bashkisë Bulqizë dhe Steblevë, pjesë e bashkisë Librazhd”.

Siç shihet, shtrirja territoriale është e njëjtë për të dyja propozimet, por qëllimet janë të ndryshme: njëra kërkon kthimin në identitetin shqiptar dhe tjetra kërkon regjistrimin si pakicë maqedonase.

Vendimi nëse do të krijohet njësia e re administrative mbetet në vullnetin e deputetëve.

2. POZITA GJEOGRAFIKE

Njësia Bashkiake Kalabardhë, që propozohet, shtrihet në jug-lindje të Bashkisë Bulqizë dhe veri të Bashkisë Librazhd. Ka një shtrirje gjeografike rreth 350 sipërfaqe mbi 24.000 Ha tokë të punuar, me një terren kryesisht kodrinor-malor. Nga Lindja kufizohet me kufirin shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Jugu me Bashkinë Librazhd dhe nga veriu me Bashkinë Bulqizë.

Zona përbëhet nga 25 fshatra dhe përshkohet nga rruga nacionale Peshkopi-Librazhd. Kryeqendra e bashkisë, Ostreni i Madh ndodhet 60 km larg qytetit të Peshkopisë, 50 km larg qytetit Bulqizë dhe 45 km larg qytetit Librazhd, rrugë që akoma është rurale, por ka përfunduar projekti dhe ka filluar asfaltimi

i saj nga Librazhdi.

Klima është kontinentale malore, me dimër të gjatë dhe të ashpër, me reshje dëborë përgjatë gjysmës së vitit dhe me verë të freskët e të thatë. Temperatura shkon më e ulta -17°C në dimër dhe më e larta në verë deri në 28°C, dhe reshjet e dëborës arrijnë deri 2m duke e bllokuar shpesh zonën.

3. POZITA ADMINISTRATIVE

Me ligjin nr. 7572, datë 10 qershor 1992, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” në Kalabardhë u ngritën tre komuna: Ostren i Madh, Trebisht dhe Steblevë. Krahina që deri atëherë përfshihej në rrethin e Dibrës, u nda në dy pjesë: komunat Ostren i Madh dhe Trebisht ishin administativisht me

Krijimi i “Bashkisë Kalabardhë” është domosdoshmëri për zhvillimin e zonës dhe nevojë jetike për popullsinë e fshatrave të kësaj zone. Duke qenë njësi e vetëqeverisjes vendore, me autonominë e saj vendore krahina do rregullojë dhe administrojë pjesët thelbësore të çështjeve publike, nën përgjegjësinë e saj dhe në interes të bashkësisë, duke zgjidhur shumë probleme social-ekonomike dhe rritur mirëqenien e banorët e zonës.

Bashkinë Bulqizë, ndërsa komuna Steblevë me bashkinë Librazhd.

Me reformën e re administrative, sipas ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativ-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, tre komunat ekzistuese, Ostren i Madh, Trebisht dhe Steblevë u kthyen në njësi administrative, duke humbur qeverisja vendore e krahinës. Humbja e pushtetit të këshillave lokalë, si organ ekzekutiv të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, mungesa e organit vendimmarrës për zonës, mungesa e vullnetit të mirë e të duhur nga bashkitë Bulqizë dhe Librazhd për politika social-ekonomike të duhura për zonën, mungesa e fondeve financiare si rrjedhim i përqendrimit të tyre në zonat me influenza personale etj. kanë sjellë probleme serioze dhe të rënda ekonomike e sociale në zonë dhe për popullsinë e fshatrave.

Pra, nëse në vitin 1992 me ndarjen e pushteteve, Ostreni, Trebisht dhe Stebleva ishin pjesë e nivelit të parë të qeverisjes vendore, sot nuk janë më pjesë e nivelit të parë të qeverisjes vendore. Kështu, ndarja administrative e deritanishme ka rezultuar e dështuar, rrënuese dhe diskriminuese për krahinën e Kalabardhës.

4. POPULLSIA

Kalabardha ka një popullsi rreth 6.500 banorësh ose rreth 2.000 familjesh, e përqendruar në 25 fshatrat e zonës. Popullsia e Kalabardhës është tërësisht me etni të pastër dhe me ndjesi shqiptare, pavarësisht spekulimeve të qarqeve nacionaliste sllave. Ata kanë origjinë të pastër iliro-arbërore, për mbrojtjen e së cilës kanë luftuar historikisht kundër pushtuesve sllavë. Kujtojmë veçanërisht luftërat që kanë zhvilluar kalabardhasit kundër serbëve dhe bullgarëve gjatë luftës së parë e të dytë Ballkanike dhe gjatë luftës së parë Botërore, ku fshatrat e Kalabardhës u dogjën tre herë nga serbët dhe një herë nga bullgarët, ku u vranë e masakruan qindra djem e vajza e pleq të pafajshëm vetëm se ishin shqiptarë, ku u grabitën pothuaj e gjithë bagëtia etj. Qëndresa e kalabardhasve për mbrojtjen e trojeve të veta stërgjyshore ka qenë heroike.

Lëvizjet demografike, të cilat janë karakteristike për rajonin e Dibrës, për krahinën e Kalabardhës kanë qenë të larta. Kryesisht lëvizja ka pasur tendencën drejt qendrës metropolitane në Tiranë e Durrës, por edhe drejt zonave të ulëta ku janë vendosur kryesisht në zonat periferike të tyre.

Është paradoks që ata që ndërtuan Shqipërinë, ata që krijuan shkollën shqiptare të ndërtimtarisë sot po braktisin vendlindjen e tyre për shkak të mungesës së politikave të duhura social-ekonomike dhe keq admin-

Duke qenë një unitet administrativo-territorial, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale, Kalabardha do ribashkohej si njësi etnokulturore më vete dhe do rivitalizoj kjo krahinë e shquar atdhetare e patriotike shqiptare.

istritimit të zonës. Kujtojmë se Kalabardha ka pasur 11 heronj të punës dhe dhjetëra laуреатë, nën drejtimin e të cilëve janë ndërtuar mbi 400 vepra më madhore të vendit gjatë viteve 1945-1990.

4.1. PUNËSIMI

Popullsia merret kryesisht me blegtori, bujqësi, mbledhje bimësh aromatike dhe medicinale. Emigrimi është baza më e madhe e punësimit. Kryesisht emigrantët punojnë në ndërtim, bujqësi dhe shërbime.

Në tre njësitë administrative janë të regjistruara janë 16 subjekte private, kryesisht në shërbime dhe tregti. Familjarët dalin në treg javor në zonë, i cili organizohet çdo të enjte në Ostren të Madh me produktet e tyre blegtorale të bëra në shtëpi dhe ku vijnë dhe shesin produktet industriale dhe tregtare nga Shupenza, Zërqani, Bulqiza dhe Peshkopia.

Me qëllim zhvillimin e zonës dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë nevojitet një politikë e mirëfilltë punësimi e banorëve, në përshtatje me resurset natyrore, njerëzore dhe kulturore të zonës.

4.2. SHËRBIMI SHËNDETËSOR

Në qendrat e njësive administrative funksionojnë formalisht qendra shëndetësore. Qendrat nuk është e pajisur mirë, nuk kanë auto-ambulancë, si dhe nuk kanë shërbim stomatologjik. Në disa fshatra ekzistojnë formalisht ambulancat, por mungon personeli mjekësor. Për mungesë mjekësh dhe për një vizitë mjekësore banorët e fshatrave detyrohen të ikin në Bulqizë, Peshkopi, Librazhd apo Elbasan.

Nevojitet domosdoshmërisht krijimi i një shërbimi shëndetësor efikas për popullsinë e kësaj krahine.

4.3. EKONOMIA LOKALE

Ekonomia lokale kryesisht bazohet në burimet natyrore dhe në menaxhimin e tyre në formë tradicionale. Dega kryesore e ekonomisë lokale është blegtorja dhe bujqësia.

Zona është shumë e pasur me burime natyrore. Malet dhe kodrat janë të gjelbëruara dhe të bukura si një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit, pasi shumë pasionantë dhe vizitorë të ndryshëm i frekuentojnë këto ambiente të bukura malore, përreth të cilave ka pyje, livadhe, burime uji. Ka mbi 70.000 ha pyje të mbrojtura, kryesisht me dushk, ah, pishë e zezë dhe pishë e bardhë si dhe 560 ha kullota. Këto pyje nuk janë dëmtuar dhe ruhen me fanatizëm nga banorët e zonës. Gjithashtu, ka shumë bimë medicinale që rriten në këto pyje. Këto pyje janë të dëmtuar dhe janë faktorë kryesor për erozionin e madh në këtë zonë.

Zona ka dhe burime ujore si burimet e Tuçepit, ku është dhe kanali i madh vaditës, i cili përdoret për vaditje jo vetëm nga njësia administrative Ostren, por dhe nga fshatrat e njësive administrative Gjoricë, si dhe janë ndërtuar tre hidrocentrale. Zalli i Okshtunit është i pasur jo për vetëm me sasi të konsiderueshme uji por dhe me inerte. Në të janë ndërtuar 3 hidrocentrale të tjerë.

Fauna e zonës është shumë e pasur me lloje të ndryshme gjallesash dhe kafshësh e shpendësh. Përmendim ujkun, ariun, derrin,



drerin, kaprollin, dhelprën, lepurin, shqiponjën, thëllëzën, pëllumbat e egër etj.

Bujqësia në zonë nuk përbën degë bazë, por një faktor ndihmës për ekonominë dhe të ardhurat e familjeve të kësaj krahine. Kulturat kryesore bujqësore që kultivohen janë patatja, misri, fasulja, jonxha, gruri, thekra si dhe disa lloje drurësh frutorë si molla, qershia, kumbulla, arra, gështenja e tjerë. Kjo degë e ekonomisë ndeshet dhe me vështirësitë e tjera si kudo në Dibër, ku mungon mekanika, mungojnë farërat dhe pesticidet, ngastrat e vogla, gjë që bën të kemi një rendiment të ulët të prodhimtarisë bujqësore që për rrjedhojë dhe dalja në treg të jetë e vogël dhe të ardhurat për banorët dhe familjet e tyre të jetë e ulët.

Blegtorja ka qenë një nga degët që ka ecur më shumë kohët e fundit. Kjo për arsye se zona e ka pasur për traditë mbarështimin e blegtorisë, por edhe për shkak të rritjes së kërkesave të tregut për mish, produktet e qumështit, vezë dhe mjaltë. Shumë nga banorët e zonës mbarështojnë dele, gjedhë dhe mbajnë dhe bletë për mjaltë.

Infrastruktura dhe shërbimet janë pika më e dobët e njësive administrative, për të cilën mund të themi se mungon fare ose është në cilësi shumë të dobët shërbimi që i ofrohet komunitetit. Kjo për disa arsye: një pasi zona është parë si zonë e thellë, nuk janë investuar fonde në këtë drejtim, kanë munguar projektet dhe programet cilësore si dhe terreni është i vështirë dhe fshatrat janë larg nga njëri-tjetri.

Vetëm një plan konkret i mirë studiuar dhe i mbështetur me mjete financiare do mundësonte një ekonomi të mirë të zonës dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë.

5. DOMOSDOSHMËRIA E KRIJIMIT TË BASHKISË

Kalabardha përbën një krahinë më vete me lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale të përbashkët. Ajo ka qenë historikisht njësi administrative e pandarë, siç ka qenë deri në vitin 1993 në përbërje të rrethit Dibër. Reforma territoriale e 1992 e ndau atë në dy pjesë padrejtësisht, jashtë vullnetit të kalabardhasve.

Aktualisht zona dhe popullsia përballet me vështirësi të mëdha ekonomike dhe probleme të shumta shoqërore, sociale dhe kulturore, si: cilësia mjaltë e ulët e shërbimeve në njësitë administrative, infrastruktura e keqe, nuk ka asnjë metër linear rrugë të asfaltuar, shërbim jo i mirë arsimor dhe shëndetësor, mungesa e ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike, mungesa e projekteve dhe planeve zhvilluese e rregulluese bashkëkohore dhe të realizueshme, mungesa e investimeve, imazhi i keq demagogjik i krijuar nga sistemi i kaluar për zonën e thellë dhe e pazhvilluar, mungesa e burimeve të mjaftueshme humane, sidomos atyre profesionale, mospasja e një plani për zhvillimin e zonës dhe për zhvillimin e turizmit, çështjet e pronësisë të pazgjidhura. Banorët ndjehen të braktisur pothuaj nga çdo lloj shërbimi, jo vetëm për mungesën e aftësisë së administratave të bashkive aktuale, por edhe nga distanca e madhe nga qendra e Bashkisë, ku fshati më i afërt ndodhet 50 km larg Bulqizës, dhe më i largëti 70 km, që u duhet të lëvizim edhe

në rrugë në gjendje të mjeruar, si në mesjetë. Largimi i banorëve nga komuna për në zonat e tjera urbane dhe metropolitane, erozioni, kriza ekonomike globale mund të frenojë investimet e huaja etj.

Vitet e fundit ndjehet një rritje e konsiderueshme e interesit dhe investimeve të banorëve të shpërngulur për tu rikthyer në shtëpitë e tyre të braktisura në vendlindjet, por që ndeshën me vështirësitë e shërbimeve administrative dhe qytetare.

Krijimi i Bashkisë do të sjellë rrijetësim të krahinës, të vlerave të saj etno-kulturore dhe zhvillim ekonomik, social e kulturor të popullsisë së kësaj krahine. Sepse zona ka shumë faktorë që e favorizojnë zhvillimin e saj:

- ka pasuri të shumta natyrore, peizazh i mrekullueshëm malor, të cilat janë një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit malor dhe rural, ekologjik dhe kulturor, që do gjeneronin në të vërtetë të ardhura të larta për ekonominë lokale e rajonale;
- ka kullota të shumta, tradita në rritjen e të imtave, të cilat janë një mundësi e mirë për shtimin e prodhimit të qumështit dhe mishit, si dhe rritjes së të ardhurave;

• pyjet dhe bimët medicinale janë burim të ardhurash të mira për ekonominë e zonës dhe për banorët;

• karakteri punëtor, specialiteti në ndërtimtarë dhe shtegtimtarë i bën banorët e Kalabardhës të shfrytëzojnë mundësitë për të rritur të ardhurat si dhe duke zhvilluar e shfrytëzuar lëvizjen e lirë në vend dhe në Evropë;

• shtimi i fondeve nga qeveria qendrore për vendorët dhe programe e projekte të ndryshme që kanë në fokus zhvillimin e zonave malore dhe atyre rurale;

• programet e ambasadave të shteteve evropiane dhe të Bashkimit Evropian me Qarkun e Dibrës ku mund të përfitojë dhe bashkia me njësitë e saj administrative;

• asfaltimi i rrugëve, sidomos i rrugës nacionale Shupenzë-Librazhd mundëson lëvizjen e shpejtë për në qendrat urbane të Peshkopisë e Librazhdit si dhe me Elbasanin e Tiranën;

• pozita gjeografike e favorshme për bashkëpunim me bashki e rajone të tjera dhe me Maqedoninë ku mund të përfitohet nga bashkëpunimi ndërkufitar;

• tradita e pasur kulturore etj.

Zhvillimi i turizmit kulturor, rrijetëzim i një siti antik që mendohet se ka vlera, apo edhe nxitja e ngritjes së agro-turizmit, këto janë ëndrrat, apo si të thuash baza vizionare mbi të cilën qëndron kjo nismë e shoqatës që ka punuar mbi këtë projekt.

Bashkia Kalabardhë do jetë një njësi administrative e qeverisur mirë, me rrugë të rregulluara dhe me rrugën nacionale Peshkopi - Librazhd të asfaltuar, me rrjete ujësjellësish në shumicën e territorit të saj, me kanale të zeza të rregulluara, me shkolla në kushte normale për mësim, me qendër shëndetësore dhe ambulanca në çdo fshat ku ofrohet shërbim me cilësi.

Fshatrat e Ostrenit, Trebishtit, Klenjës, Steblevës, Borovës, Fushë Studës etj. do të jenë vende të bukura dhe për turizëm, nga të cilat do të vijnë të ardhura për banorët e zonës, të cilët do jetojnë në mirëqenie nga ekonomia e tyre dhe në fqinjësi të mirë e bashkëpunim

Kalabardha është shumë e pasur me vlerat e saj kulturore dhe artistike. Doket, zakonet, kostumet popullore janë një pasuri e madhe e kësaj zone. Kështu, banorët e Kalabardhës kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e artit, pikturës, shkencës, arsimit, sportit, gazetarisë në rajonin e Dibrës e gjithë Shqipërisë. Mbrojtja dhe mbajtja e kësaj kulture tradicionale të krahinës, si vlerë të shtuar në kulturën tonë kombëtare, kërkon angazhim dhe veprimtari konkrete të institucioneve lokale e vendore.

me komunitat dhe banorët e pjesës tjetër të krahinës së tyre në Maqedoninë fqinje.

Bashkia Kalabardhë do përbëhet nga tre njësi administrative aktuale, me 25 fshatra:

- Njësia Administrative Ostren me 12 fshatrat: Ostren i Madh, Ostren i Vogël, Orzhanovë, Kojavec, Lejçan, Okshtun, Oreshnjë, Radovesh, Lladimericë, Tuçep, Pasingë, Tërbaç;
- Njësia Administrative Trebisht, me 6 fshatrat: Klenjë, Gjinovec, Vernicë, Trebisht Bala, Trebisht Muçinë, Trebisht Çelebi;
- Njësia Administrative Steblevë, me 7 fshatrat: Steblevë, Borovë, Fushë Studë (Llangë), Zabzun, Sebisht, Moglicë dhe Prodan.

6. DOMOSDOSHMËRIA E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË KRAHINËS

Toponimia e sotme e krahinës “Gollobordë”, nuk është toponimi i lashtë, historik i saj. Emërtimi i lashtë, antik i saj ka qenë “Kalabardhë”, që do të thotë ata që ndërtojnë kalatë me të bardha, pra me gëlqere. Për qëllimet e veta zaptuese edhe të kësaj krahine, pushtuesit sllavë ia ndërruan toponimin historik të lashtësisë dhe mesjetës nga “Kalabardhë” në “Gollobordë”, sikurse kanë bërë edhe në zona e fshatra të tjerë të trojeve shqiptare. Përdorimi i këtij toponimi sllavë cenon rëndë imazhin e identitetit etnik të kësaj popullsie autoktone, të lashtë në trojet e veta iliro-arbërore, por edhe i shërben politikave nacionaliste të fqinjëve grabitqarë të Shqipërisë.

Ndryshimi i emërtimit të krahinës nga “Gollobordë” në “Kalabardhë”, i sjell identitet krahinës, është një hap që vjen në përputhje me interesat ekonomikë e socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore të kësaj krahine.

Kërkesa për ndryshimin e emërtimit materializon vullnetin e popullsisë së krahinës, pas një procesi të gjerë konsultimi me banorët dhe intelektualët e kësaj krahine.

PËRMBLEDHJE

Krijimi i “Bashkisë Kalabardhë” është domosdoshmëri për zhvillimin e zonës dhe nevojë jetike për popullsinë e fshatrave të kësaj zone. Duke qenë njësi e vetëqeverisjes vendore, me autonominë e saj vendore krahina do rregullojë dhe administrojë pjesët thelbësore të çështjeve publike, nën përgjegjësinë e saj dhe në interes të bashkësisë, duke zgjidhur shumë probleme social-ekonomike dhe rritur mirëqenien e banorët e zonës.

Duke qenë një unitet administrativo-territorial, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale, Kalabardha do ribashkohej si njësi etnokulturore më vete dhe do rivitalizoj kjo krahinë e shquar atdhetare e patriotike shqiptare.

* Autori është kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore Artistike “Haziz Lila”

Bilanc i qeverisjes vendore: **Arritjet** dhe **sfidat** e 4 bashkive që qarkut të Dibrës

Më 22 korrik 2022, në Pogradec, qeveria shqiptarë bëri një analizë të punës së bashkive të vendit, me rezultatet e arritura deri më tani dhe prioritetet kryesore me efekt elektoral për vitin në vazhdim.

Në fillim të analizës për Qarkun e Dibrës, Kryeministri Edi Rama u ndal në dy investimet kryesore në këtë qark, Rugën e Arbrit dhe hidrocentralin e Skavicës.

“Bëhet fjalë për dy projekte strategjike kombëtare: për Rugën e Arbërit, e cila sot funksionon, por siç e kemi thënë kur u hap, por mbetet për tu ndërtuar Tuneli i Murrizit, ndërtimi i të cilit ka kaluar përtej afatit të parashikuar si rezultat i formacioneve gjeologjike shumë problematike dhe për Skavicën, që është një projekt i një rëndësie strategjike kombëtare, por tanimë edhe në kushtet e krizës së madhe energjetike dhe të perspektivës jo fort të ndritur të sektorit të energjisë globalisht edhe në Europë, ka një rëndësi shumë të madhe për sigurinë energjetike edhe të rajonit”, tha kryeministri Rama.

BASHKIA KLOS: NUK KEMI PËR FITUAR NGA PROJEKTET E RILINDJES URBAE

“Në momentin e marrjes së detyrës, situata financiare në bashkinë Klos ishte shumë e vështirë, tha gjatë prezantimit Ilmi Hoxha, kryetar i Bashkisë Klos, pasi trashëgonte një borxh prej afro 22 për qind në totalin e buxhetit të saj”. Hoxha tha se gjatë vitit 2021 ky borxh ra në 12%, duke dhënë mundësi financiare që gjatë vitit 2022 të planifikoheshin investime të domosdoshme për komunitetin.

Hoxha kishte evidentuar pesë arritjet më të rëndësishme si: ndërtimi i ujësjellësit për 4 fshatrat në njësinë administrative Suç; rinovimi i palestrës dhe zonës së jashtme të shkollës 9-vjeçare në Klos; asfaltimi i rrugës Pleshë - Cërujë - Patin; rikonstruksioni i ujësjellësit të Klosit dhe zonave përreth si dhe dhe përmirësimi i shërbimit pastrimit dhe përmirësimi i shërbimit social.

Më pas Hoxha, tha se Klosi është një ndër bashkitë e para ku prioriteti ka qenë pastrimi. Në vitin 2020, pastrimi kryhej përmes një operatori ekonomik, por pas mbylljes së kontratës, tashmë këtë shërbim e kryen bashkia.

“Kjo ka rezultuar me shumë efikasitet duke e shtrirë pastrimin në gjithë territorin e bashkisë”, theksoi Hoxha. Gjithashtu ai theksoi se është rritur ndjeshëm shërbimi social dhe ka patur një trefishim të familjeve me bonus qiraje, jo vetëm për shkak të varfërisë, por edhe për shkak të tërmetit që preku territorin e bashkisë Klos.”

Kryetari i Bashkisë së Klosit evidentoi gjithashtu pesë ndërhyrjet më të rëndësishme në nivel qendror dhe vendor.

Në nivelin qendror ai kërkoi mbështetje për rikualifikimi urban të qytetit të Klosit.

“Në qytet të Klosit nuk është investuar në kuder të rilindjes urbane”, tha Hoxha, “ndaj shpresojmë që ta marrim këtë investim pasi do të jepte një ndikim pozitiv në qytetin tonë”.

Gjithashtu, ai kërkoi mbështetje për rikonstruksionin e shkollës së mesme në Suç të dëmtuar nga tërmeti i nëntorit 2019, ndërtimin e ujësjellësit rajonal për tetë fshatrat e njësisë administrative Klos, nga 12 njësi që ka bashkia, ndërtimin e ujësjellësit për njësinë administrative Xibër dhe ndërtimi i urës mbi lumin Mat, që lidh tre fshatra të njësisë administrative (NJA) Gurrë dhe dy fshatra të njësisë administrative Komsit të bashkisë Mat.



Në foto: Kryetarët e Bashkive të Qarkut të Dibrës: Nga e majta në të djathtë: Ilmi Hoxha-Klos, Agron Malaj-Mat, Rahim Spahiu-Dibër dhe Lefter Alla-Bulqizë.

Bashkia KLOS kërkon:

- Rikualifikimin Urban të qytetit
- Rikonstruksionin e shkollës së mesme në Suç
- Ndërtimin e ujësjellësit rajonal dhe Nj.A. Xibër
- Ndërtimin e urës mbi lumin Mat
- Qendra sportive, kënd lojrash dhe qendër sociale

Në nivel lokal Hoxha theksoi nevojën e ndërtimit të tregut në qytetin e Klosit, mjedisve dhe sportive të hapura, ndërtimin e një qendre për ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë, ndërtimi i një këndi lojërash për qytetin dhe ndërtimin e një segmenti rrugor të pambaruar të NJA Gurrë.

Sipas Hoxhës, investimet e mësipërme dhe ndërtimi i Qendrës Shëndetësore në NJA Xibër, janë një emergjencë për bashkinë e Klosit.

BASHKIA MAT: RRUGA URA E MATIT - MIRDITË JASHTË FUNKSIONIT, NUK ËSHTË MARRË AKOMA NË DORËZIM

Për një situatë të rënduar financiare foli edhe kryetari i Bashkisë së Matit, Agron Malaj, i cili theksoi se e ishin gjetur bashkinë me një borxh 47% të buxhetit. “Përveç uljes së theksuar të borxhit, kemi rritur edhe të ardhurat e bashkisë, duke e çuar borxhin në vitin 2021 në 27 për qind”. Malaj tha se pati një rritje të lehtë të borxhit prej 3.4 %, për shkak të borxheve dhe detyrimeve që vijnë nga faturat e prapambetura të krijuar në vite, por ishte besimplotë se gjatë vitit 2022 borxhi do të ulej ndjeshëm.

Ndër pesë arritjet më të rëndësishme të bashkisë Mat ai përmendi pastrimin e gjithë territorit të mbetjeve urbane përmes 30 hotspotëve. Ashtu si dhe Klosi, pastrimi tani është nën administrimin e Bashkisë, duke e shtrirë kështu shërbimin në rreth 77 për qind të territorit dhe brenda 2 viteve të ardhshme në gjithë bashkinë.

Malaj tha se ishin rehabilituar 412 km rrugë rurale dhe është krijuar një sektor me mbështetje me makineri speciale dhe këto rrugë do të mirëmbahen çdo vit. Gjithashtu janë rehabilituar kanalet vaditëse që për 30 viteve kanë qenë jashtë funksionit si dhe kanë një plan për të rritur nga 10 për qind situatën

Bashkia MAT kërkon:

- Rugën e re Mat - Mirditë
- Rivitalizimin e sheshit “A.Zogu”
- Ndërtimin e linjës së furnizimit me ujë të Burrelit
- Rikonstruksionin e unazës së madhe
- Rehabilitimin e kanaleve të ujërave të zeza të qytetit

e kanaleve vaditëse çdo vit.

Kryetari i Bashkisë së Matit theksoi edhe punën që është bërë në rikonstruksionin e blloqeve të pallateve, ndriçimin e qytetit si dhe të njësive administrative dhe pikave kyçe si ura, segmente kryesore etj.

Malaj tha se në nivel qendror, është i rëndësishëm rruga nga ura e Matit deri në Mirditë, e cila brenda 6 muajve doli jashtë loje dhe sot është në gjendje katastrofike. Kjo rrugë e ndërtuar në vitin 2011, nuk është marrë akoma në dorëzim.

Malaj kërkoi ndihmë nga qeveria për rivitalizimi i sheshit “Ahmet Zogu”, ndërtimin e linjës kryesore të furnizimit me ujë të qytetit të Burrelit, dhe rikonstruksionin e unazës së madhe të qytetit.

Në nivel lokal, tha Malaj, kemi rivitalizimin e shesheve, vendosjen e busteve të disa figurave historike të Matit, asfaltimin e rrugëve periferive të qytetit, ngritjen e një rrjeti inovacioni për të rinjtë, rikonstruksionin e tregut industrial dhe godinave zjarrfikëse etj.

Një nga aksionet më emergjente mbetet rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza të qytetit të Burrelit dhe rrethinave përfaq, sepse të gjithë këto ujëra të zeza bien në lumin Mat, e prej andej përfundojnë në liqenin e Ulzës, duke sjellë një dëm mjedisor në parkun natyror “Ulza Ecopark”, e cila ka sjellë një ndryshim rrënjësor në sektorin e turizmit.

Malaj përmendi edhe disa projekte në fushën e infrastrukturës sportive, duke rikthyer gjithë sportet si futboll, basketboll, volejbol, çiklizëm etj.

BASHKIA BULQIZË: INVESTIME NË INFRASTRUKTURË DHE RRJETIN ENERGETIK

Kryetari i Bashkisë së Bulqizës, Lefter

Bashkia BULQIZË kërkon:

- Rikonstruksionin e spitalit të Bulqizës
- Asfaltimin e rrugës së Martaneshit
- Ndërtimin e një landfilli
- Ndërtimin e dy shkollave të reja
- Ndërhyrje në përmirësimin e rrjetit të furnizimit me energji elektrike

Alla, në fillim të fjalës së tij theksoi se kishte marrë një bashki pa borxhe, por me mjaft problematika të ardhura nga ish-komunat. Si arritje më të rëndësishme ai përmendi dhënien e 3600 titujve të pronësisë si dhe është kryer regjistrimi fillestar i 43 mijë ha pyje dhe janë regjistruar 147 prona në emër të bashkisë, duke hapur rrugën zhvillimit të hapësirave publike.

“Një arritje e rëndësishme dhe vëmendje e veçantë nga ana jonë ka qenë furnizimi me ujë të pijshëm, tha Alla. Sot në Bulqizë dhe Krastë kemi 14 orë ujë në ditë, ndërsa në disa njësi si në Shupenzë, Gjoricë ka 24 orë ujë”.

Alla theksoi projektet në vaditjen e tokës, ku nga 8500 ha tokë bujqësore që ka bashkia, 81 për qind e saj mbulohet me ujë, nga 51 për qind që ishte në vitin 2019. Më fondet e bashkisë është ngritur një treg bujqësor si dhe kanë aplikuar dhe janë shpallur fitues nga AZHBR për ndërtimin e një tregu bujqësor edhe në Bulqizë.

Sipas Allës, me fondet e bashkisë janë asfaltuar 21 km rrugë dhe është ndërtuar edhe ura e Zall-Sopotit, e cila lidh disa fshatra me rrugën e Arbrit.

Alla tha se nga konstruksioni i ish-kompleksit “Punëtorëve të qytetit” janë përfutur 37 banesa sociale si dhe janë ndërtuar disa shtëpi për të pastrehët.

Në fushën e shëndetësisë ai përmendi ndërtimin e 3 qendrave të reja shëndetësore dhe 8 ambulanca, ndërkohë falë edhe donatorëve, së shpejti do të kemi dhe 9 ambulanca të tjera.

Si investime në nivel qendror Alla përmendi rikonstruksionin e spitalit të Bulqizës, asfaltimi i rrugës lidhës të qytezës së Martaneshit me Rugën e Arbrit, ndërtimi i një landfilli dhe ndërtimi i dy shkollave të reja, më qëllim eliminimin e klasave kolektive.

Me nivel lokal kryetari i Bashkisë së Bulqizës theksoi nevojën për sistem e asfaltim të

REPORTAZH / FESTA E MAQELLARËS

Maqellara, perlë e natyrës shqiptare

Nga HALIL RAMA

Bashkia DIBËR kërkon:

- Ndërtimin e rrugës Herbel-Peshkopi
- Ndërtimin e rrugës Arras-Lurë
- Finalizimin e landfillit rajonal
- Ndërtimin e banesave sociale
- Ndërtimin e kanalit vaditës në Maqellarë.

rrugëve rurale për t'i lidhur me njësitë administrative dhe me aksin kombëtar, përfundimi i regjistrimit fillestar të gjithë pronave, krijimi i mundësive alternative për punësim, përmes tërheqjes së investitorëve si në turizëm, fasoneri, bujtina etj. si dhe ndërtimi i dy pallate për të pastrehët.

Si aksione më emergjente janë ndërhyrja për përmirësimin e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, pasi gjendja është nivelet problematike dhe akoma jemi me investimet e bëra në vitin 1972, nisja e projektit për rikonstruksin e fasadave të qytetit, sistem-asfaltim i rrugës Qafë-Buall-Martanesh dhe sistemim-asfaltimi i rrugës që lidh dy njësi administrative, Ostreni dhe Trebishti që bashkohen me aksin Bulqizë-Librazhd.

BASHKIA DIBËR: NJË MENAXHIM MË I MIRË I PASURIVE UJORE

Kryetari i Bashkisë së Dibrës, Rahim Spahiu tha se “në bashkinë Dibër ka pasur një rritje të lehtë të të ardhurave vendore, dhe po ashtu ka pasur rritje edhe nga investimet nga Buxheti i Shtetit”.

Nga 5 arritjet më të rëndësishme të Bashkisë ai përmendi uljen e borxht të bashkisë nga 18.82 për qind në 13.71 për qind për një periudhë 4-mujor që ai drejton Bashkinë e Dibrës. Në bashkinë Peshkopi janë bërë afërsisht 10 km asfaltim rrugë në qytet dhe rrugë rurale, është ndërtuar një kopsht dhe qendër shëndetësore dhe dy shkolla të rikonstruktura si dhe është bërë rehabilitimi i veprave vaditëse të 22 liqeneve dhe të 618 km kanale vaditëse në 15 njësi administrative.

Spahiu tha se “ky ka qenë viti i parë që nuk kemi pas asnjë ankesë nga zonat dhe njësitë për furnizimin me ujë dhe për probleme në kanalet vaditëse”.

Një arritje tjetër Spahiu përmendi rehabilitimin dhe mbylljen përfundimtare të depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane si dhe promovimi i Dibrës turistike përmes “Dibra n'Fest”, pasi tani, me rrugën e Arbirit, Dibra i ka mundësitë që të jetë një vend turistik.

Në nivel qëndror Spahiu përmendi investimet në segmentin rrugor Herbel-Peshkopi, ndërtimi i rrugës Arras-Lurë, finalizimi i studimit të fizibilitetit dhe financimit të landfillit rajonal, ndërtimin e banesave sociale për familjet e pastrehë, ndërtimi i një kanali vaditës në Maqellarë.

“Maqellara është është një zonë me 14 mijë banorë dhe nuk ka ujë vaditës, është e vetmja zonë që nuk ka ujë vaditës”, tha Spahiu.

Në nivel lokal Spahiu vuri theksin te rishikimi i planit të përgjithshëm vendor, studimi dhe hartimi i projekteve për rivitalizimin dhe rigjenerimin e zonave rurale, rikonstruksin e disa institucionet arsimore, sportive dhe kulturore.

“Në Dibër këtë vit është krijuar për herë të parë edhe ekipi i futbollit të femrave”, tha Spahiu.

Kryetari i Bashkisë së Dibrës theksoi edhe planet e tij për zerimin e borxheve të bashkisë, menaxhimin në shërbimeve të emergjencave civile dhe kontrollit të territorit etj.

Më emergjente Spahiu tha se është ndërtimi dhe vënia në efikasitet të ujësjellësit të Maqellarës, përfundimi i asfaltimit të rrugëve në qytet dhe rrugëve rurale, rikonstruksin dhe rehabilitimi i plotë i trotuareve të qytetit, etj.

Korresp.Rr.A.

Maqellara, njësi më e madhe administrative e Bashkisë Dibrë dhe e qarkut me të njëjtin emër, për të dytin vit radhazi përjeton ditë-festën e saj. Nismëtarë dhe protagonistë të kësaj dite, dy kolegë gazetarë dhe shkrimtarë të njohur, Osman Xhili dhe Setki Jashari. Prej disa ditësh ata ftuan nëpërmjet rrjeteve sociale intelektualë të zonës, vendas e me banim në Tiranë, Peshkopi e Bulqizë, si dhe emigrantë të ardhur për pushime në vendlindjen e tyre. Dhe ja, jo një e dy, por qindra bij e bija të kësaj zone, që kishin ardhur deri edhe nga Brukseli, Zvicra, Gjakova e Dibra e Madhe e RMV, do të “pushtonin” mesditën e 11 gushtit resortin fantastik të Shaban Beçës në fshatit Potgorcë, buzë Drinit.

RINGJALLJA E TRADITËS

Nën moderimin mjeshtëror të Defrim Methasanit – i njohur në gjithë vendin si dhe në hapësirën mbarëshqiptare, si ikonë e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, por dhe si organizator i talentuar i eventeve të tilla, festa do të niste me performimin e disa valleve nga valltarë të Ansambli Artistik “Dine Doda” të Muhurrit, nën ritmet festive të daulleve.

Në këtë perlë të natyrës turistike, Defrimi do të improvizonte mjaft bukur skenën rrethore, nga ku burrat e ulur këmbëkryq do të interpretonin këngën epike “Kjo është Dibra maja-maja”. Më pas do të intervistonte dhjetëra personalitete dhe të përhapte siç di vetëm Ai jehonën e mbresave të tyre.

Dhe ja, i pari Leonard Tase. Emblema e volejbollit modern që solli risi në fushën e volejbollit në Shqipëri dhe që njihet jo vetëm për kontributet e tij në sportin e volejbollit si lojtar apo organizator dhe më pas si trajner, por edhe për mbështetjen që gëzon në Evropë dhe me gjerë nga BVA – CEV – FIVB dhe krerët më të lartë të volejbollit në botë (si Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Volejbollit FSHV për afro dy dekada dhe si ish-këshilltar për Sportin i Presidentit Meta), do ta vlerësonte këtë fshat të Maqellarës si perlë të natyrës shqiptare, që sipas tij nuk ka të dytë për nga bukuria e hijeshia. Pikërisht, nga këtu do të jehonte zëri i artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt “Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”. Me mjeshtëri të rrallë artistike, ajo interpretoi për pjesëmarrësit në këtë festë disa këngë qytetare dibrane e kështu zëri i saj brilant jehoi si asnjëherë tjetër brigjeve të Drinit të Zi.

Pikërisht, këtu ku pothuajse ishte shuar tradita e këngës, Liri Rasha kontribuo, jo vetëm si një zë i veçantë dhe interpretuese dinjitoze e këngës qytetare dibrane e asaj shqiptare në tërësi, por edhe me fjalën e saj të ngrohtë përshëndetëse për njerëzit e mirë të Maqellarës, duke e rritur kështu ndjeshëm entuziazmin mes të pranishmëve në këtë festë mbresëlënëse. Por, Defrim Methasani – “Mjeshtër i Madh”, që vetëm para pak kohësh organizoi suksesshëm eventin “Maqellara fest” me ndeshje volejbollit mes ekipit të vajzave të ekranit dhe atij të vajzave të gjimnazit “Fiqiri Dine” të Maqellarës dhe show spektakolar me djemtë e raftingut, edhe në këtë festë të radhës do t'i kushtonte vëmendjen e duhur ndeshjes së futbollit mes ekipeve të nxënësve maqellaras, organizuar përsosmërisht nga trajneri Nexhat Agolli. Kësisoj, kjo ditë feste mund të konsiderohet edhe si ringjallje e traditës me veprimtari nga më të larmishmet. Madje, nga këtu do ta merrte frymëzimin edhe poeti Demir Rusi, për të premtuar promovimin e dhjetë librave të tij, pikërisht te ky resort i mrekullueshëm.

Kësaj atmosfere festive pa dyshim që do t'i gëzoheshin edhe intelektualit i shquar nga Dardha e Pukës, Luigj Marku (i ati i ish-futbollistit të “Korabit”, sulmuesit Taulant Marku), ndërkohë që atë do ta ndizte dukshëm me zërin e tij magjepsës, Kole Martin Aramathi, si dhe Afrim Kurtaga, Ver Kulla, Urin Asllani e dhjetëra personalitete tjera të kësaj treve. Ndërsa regjisori, skenaristi dhe

aktori Aqif Ademi, ky bir i shquar i Maqellarës me banim në Tiranë, jo pa qëllim kishte zgjedhur për të interpretuar vargjet e këngës së Haxhi Maqellarës, “Jam krenar që jam dibran”. Me të njëjtën performancë u shfaq dhe u duartrokrit fuqishëm nga pjesëmarrësit edhe kaskadori i famshëm nga Dibra e Madhe Di Jashari.

Pjesëmarrësit ndjenë emocione të fuqishme, kur nga mikrofoni i moderatorit Methasani jehuan opinionet mbresëlënëse të sekretares së përgjithshme të Prefekturës Dibrë, Znj. Donika Hysenaj, si dhe intelektualit të mirënjohur maqellaras, me rrezatim mbarëkombëtar Demir Osmani (babai i moderatorës së mirënjohur të spektakleve televizive Arbana Osmani).

Shtrengim duarsh e takim mjaftë miqësor nga organizatorët Xhili e Jashari edhe me pjesëmarrësit e familjes të bijës së Maqellarës,

ardhur nga Gjakova, Luiza Bajraktari Stanica si dhe me princeshën e Bim Bulkut, Manjola Liana Bulku, ardhur nga Belgjika. Fjalë zemre prej tyre për këtë festë madhështore me premtimin se do të jenë të pranishëm edhe vitin tjetër.

Dhe pa dyshim, oratorët shprehën mirënjohje për administratorin e Njësisë Administrative Maqellarë, djalosin simpatik Florian Lazri, jo vetëm për mbështetjen në organizimin e kësaj feste, por edhe për drejtimin e njësisë me vizion dhe përkushtim maksimal.

SHQETËSIMI I LIGJSHËM PËR MASIVIZIMIN E FESTËS

Ndërsa kanë vlerësuar atmosferën e festës, organizatorët e saj, Osman Xhili e Setki Q. Jashari nuk kanë nguruar të shprehin shqetësimin e tyre të ligjshëm për masivizimin e saj. Dhe kanë të drejtë edhe për faktin se 22 fshatrat e Njësisë Administrative Maqellarë (Bllata e Poshtme; Bllata e Sipërme; Burimi; Çernena; Dovolani; Erebara; Fusha e Vogël; Gradeci; Grezhdani; Herbeli; Katundi i Vogël; Kërçishti i Poshtëm; Kërçishti i Sipërm; Kllapçishti; Kovashica; Pesjaka; Pocesta; Podgorci; Popinari e Vojniku) kanë nxjerrë me qindra personalitete të njohura lokale e kombëtare, të cilët jo vetëm që nuk duhet t'i mungojnë, por edhe t'i kontribuojnë kësaj feste. Ashtu si Osman Xhili që ka shkruar me fantazi e profesionalizëm të lartë dhjetëra reportazhe, portrete intelektualësh e sipërmarrësish shembullorë si dhe artikuj problemorë për Maqellarën, dhe biri i devotshëm i kësaj zone Setki Jashari, autor i dy romaneve mjaft të arrirë artistikisht, edhe bashkëqytetarët maqellaras me banim në Tiranë, të të gjitha profesioneve e moshave, duhet t'i bashkohen misionit të tyre. Këtë e shpreh si domosdoshmëri edhe Ramazan Illica, babai i dy gazetarëve të talentuar, Elisabeta dhe Eduard Illica. Ndërsa drejtuesit e vet-

eranëve të Rrethit Dibrë, kryetari Alush Stojku dhe ndihmësit e tij shembullorë Besnik Lami e Ilmi Cani, të ngazëllyer nga atmosfera festive, domosdoshmërinë e masivizimit të festës e shtrojnë edhe në aspektin e ndikimit të saj në edukimin patriotik të brezave. Dhe kanë të drejtë, sepse përveç veprimtarive kulturore e sportive, festa duhet të ndikojë edhe në evidentimin dhe promovimin e vlerave të historisë, të patriotëve e luftëtarëve të kësaj treve për liri e pavarësi kombëtare, të ngjarjeve e personaliteteve të LANÇ, traditës, arsimit e kulturës, që në këtë zonë, si askund tjetër kanë shkëlqim të rrallë. Do të mjaftonte për këtë qoftë edhe sikur dikush nga historianët e zonës (që nuk janë të paktë) të zhvillonte një bisedë për profilin e personalitetit të shquar Iljaz Pashë Dibra (Qoku), i cili më 10 qershor 1878 kryesoi mbledhjen e parë të Lidhjes së Prizrenit dhe që njihet për kontributin e tij madhor për çështjen kombëtare shqiptare.

Gjithsesi, misioni i miqve e kolegëve të nderuar Osman Xhili e Setki Jashari duhet konsideruar i përbushur edhe për këtë fillim të mbarë. Sepse Maqellara me më shumë se 14.000 banorë, që gjendet 22 kilometra larg kryeqendrës së Dibrës shqiptare, Peshkopisë dhe vetëm 5 kilometra larg Dibrës së Madhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me resurse të shumta natyrore e njerëzore (e konsideruar si hambari apo “Myzeqeja” e Dibrës) e meritonte një festë të tillë.



Nga **Mikaela Minga**

Ka mënyra të ndryshme si mund të hysh në dialog me vepra të caktuara arti, madje edhe të rrish gjatë me to. Kjo më ndodhi me *Valle dibrane*, vepër e piktorit Bajram Mata. Ngacmimi fillestar erdhi gjatë një bisede rreth vepërës, organizuar në kuadër të ekspozitës “Tirana Patience”, hapur rreth dy vjet më parë në Galerinë e Arteve. Pa pretenduar të vesh petkun e studiuesit apo kritikut të artit, kjo vepër ftonë që, nën petkun e etnomuzikologut, të hulumtoja aspekte të kulturores, muzikores, po aq sa edhe të antropologjikes e folklorikes.

E fillova këtë lloj hulumtimi duke u përpjekur të njoh fillimisht autorin. Bajram Mata zë një vend relativisht diskret në historinë e artit shqiptar. Ai i përkiste brezit të artistëve (muzikantë, shkrimtarë, kineastë) që u formuan midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Kreu dy vjet studime në Shën Petersburg (Leninograd) të cilat, për shkak të prishjeve të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik i përmbylli në Tiranë, në vitin 1965. Pas mbarimit të studimeve, Mata u caktua në Peshkopë, ku punoi si mësues e skenograf në Shtëpinë e Kulturës, duke qenë njëherazi anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. [1] Për familjarët, kthimi në provincë rezultoi kufizues në shumë drejtime. Prapëseprapë, ai arriti të mbajë lidhje aktive me Tiranën, duke u bërë pjesë e asaj atmosfere të veçantë kërkimi e eksperimentimi që karakterizoi artin figurative shqiptar në fund të viteve ’60 dhe fillimin e viteve ’70, ndonëse jo krejt i evidentuar, do të vërente Ermir Hoxha:

Ndër rastet e parrahura në shtyp, çudit rasti i Bajram Matës, pasi në vitet në fjalë [’69-’74, shënimi im] artisti realizon disa nga krijimet e tij më të mira. Në një kërkim personal mbi formën, që në vitin 1969, ai nis të shpalosë tendencën e tij për evidentimin e ngjyrës. Kërkim si ai në tablonë “Aksionistet”, ku ngjyra e ndezur e perëndimit të diellit, duket sikur për një çast ka ndezur vrullin revolucionar të vajzave të reja. Dinamizmi i figurave duket sikur vallëzon drejt hapësirave të reja të jetës, mbështjellë nga një optimizëm ngjytës. Përveç realizmit karmin të aksionisteve, Mata realizon dhe disa tablo me temë nga qyteti i lindjes, ku atmosfera e gjallë e aktiviteteve folkloristike merr peshën kryesore. Kështu ndodh në tablotë “Valle dibrane” dhe “Dasmë në fshat”, ku perceptimi artistik i asaj që po ndodh, duket sikur reduktohet thjesht në përcimin e ndjesisë së të tërës. Ajo që paraqet artisti nga ajo që sheh, është vetëm një miks ngjyrash e linjash. Ekspresiviteti kromatik kap kulmin. Zhduken tiparet e portreteve, linjat ndarëse të turmave e ndërtesave. E kuqja flakëritëse shpërndahet ngado si shenjë identiteti e veshjeve karakteristike, ndërsa turma e elektrizuar duket sikur jeton një ditë të gjatë sa një jetë.[2]

Në fakt, *Valle dibrane* nuk ka datë, por me shumë gjasë i përket kësaj periudhe. Ajo është blerë nga Galeria e Arteve në vitin 1985, dy vjet pas vdekjes së parakohshme të piktorit, në moshën 43 vjeçare. Por, gjasat janë që t’i përkasë periudhës në fjalë.

Valle dibrane e Matës më përcjell një përmasë intimiteti dhe subjektiviteti. Ajo fikson çastësinë e vallëzimit, të lëvizjes me një spontaneitet të çlirshëm. Toni i ngjyrave, sidomos i së kuqes i bën shumë evokuese trupat njerëzore në çastësinë e tyre performative. E gjitha kjo tregon sesi ky proces përfaqësimi ikonografik ka pasur qasje të ndryshme, të cilat varen edhe nga individualiteti i artistit, mënyra si ka përthithur një orientim të caktuar estetik, apo ideologjik dhe e ka përfutur në vepër.



Valle dibrane

Përmbajtja shkon për shtat me pasqyrimin ose referimin e elementeve të kulturës tradicionale, çka përbënte një orientim të përgjithshëm estetik të arteve shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX. Një pririje të tillë do ta quaja përfaqësim (representation) të tradicionales, folklorit, muzikës folklorike në veprën e artit për t’i dhënë atributet kombëtare. Nga ana tjetër, kultura tradicionale shërbeu gjithashtu edhe si mjet i fortë propagande brenda kulturës socialiste, si formë promovimi e ideve të saj mbi kolektiven, kombëtarën, popullin dhe fshatin. Edhe ky qëndrim pati përfaqësimin e vet ikonografik, çka ilustron me numrin e madh të veprave të cilat e implementojnë një përmbajtje të tillë. Për shembull, mjaft emblematic për këtë është *Shqipëria vallëzon* (1971) e Abdurrahim Buzës.

Këtu akti i vallëzimit, në një valle rrethore mund të lexohet si simbol i vetë kombit dhe i “festivitetit socialist”; ku burra e gra veshur me kostume tradicionale nga gjithë krahinat kërcëjnë së bashku. Kjo vepër shërbeu edhe si imazh-logo i festivalit folklorik të Gjirokastërës, duke u vendosur në skenën e tij, po aq sa edhe në shumë kartolina të kohës. Kësisoj, ajo kthehet në një përfaqësuese të qartë të punës kulturore me folklorin dhe kulturën tradicionale brenda modernitetit socialist që, si e tillë, nuk kishte aq lidhje me të shkuarën tradicionale, sesa me të tashmen, “e lavdishme” dhe “progressive”, në të cilën kjo “tradicionale” po rijetëzohet.

Përkundër, *Valle dibrane* e Matës më përcjell një përmasë intimiteti dhe subjektiviteti. Ajo fikson çastësinë e vallëzimit, të lëvizjes me një spontaneitet të çlirshëm. Toni i ngjyrave, sidomos i së kuqes i bën shumë evokuese trupat njerëzore në çastësinë e tyre performative. E gjitha kjo tregon sesi ky proces përfaqësimi ikonografik ka pasur qasje të ndryshme, të cilat varen edhe nga individualiteti i artistit, mënyra si ka përthithur një ori-

entim të caktuar estetik, apo ideologjik dhe e ka përfutur në vepër.

Por, ka edhe diçka personale në këtë vepër. Lindur më 1940, në fshatin Lejçan, të zonës së Gollobordës, në krahinën e Dibrës, Mata sjell pikërisht një situatë nga vendlindja e tij që përbën edhe një nga zonat ku ia vlen të ndalesh sa i takon traditës së vallëzimit. E vendosur midis Dibrës dhe Elbasanit, Golloborda ndahet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Ajo ka një popullsi mikse: shqiptare dhe bullgaro-maqedonase, të fesë muslimane dhe ortodokse. Kostumet në fjalë i përkasin kryesisht popullsisë muslimane të kësaj zone. Krahina e Dibrës në përgjithësi ka qenë e dalluar për shumëllojshmërinë e valleve dhe praktikat e tyre. Aq e vërtetë është kjo sa përcaktimi “valle dibrane” do të ishte shumë i përgjithshëm për të treguar larinë e valleve dhe kërcimeve të zonës. Ramazan Bogdani është marrë gjerësisht me vallet tradicionale. Ai ndalon të kjo zonë posaçërisht në qershor të vitit 1977, me një ekspeditë folklorike, ku mbledh e dokumenton shumë syresh. Libri i tij *Gjurmime koreografike* (1995) përshkruan detaje prej të gjitha zonave, të cilat i ndan në: vallet e Grykës së Madhe, vallet e malit të Selishtës, vallet e malit të Çidhnës, ato të fushës së Dibrës, vallet e kalasë së Dodës, vallet e krahinës së Lurës, si dhe vallet e krahinës së Gollobordës.

Nuk e dimë nëse ka pasur ndonjë valle specifike që e ka frymëzuar Matën. Gruaja e tij Drane Mata, tregon se pikënisje për këtë vepër ka qenë një dasmë në Ostren, krahina ku kish lindur. Fillimisht bëri disa skica të vogla në bllokun e vet. Ka qenë maj ose qershori i vitit 1975, sipas saj. Dhe me t’u kthyer prej andej, skicat filluan të merrnin trajtën finale. Por, matanë titullit, është vetë penelata e Matës që të nxit për të folur rreth valleve të kësaj zone.

Si fillim, jemi në një hapësirë tërësisht femërore; çka do të thotë që kemi të bëjmë

me një valle grash. Vallet e grave në zonat e Dibrës, në kontekstet e jetës rituale tradicionale, Ramazan Bogdani i ndan në dy tipologji: E para vallet që kërcëhen në rreth të mbyllur ose gjysmërreth. Te këto, interpretueset kapen për dore me njëra-tjetrën. Ndërsa tipologjia tjetër e janë “kciemet” që vendasit i specifikojnë në mënyrë edhe më të detajuar si: “Kcimi me t’majtme; kciemet me t’lëshueme”. Këto interpretohen veçmas dhe me një mënyrë më të çlirët. Nëse shohim pozicionin e valltareve në pikturën e Matës mund të themi se nuk jemi në tipologjinë e valleve në gjysmërreth që është karakteristike për gratë e moshuara. Valltaret nuk janë të kapura për dore me njëra-tjetrën. Në studimin e tij, Ramazan Bogdani flet për një valle të quajtur “vallja e lshueme” si një tip i veçantë kërcimi i zonës së Gollobordës, e cila shoqërohet me këngë e dajre. Gratë këtu, sipas tij, ndahen në dy grupe, në ato që kërcëjnë dhe ato që shoqërojnë me këngë e dajre. Kjo lloj skeme e shkëputjes së një dysheje, bëhet me radhë për të mbërritur në fund tek kërcimi i të gjithave së bashku.

Po ta shohim me kujdes, edhe këtu kemi një lloj ndarjeje në dy grupe: Kemi katër protagoniste të vendosura në pjesën e majtë të pikturës. Vështrimi dhe fytyrat e tyre janë drejtuar tek një çift valltaresh që gjenden në anën e djathtë, gati-gati në skaj. Ato janë pozicionuar njëra-përballë tjetrës dhe të krijojnë përshtypja sikur përipiqen të dalin jashtë kornizave konvencionale të pikturës; t’u ikin atyre; një pjesë e trupit të njëres prej tyre është lënë jashtë telajos, ndërsa tjetra është pikturuar vetëm në ¾ e trupit. Të dyja duket sikur shkrihen me sfondin.

Katër prej valltareve luajnë me dajre, por ajo që bie më shumë në sy është pozicioni si mbajnë instrumentin. Duart i kanë të ngritura lart; dajres i bien duke e pozicionuar sipër kokës. Ky pozicion është jo aq i natyreshëm, ose komod, le të themi. Më konvencionali

rkon të japë edhe Mata. Vetë imazhi i tyre është lëvizës, jo shumë i qartë; nuk kërkon ta shquajë figurën, por përpiket të kapë lëvizjen e saj; dinamikën, gjendjen, energjinë. Është një penelatë e hedhur shpejt me synimin për të kapur jo aq portretin, sesa ravijëzuar emocionin që përcjell ajo. Aq e vërtetë është kjo sa piktori nuk shqetësohet as të përfshijë të gjitha portretet brenda kuadrit; skajet, fjala vjen janë të prera dhe, si e vërejtja, valltarja në skajin e djathtë na jepet vetëm pjesërisht.

paraqitet me dajren e vendosur përballë me kraharonin ose pak e spostuar. Dhe është një detaj i cili sugjeron një situatë ekzaltimi, një moment, po themi climax-i të interpretimit të saj. Gjithë hapësira duket se zotërohet nga çifti i valltareve në skaj të pikturës. Kurse në tërësi kemi paraqitjen e një mikro-universi të krijuar aty-për aty dhe që i ka përfshirë plotësisht.

Pikërisht këto lloj emocionaliteti të çastit kërkon të japë edhe Mata. Vetë imazhi i tyre është lëvizës, jo shumë i qartë; nuk kërkon ta shquajë figurën, por përpiket të kapë lëvizjen e saj; dinamikën, gjendjen, energjinë. Është një penelatë e hedhur shpejt me synimin për të kapur jo aq portretin, sesa ravijëzuar emocionin që përcjell ajo. Aq e vërtetë është kjo sa piktori nuk shqetësohet as të përfshijë të gjitha portretet brenda kuadrit; skajet, fjala vjen janë të prera dhe, si e vërejtja, valltarja në skajin e djathtë na jepet vetëm pjesërisht.

Po kështu, në një valle, gjymtyrë kryesore janë këmbët, lëvizja e së cilave mund të konsiderohet si gjeneruese e së gjithës. Këto ama nuk rezultojnë të jenë aq të rëndësishme për Matën, krahasuar me gjuhën e trupit, me trajtat valëzuese që iu jep kostumeve dhe sidomos duarve, ku nuk mund të mos tërhiqemi nga një feminitet joshës që përcjellin krahët gjysmë të zhveshura të tyre. Së fundi, sfondi neutral rijetëzohet përmes ngjyrave të kostumeve, si dhe nga hijet e trupave në raport me vendin ku janë pozicionuar.

Sigurisht, nuk kemi pse të pretendojmë që Mata të na japë një paraqitje skematike dhe rigorozë të një valleje të përcaktuar, por pikërisht përmes mungesës së këtij pretendimi, mund të hapim një diskutim rreth valles tradicionale në planin studimor e performativ.

Është me interes të vërejmë se vizatimi dhe skicimi i lëvizjeve ishte një metodë pune në studimin e saj. Për këtë angazhohej posaçërisht një piktor-skicograf. Kjo bëhej sepse fokusi i etno-koreologjisë shqiptare ka qenë mbi të gjitha produkti në vetvete, përpjekja për ta izoluar si artefakt dhe jo për ta parë vallëzimin si proces, në kontekst, brenda ritit dhe rëndësisë që kishte brenda tij. Kështu skicat detajoheshin me kujdes, duke u përqendruar sidomos te gjymtyrët. Mirëpo sa i mjaftueshëm është një proces i tillë për të kuptuar trupin që kërcen?

Një sistem i tillë nuk arrin dot të tejshkrualjë atë impuls të përbrendshëm që nxit dhe vë



Shqipëria vallëzon (1971) e Abdurrahim Buzës

trupin në lëvizje, e bën të vallëzojë. Ndonëse përqendrohet te trupi, ai nuk merret dot me truporen, me ato veçori që kanë të bëjnë me *proprioceptimin* që nënkupton pikërisht ndërgjegjësimin për lëvizjen dhe pozicionin e trupit brenda gjithë procesit. Për më tepër nuk mund të ketë një trup arketip. Mata pikturon gjashtë personazhe femërore dhe asnjëra prej tyre nuk vjen njësoj te shikuesi. Dhe të gjithë këta trupa janë të formuar si qenie sociale dhe kulturore; të njëjtë por ndryshe.

Edhe aplikimi i filmimeve nuk ndihmoi studimin, pavarësisht investimit të madh në drejtim të mjeteve teknologjike. Kjo sepse mbeti i skematizuar. Krijimi i një lloj videoklipi, me valltarë dhe instrumentistë të veshur me kostume tradicionale, të cilët vendoseshin përgjithësisht në një peizazh natyre ishte një simulim performance, jashtë kontekstit ritual ku gjenerohej vallja dhe kërcimi.

Niveli tjetër, ai i performancës na çon te statusi skenik e spektakularizues që mori kërcimi tradicional në modernitetin kulturor socialist. Formatet festivalore dhe ato të ansambleve institucionale sollën ndryshime thelbësore në vetë ekzistencën e kësaj praktike. Një nga më thelbësorët kishte të bënte me ndarjen gjinore që ishte karakteristike e vallëzimit tradicional. Përzjerja gjinore që na përcjell Abdurrahim Buza, festivalet folklorike dhe që sot na duken si normalitet, janë, në fakt, rrjedhojë e këtij statusi moderniteti. Vallet e grave dhe ato të burrave kanë qenë të ndara. Secila gjeni kishte tipologjinë e vet; sikundër edhe kontekstet e veta të interpretimit. Kishte raste përjashtimore kur burrat mund të interpretonin valle që tradicionalisht luheshin nga gratë, si me rastin e disa valleve të Devollit të sipërm, por nuk ka ndodhur e kundërta. [3]

Në periudhën diktatoriale, sidomos gjatë fushatës për emancipimin e gruas, një ndarje e tillë u interpretua si shenjë prapambetje, të cilën progresi i diktaturës së proletariatit do t'i jepte fund.

Kështu shkruhet në një artikull të vitit 1968:

Në vallëzimin tonë popullor tradicional ekzistojnë dy lloje të ndryshme kërcimi: vallet e grave dhe vallet e burrave. Ky veçim i valleve simbas seksit është një nga shfaqjet e dasisë dhe e pabarazisë së gruas me burrin, e pasqyruar nëpërmjet artit të kërcimit. [4]

Në fakt, një ndarje e tillë nuk do kuptuar në mënyrë kaq sipërfaqësore; ajo ka rrënjë social – kulturore. Lidhet me ndarjen e punës dhe funksionet që gruaja ka pasur historikisht në jetën familjare dhe atë shoqërore. Vallet lidhen me këto role

dhe si të tilla janë praktikuar brenda shoqërisë tradicionale. Ato janë të lidhura ngushtë me ritualin; me ritet kalendarike, me festat e motmotit dhe sidomos me ritualin e dasmës që përbën edhe hapësirën më të rëndësishme të praktikimit të tyre. Kjo është perceptuar historikisht si një hapësirë e ndarë gjinore. Vallet nuk janë akte që veprojnë në mënyrë të pavarur, apo jashtë komunitet dhe historisë së tij; por një pjesë integrale e tij.

Në një nivel tjetër, kjo gjë kushtëzohet edhe përmes mënyrave si përftohet fizikisht lëvizja, emocionaliteti; për burrat e për gratë. Në fund të fundit, vallëzimi është një art i cili i referohet gjuhës së trupit dhe që shprehet me anë të gjithë formave të lëvizjes që ky është në gjendje të realizojë. Si burrat, ashtu dhe gratë kërcejnë për kënaqësi, por edhe për ta ndjerë e përjetuar trupin në mënyra të caktuara (*proprioceptimi*). Për rrjedhojë, tek vallet e burrave lëvizjet dhe plastika e trupit karakterizohen nga të tjera veçori fizike..

Përzjerja gjinore ishte rrjedhojë e një formati i cili lidhej me ansamblen e institucionizuar folklorike pranë shtëpive e vatrave të kulturës. Në shumicën e rasteve këto kishin në përbërje të tyre valltarët më të spikatur, të cilët angazhoheshin brenda tyre. Këto ansamble do ta bartnin këtë lloj praktike nga logu, fusha, oda e dasmorëve në skena festivalesh e koncertesh; pra kemi kalimin nga një performance inkluzive, përfshirëse, intime, që të përfshinte sa ty që kërcejte, aq edhe të tjerët rreth e rrotull; në një performance ekskluzive, ku spektatori ishte në pozicionin e soditjes, i ndarë nga interpretuesi; së fundi, nga një performancë lokale, e një zone, në një interpretim kombëtar, që i përkiste Shqipërisë. Afirmohen kështu valle me përkatësi gjeografike: vallja e Kukësit, vallja e Tropojës, vallja e Librazhdit, vallet dibrane, vallja e Bradasheshit.

Duke iu nënshtuar dinamikave të skenës, përshtatjes me ligjet e performances ekskluzive, kjo lloj praktike do të duhej të kishte përkorën estetike, në sensin e rregullimit dhe sinkronizimit të lëvizjeve; do të duhej të kishte një lloj formalizimi të tyre, të imponuar nga skena dhe spektatori. Në këtë proces angazhoheshin punëtorët kulturorë, por edhe studiues, të cilët shpesh shkonin deri aty sa të jepnin udhëzime për mënyrën si valltari duhet të kryente lëvizjen, sa duhet ta ngrinte këmbën. Kjo ngjan qesharake, deri diku dhe është diçka që shkaktonte jo pak pakënaqësi nga ana e valltarëve, sidomos atyre që e zotëronin këtë dije në mënyrë të përvëçme. Më ka ndodhur shpesh gjatë ekspeditave që valltarë e valltare të tregojnë detaje të kësaj marrëdhënie përgjithësisht të tensionuar mes tyre dhe udhëheqësve artistikë, regjisorëve, koreografëve, apo studiuesive, të cilët viheshin shpesh në rolin e “ekspertit” dhe jepnin udhëzime të këtij tipi.

Nga ana tjetër, shumë prej këtyre, gjatë bisedave të realizuara sot e kujtojnë me një lloj nostalgjie këtë përvojë skenike. Edhe pse me vetëdijen që ishte diçka krejt tjetër nga ajo që bënin në konak, apo odat e tyre, kjo lloj përvoje për disa prej tyre u shndërrua edhe në një formë afirmimi dhe suksesi.

Përpos modifikimit të lëvizjeve, pika ndoshta më kulmore e këtij procesi modernizues erdhi me spektakularizimin, ose me shpikjen e valleve të reja, *ad hoc*, nga koreografë të shkollluar. Në këtë rast kemi të bëjmë me tablo koreografike, sesa me valle *strictu sensu*. Disa prej tyre ruanin le të themi një lloj afiniteti me modelet tradicionale, por për çdo rast duke e përfshirë brenda një koreografie konvencionale. Modele të tilla gradualisht erdhën edhe duke kodifikuar një gjuhë të caktuar trupi: kam parasysh këtu detaje të tilla si kërcimet akrobatike, hapjen e krahëve (kush nuk e ka parasysh figurën e Besim Zekthit apo Rexhep Çelikut) që përshenjinonin epiken, trimërinë, shqiponjën, shqiptaren.

<https://www.youtube.com/watch?v=T8Q-rB-VQ2q8>

Shembulli më i njohur i kësaj koreografie neo-tradicionale me një gjuhë të kodifikuar trupi është *Festë të madhe ka sot Shqipëria*, e popullarizuar gjerësisht, ndër të tjera edhe përmes këtij videoklipi, i cili është realizuar në vende po aq të stereotipizuar për ideologjinë dhe kulturën proletare.

https://www.youtube.com/watch?v=_WDuKxL7ivc

Ky spektakularizim mediatik e festivalor ka bërë që sot shumë prej këtyre valleve të kthehen në standarde dhe si të tilla të (ri) hyjnë brenda komuniteteve përkatëse, duke u pranuar si të traditës (vallja e Tiranës; vallja e Librazhdit, apo ajo e Tropojës, që tani së fundi është futur edhe në listen e trashëgimisë kulturore). Ndërkaq, pjesa më pak e diskutuar dhe e trajtuar është pikërisht kjo punë kulturore që qëndron pas kërcimit tradicional dhe që sot dikton edhe mënyrën si kërcen e vallëzon “traditën” çdokush prej nesh.

Për mua, humbja e kësaj përmase rituale, ai lloj zvetërimi i saj është si zhdukja e shumë botëve të përveçme ku njerëzorja bëhej bashkë me mitiken e simboliken, ku truporja dialogonte me shpirtëroren, sensualen. Duke u shpëputur produkti ka humbur elementë thelbësorë dhe bashkë me të edhe komuniteti e shoqëria. Për valltarë profesionistë, koreografë dhe operatorë kulturorë ngjitja në skenë dhe koreografitë neo-tradicionale ishin një zhvillim i nevojshëm, një pasurim që mbartet edhe sot dhe që si i tillë ka sjellë vlerat e veta, pavarësisht problematikave që e shoqëruan. Secila prej palëve është në të drejtën e vet. Ajo që ka rëndësi është që ndërsa i kemi pranuar këto valle si pjesë e trashëgimisë kulturore, është e udhës që gjithashtu të njohim punën kulturore prapa tyre. Vallja nuk është diçka statike, pasqyrë e një kulture të caktuar, por një proces formëues i saj. “Fuqia e vallëzimit qëndron në aktin e performancës çka përfshin valltarë dhe spektatorë bashkë, në një proces që i jep kuptim vallëzimit dhe e përbashkon vallen me ide dhe përvoja të tjera.” [5] Ajo çka i mbetet të sotmes është të përpiket të hulumtojë më thellësisht brenda tij këtij procesi i cili iu ka dhënë jetë produkteve që ne kërcejmë e vallëzojmë.

[1] Informacionet biografike janë marrë nga familja e Bajram Matës. I jam mirënjohëse Elsa dhe Drane Matës, vajzës dhe gruas së autorit.


[2] Ermir Hoxha. *Arti në Shqipëri. 1945-1990*. Tezë doktore. Universiteti i Tiranës: Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore. 2014, fq. 131

[3] Këtë informacion e kam marrë gojorisht nga Josif Minga.

[4] Nexhat Agolli dhe Ramazan Bogdani. “Vallja si shprehje e ndjenjave dhe e mendimeve të gruas në jetën shoqërore”. *Studime filologjike*. 1968, 173.

[5] John Blacking. “Dance as cultural system and human capability: An anthropological perspective. Në *Dance a multicultural perspective. Report of the third study of dance conference*. Përg. J. Adshead. 1984, 20.

Marrë nga *Peizadhe të fjalës*, <https://peizazhe.com/2022/08/12/valle-dibrane/>



Komentatorët gjermanë në stadiumin e lojërave olimpike të Mynihut çuditen me shpejtësinë e Luiza Gegës.

Luiza Gega po çudit botën me shpejtësinë e saj

Nga ENELA SHEHU MARKJA, Mynih



„Sehr Souverän!“ - Tepër e sigurt. Luiza Gega shpallet kampione Europe në garën e 3000 metrave me pengesa me kohën 9:11.31, duke shënuar jo vetëm një rekord personal, por edhe një rekord europian.

Nga 11 deri më 21 gusht u zhvillua në qytetin e Mynihut Kampionati European i Atletikës, aktiviteti më i madh sportiv veror, që nga Lojrat Olimpikë në verën e vitit 1972.

Jo vetëm Parku Olimpik, i cili ishte dhe zemra e këtij aktiviteti sportiv, por dhe gjithë qyteti u shndërrua në një tribunë për sportistët dhe atletët më të mire europian.

Shiu i pritur gjithë verën ra pikërisht ditën e shtunë, por ky fenomen natyror nuk ndikoi aspak në performancën e Luiza Gegës drejt medaljes së artë.

Deri të shtunën në mbrëmje nuk e njihja Luiza Gegën, mbase nga largësia ose dhe mosinteresi që na mbuloi bashkë me pandeminë, derisa zëri i komentatorit në stadium komentoj garën 3000 m me pengesa për femra: „Die Albanerin vorne weg“ - Shqiptarja krejt përpara.

„Gega schockt die gesamte Welt mit ihrem mörderischen Tempo“ - Gega po çudit botën me shpejtësinë e saj.

„Sehr Souverän!“ - Tepër e sigurt.

Atletet britanike si dhe atletja gjermane e njohur Lea Meyer ju afruan, por nuk e arritën dot rekordin dhe performancën e atletes shqiptare Luiza Gega.



„Die Albanerin vorne weg“ - Shqiptarja krejt përpara.

„Gega schockt die gesamte Welt mit ihrem mörderischen Tempo“ - Gega po çudit botën me shpejtësinë e saj.

„Sehr Souverän!“ - Tepër e sigurt.

Për t'u vlerësuar besimi i saj i plotë në vetvete si dhe në performancën dhe teknikën sportive.

Mbresëlënësë fjalët e saj, kur tregonte që, përgjatë garës hidhte sytë nga spektatorët në kërkim të flamurit tonë kombëtar, për të ditur nëse në këtë stadium të madh, ka dikush që e njeh dhe e mbështet atë.

Dhe një flamur ishte aty, për ti dhënë kurajo atletës sonë, e cila e ktheu shumëfish gëzimin te shqiptarët anembanë botës.

„Ne, si spektator e sportëdashës përjetuam - falë fitores së Gegës - momente magjike, të paharrueshme, emocione që të ngjallin ndjenjën e krenarisë kombëtare kur ngrihet flamuri dhe këndohet himni kombëtar në atmosferën shumëngjyrëshe festive në Parkun Olimpik të Mynihut.

Luiza Gega dhe ekipi i saj, jo vetëm që treguan prezencë në kampionat, por me thyerjen e rekordit dhe medaljen e artë u përjetësuan si në botën sportive të atletikës ashtu dhe në qytetin e Mynihut.

Për sportin dhe shoqërinë shqiptare është medalja e artë e Luiza Gegës krenari, por edhe një sfidë e vërtetë.

Talentet nuk na mungojnë, por puna dhe performanca e tyre duhen vlerësuar, duke ju dhënë atyre kornizën dhe mbështetjen e domosdoshme në ecurinë sportive.

Luiza, kjo vajzë dibrane, është një shembull i shkëlqyer për të gjithë sportistët dhe më tepër për brezin e ri që edukohet nëpër shkolla.

Me disiplinë dhe këmbëngulje bëhen ëndrrat realitet!

MESAZHI I KAMPIONES PAS SUKSESIT

GEGA: Të rinjtë mund t'ia dalin!

Emocionues ka qenë mesazhi i Luiza Gegës pas suksesit të saj dhe ardhjes në Atdhe. Unë ia dola, por edhe ju mund t'ia dilni, - ka pohuar atletja kampione në Tiranë.

Kjo medalje është jo vetëm e imja personalisht, por e një populli që meriton të nderohet kudo, brenda dhe jashtë vendit. Kur kam mbaruar metrat e fundit të garës, gjëja që mendoja ishte se si do të ndiheshin shqiptarët e mi, sa të lumtur dhe krenarë. Ndaj finishi m'u duk si një kulm lumturie dhe si një fillim ëndrrë për mua dhe miliona shqiptarë. Bota kuptoi se sa vlejme ne, që shpeshherë na injorojnë ose nënvlerësojnë. Vërtet s'kam qenë ndonjëherë më e emocionuar dhe e lumtur se këtë radhë. Akoma vazhdoj të jetoj me mbrëmjen e Mynihut dhe shkëlqimin e saj. Unë kam vite që punoj, veçmas në dekadën e fundit dhe kur fitova medaljet e para në vitin 2012, kuptova se mund të arrij gjithçka. Tashmë ja ku jemi dhe unë dua t'i falënderoj të gjithë ata që më mbështetën dhe kurrë s'më braktisën. Trajneri im është heroi im, sepse pa Taulantin, ndoshta s'do isha kjo Luiza kampione. Por edhe institucionet apo individët që më kanë qëndruar pranë meritojnë një falënderim special, sepse më kanë mbështetur për të arritur këtë ditë. Veçmas këto dy vitet e fundit, interesimi ka ardhur në rritje dhe falë këtij suporti edhe unë ia dola.

D.Methasani



atletikë

Luiza Gega nuk është thjesht një krenari, por një pasuri kombëtare.

Nga **DEFRIM METHASANI**

Rrugëtimi i saj është i gjatë dhe i vështirë, por i bukur dhe emocionues për një kampione të re Europe, e cila bëri historinë dhe shkroi emrin e saj me germa të arta si medaliste e artë dhe rekordmene Europe në garën e 3000 m me pengesa, me kohën e re 9.11.31. Luiza Gega ose flutura kuqezi, qëndis për herë të parë emrin si mbretëreshë Europe në sportin mbretëreshë të atletikës.

Ajo iku nga fshati i thellë Okshtun i Dibrës në moshën 7 vjeçare, një fshat ky me shumë histori nga lufta dhe erdhi së bashku me familjen e saj, prindërit Abazin dhe nënën Zgarifete, (një ish shoqja ime e shkollës së mesme në Peshkopi), me tre motrat dhe vëllain në Durrës për një jetë më të mirë. Aty hapat e saj të shpejtë ranë në sy të trajnerit Azbi Dauti, njëherësh edhe djali i tezes së saj dhe filloi rrugëtimin e pistës në garat e gjata. Pasi mbaroi shkollën e mjeshtërisë në Durrës erdhi në Tiranë në Universitetin e Sporteve, duke bërë hapat galopantë të saj tashmë me një super profesionist si trajner, Taulant Stermasi. Falë punës së tyre titanike, titujt rezultatet dhe medaljet e Shqipërisë, Ballkanit dhe Mesdheut u bënë pronë e saj, por viti 2022 ishte kulmi i kampiones së jashtëzakonshme. Pasi u shpall kampione Ballkani dhe Mesdheu, ajo doli e pesta në botë dhe vetëm pak ditë më pas vullkani i saj ndezi vlagën në Mynih në Kampionatin European të Atletikës. Tashmë ajo është kampionja e parë e pistës europiane si shqiptare dhe konsiderohet jo vetëm krenari, por edhe pasuri kombëtare. Por cila ishte rruga që ndoqi në pistën e atletikës kjo vajzë kaq e thjeshtë dhe punëtore, e cila ndërtoi lumturinë e saj dhe miliona shqiptarëve, mbi sakrificat e panumërta në sport, duke arritur deri në podin e nderit. Luiza pas vitit 2010 erdhi në Tiranë, ku edhe ndoqi studimet e larta. Këtu ajo gjeti një harmonizim të përsosur me trajnerin profesionist Taulant Stermasi, me të cilin punoi pareshtur drejt majave të ndryshme. Rezultatet e saj në harkun e dhjetë viteve, nga 2012 e deri në vitin 2022 janë vërtet mbresëlënëse. Në 10 vitet e fundit ajo ka arritur të fitojë 10 medalje, prej të cilave 6 të arta dhe katër të argjendta, pa llogaritur disa vende nderi në mitingje apo turne të ndryshëm. Kulminant mbetet padyshim viti 2022, ku në katër evente ballkanike, mesdhetare, europiane dhe botërore arrin të marrë tre medalje ari në Kampionatin Ballkanik, Mesdhetar dhe European dhe vendin e 5-të në botë. Gara e saj e preferuar është 3000 metra me pengesa, por edhe në 5000 metra është dalluar dhe disa herë fituese. Kuriozitet është fakti që Luiza Gega stërvitet në një vend si Shqipëria, pa asnjë rivale në pistën e atletikës në garat e saj dhe ia del të ngjitet në majë të Europës. Veçmas gara e fundit ishte spektakolare në stadiumin olimpiq të Mynihut, sepse ajo udhëhoqi gjatë gjithë kohës, duke lënë pas dy atlete brilante të vendeve të tilla superfuqi në këtë sport, si Gjermania dhe Britania. Luiza tregoi shpirt gare dhe qëndrueshmëri gjatë gjithë garimit, duke kontrolluar pistën si një snajpere dhe lidere e saj dhe me një nuhatje profesionale bëri diferencën dhe la pas kundërshtarët e saj, duke e mbyllur me kohën rekord 9.11.31.

Vendosja e flamurit pas garës në trupin e saj ishte një tjetër moment që përloti jo vetëm Luizën, por edhe miliona shqiptarë që e ndoqën anembanë botës.

Rrugëtimi i një vajze dibrane nga një fshat i thellë, deri në pedanën e Kampionatit European të atletikës si kampione dhe medaliste e artë.

Nga Okshtuni në Mynih...!



Pas garës Luiza ka marre mijëra mesazhe, saqë telefoni i saj ishte i bllokuar. Në një bisedë telefonike me trajnerin Stermasi zbulojmë faktin që urimet i kishte nga personalitete të rangut të lartë europian në sportin e atletikës dhe gjysma e drejtuesve të federatave europiane në atletike, ndërkaq që nuk i kanë munguar urimet dhe vlerësimet edhe nga drejtuesit dhe personalitetet e jetës politike dhe shoqërore në vend, pa harruar ata të familjes dhe sportit, të njohur dhe të panjohur.

Pritja e saj në Rinas ishte emocionuese e po aq edhe fjalët e saj të para në Atdhe, duke ia dedikuar këtë medalje të gjithë atyre që e mbështetën fluturën kuqezi të pistës.

Tashmë Luiza Gega do të vazhdojë të vlerësohet dhe nderohet në Tiranë dhe në rrethe, por për të shuar kuriozitetin e lexuesit, ju përmend faktin se vlera zyrtare e shpërblimit të saj pas kësaj medalje është e tilla, që për medaljen e artë merr 40 milionë lekë të vjetra dhe për rekordin europian shpërblehet me 60 milionë lekë të vjetra.

E thënë ndryshe, zyrtarisht pas këtij suksesi, ajo shpërblehet nga shteti me shifrën 100 milionë lekë të vjetra, por pa llogaritur shpërblimet nga sponsorë ose institucione

apo individë të ndryshëm.

Menjëherë pas garës, këshilli bashkiak i Bulqizës ka vendosur që Luiza Gega t'i jepet titulli "Qytetare Nderi", ndërsa trajnerit Taulant Stermasi "Mirënjohje e Qytetit".

Luiza Gega ka një tjetër event të rëndësishëm ndërkombëtar me 15 shtator në Bruksel dhe dëshira e saj është të vijojë ta vazhdojë këtë ritëm, edhe pse është 32 vjeç, por që për energjitë dhe mënyrën se si garon në pistë të duket sikur është në moshën e 10 viteve më e vogël.

Për gazetën "Rruga e Arbërit" ajo ka deklaruar se ka një tjetër qëllim tashmë, për të përsëritur këtë sukses që arriti si kampione Europe dhe për të marrë medalje olimpike. Përvoja e saj është e ndërthurur me mjaft element të rëndësishëm sportivë dhe njerëzorë, të cilët janë edhe baza e suksesit të kësaj kampionieje të jashtëzakonshme, që nderoi Dibrën, Bulqizën, familjen, shoqërinë dhe Shqipërinë.

Të ruajt Zoti, moj heroinë e heshtur! Ti e bërë tënden, tashmë na mbetet ne, shtetit, medias dhe popullit shqiptar, të bëjmë tonën në respektin dhe vlerësimin ndaj një ylli si ti...! Ti vlen Luiza Gega!

Pritja dhe vlerësimi

Rinas ishte zbuluar si asnjëherë tjetër mesditën e 22 gushtit, kur në aeroport zbriti për herë të parë si kampione Europe Luiza Gega, e cila ia doli të triumfojë në garën e 3000 m me pengesa në pistën e stadiumit olimpiq të Mynihut në Gjermani në prani të 70-të mijë spektatorëve. Ministria e Arsimit dhe Sporteve Evis Kushi, presidenti i KOKSH Fidel Ylli, presidenti i Federatës së Atletikës Gjergj Ruli dhe mjaft personalitete dhe të ftuar kishin dalë për ta pritur fluturën



kuqezi, e cila bëri të mundur të ngrihej dhe të valëvitej flamuri ynë kombëtar dhe të këndohej himni ynë në zemër të Europës. Atmosfera ishte festive dhe kampionja është ndjerë super e vlerësuar. Ndërkaq që mjaft media e kanë intervistuar duke i marrë emocionet e rastit.

Një ditë më pas kampiones Luiza Gega iu rezervua një pritje publike dhe institucionale edhe në sheshin para Kryeministrit dhe në ambientet e brendshme të saj ku edhe u dekorua me Kordonin e madh me Yllin për Mirënjohje Publike.

Korrik - Gusht 2022 - 17

ARRITJET MË TË MËDHA TË LUIZËS NË VITE

2013 - Medalje Argjendi në lojërat mesdhetare në Mersin, Turqi.

2013 - Medalje Argjendi në universiadën e zhvilluar në Kazan, Rusi.

2015 - Medalje Ari në garën e 1500 m në lojërat europiane në Baku, Azerbajxhan.

2015 - Medalje Argjendi në garën e 800 m në lojërat europiane në Baku, Azerbajxhan.

2016 - Medalje Argjendi në Kampionatin European, zhvilluar në Amsterdam.

2018 - Medalje Ari në lojërat mesdhetare në Tarragona në Spanjë në 3000 m me pengesa.

2022 - Medalje Ari në kampionatin ballkanik në Krajova Rumani në garat 5000 dhe 3000 m me pengesa.

2022 - Medalje Ari në lojërat mesdhetare zhvilluar në Oran të Algjerisë në 3000 m me pengesa.

2022 - Medalje Ari në Kampionatin European zhvilluar në Mynih të Gjermanisë në garën e 3000 m me pengesa dhe rekord europian me kohën 9.11.31.

Rrëfim emocionues i nënës së kampiones së Europës Luiza Gega

Mbeta pa frymë kur mora lajmin...!



Gjithmonë kam qenë e lumtur për një vajzë si Luiza, por lajmi kur ajo doli kampione Europe më la pa frymë. Mezi e mora veten nga emocionet. Po ashtu, edhe burri. Edhe pse kishim disa halle me bashkëshortin nëpër spitale, m'u duk se dhimbjet dhe hallat na mbaruan. Telefonat tonë u bënë si central. Nga nuk na merrnin. Urime të pafund nga brenda dhe jashtë vendit. Qenka vërtet një kënaqësi e jashtëzakonshme të marrësh urime të tilla. Vajza ka vite që jeton në Tiranë dhe takohemi rrallë, por atë ditë m'u duk se e bëra nuse. Lotët e saj i kam akoma në sy. Ajo qante në pistë, ndërsa unë qaja në shpi. M'u mblodhën të gjithë njerëzit, komshinjtë dhe gëzonim. S'paska gjë më të bukur se të shohësh fëmijën tënd të të bëjë krenar ty dhe Shqipërinë. Jam krenare vërtet për Luizën. Unë kam 5 fëmijë, por Luiza tashmë nuk është vetëm e imja, por e gjithë shqiptarëve e sidomos dibranëve nga vijnë.

Petrit Bajra, mësuesi i Dibrës së Madhe

Nga Osman Xhili

Familja e tij mendohet të ketë ardhur nga Macukulli i Matit, për tu vendosur në rrethinat e qytetit të Dibrës së Madhe. Ky qytet, në atë kohë ishte një qendër e rëndësishme diturie, zejtarie dhe me toka mjaft pjellore në rrethinat e tij. Të gjitha këto ishin arësye të mjafta, për të marrë vendimin e stacionimit të familjes Bajra në këto troje.

Petriti, djali i vetëm i kësaj familje e u rrit te datat, në Sollokiç, një fshat i bukur fare pranë lumit të Drinit. Erdhën më pas vitet e shkollimit. Djali i ri e kuptonte, se pa dije dhe një formim të mirë të përgjithshëm, nuk mund të bënte përpara në jetë, ndaj gjithmonë përpigjej të ishte tek më të mirët. Por krahas mësimi, sporti u bë një mik i ngushtë, që do ta shoqëronte për gati gjithë jetën. Ishin vitet e gjimnazit ato që shpalosën dhuntinë e Petrit Bajrës për dy gara të bukura e burrërore, hendbollin dhe futbollin. Profesori i tyre i fiskulturës, gjeneral Gëzim Ostreni u dha energjinë, frymëzimin dhe teknikën për këto dhe shumë sporte të tjera të kohës. Bashkë me Nuri Kolecin dhe shokë të tjerë ato konkuruan në kupa e kampionate në këto dy gara të bukura, duke korrur shpesh dhe trofe të rëndësishme.

Shkollimin e lartë e kreu në Prishtinë. Krahas nxënjes së leksioneve, që do ti shërbenin për mësimdhënien, ndjenja të larta patriotizmi u ngjiten dhe u ngjizën në shpirtin dhe personalitetin e tij. Shihet shqiptarët të ndarë e të përçarë në shtete të ndryshme dhe një brengë e mundonte shpesh. A do të vijë dita, që t'i fitojmë të drejtat e mohuara? A do të jetë e largët dita, kur kombi shqiptar të ketë fuqinë e tij reale? Ndaj ai nuk u tremb të bëhej pjesë e demonstratave dhe e tubimeve të mëdha në Prishtinë, në Prizren dhe deri në Itali dhe deri në Amerikë.

Petriti kujton një nga demonstratat madhështore, që u mbajt në Prizren, tamam aty, ku qe mbajtur Lidhja shqiptare e Prizrenit. Ishin momente solemne. Adrenalina e patriotizmit i kishte kapluar të gjithë pjesëmarrësit dhe sikur plumba të përdoreshin, nuk do ti trembnin ata mijra njerëz, të tubuar pranë flamurit shqiptar. Drejtuesi i demonstratës, i ngritur në podium, kishte marrë në dorë një flamur dhe po i fliste turmës: "Kemi lindur me flamur, jemi rritur pa flamur dhe tani po e vendosim sërish, që të valojë në shekuj". E vuri tamam aty ku e kishin vënë të parët e tij gati njëqind vjet të shkuara, ndërsa turma brohoriste dhe këndonte ... E, ky Skënderbeu..., si dhe këngë të tjera patriotike.

Petrit Bajra punoi për katër vite si mësues në rrethinat e Prizrenit, në fshatrat Gjonaj dhe Pllanëj. Bashkë me disa mësues të tjerë nga Dibra, ata rrezatuan kulturë dhe sjellje model. Aktivitetet e shumta artistike dhe sportive, që organizonte shkolla, ndikuan mjaft tek banorët, duke e ringjallur atë zonë. Ngjashëm me këtë do të ndodhte dhe pas transferimit të tij në Verbjan dhe Zhirovnicë të Rekës së Epërme. Regjimi i kohës nuk e kishte me

sy të mirë, që nga pjesëmarrja në demonstrata, ndaj donte ta mbante sa më larg qyteteve e qendrave të populluara. Verbjan kishte një histori të ndritur, që nga koha e të madhit Jusuf Bagerit, por prapë ishte lënë në harresë. Vetëm katër klasë mund të ndiqnin nxënësit në gjuhën shqipe e më pas të kullotnin lopët e të bënin punë të tjera të rëndomta. Mësues Petriti i sëmbohte në shpirt kjo situatë dramatike. Ishin gati 40 nxënës të kombësisë shqiptare, që diskriminoheshin në këtë mënyrë. Bashkë me të ishin dhe tre mësues të tjerë shqiptarë, Nuri Koleci, Qerim Duka, Fehmi Mustafaj. Ata dëshironin me të madhe që të tu krijoheshin mundësia këtyre fëmijëve të vazhdonin arsimin tetvjeçar. Më pas, shanset për tu arsimuar më tej do ti kishin më të mëdha.

Petriti u merr nënshkrimin të gjithë prindërve të këtyre fëmijëve dhe e dërgon te kryetari i Komunës së Gostivarit,



Destan Sulejmani. Ai e përcjell tek shefi i arsimit e pak kohë më vonë, një grup pune nisen që aty për të verifikuar shkollën në fjalë, nëse ishte e mundur, që të plotësohej kërkesa. Në fillim, thanë se nuk kishte kushte, më pas shtuan se nuk kishte kuadro të nevojshëm për zgjerimin. Falë përpjekjeve të paepura të grupit të arsimtarëve shqiptarë, u bë e mundur hapja e shkollës tetvjeçare në këtë zonë, që aq shumë e donte arsimin dhe diturinë.

Sërish transferohet në një shkollë tjetër, në atë të Zhirovnicës. Mësues Petriti indinjohej dhe ngrinte zërin, sa herë që shikonte, se shkeleshin të drejtat e shqiptarëve. Këtë gjë bëri dhe në Zhirovnicë, ku hapi klasën e parë për fëmijët shqiptarë. E dinte që ishte i survejuar nga rregjimi. E dinte që këto përpjekje për çeshtjen shqiptare paguheshin shtrenjtë. E dinte që kishte një familje për të ushqyer e për ti shkolluar dhe sërish nuk ndalej në betejën për hapjen e promovimin e arsimit shqip.

Data 25 maj e vitit 1981 është fiksuar mirë në memorien e Petrit Bajrës. Mësuesi patriot kishte përgatitur një program të bukur me fëmijët në gjuhën shqipe. Ishin vendosur parrulla, si dhe flamuri shqiptar në një vend të

dukshëm. Nxënësit e vegjël këndonin këngë për mëmëdheun dhe për gjuhën e ëmbël shqipe. Drejtori i shkollës e shikon gjithë këtë skenë i revoltuar dhe niset andej nga ishte flamuri. U përpoq ta heqë atë nga vendi dhe ta ulte poshtë. Po të ulte flamurin i kishte ulur të gjitha, kishte ulur shqiptarinë. Mësues Petriti e ndjek me të shpejtë dhe i bllokoi dorën drejtorit përpara se të kryente veprimin. Nuk do ta lejonte atë të hiqte atë flamur, që frymëzonte një komb, gjithnjë në luftë, gjithmonë të përgjakur, por kurdoherë krenar e të vendosur. Ky ishte caku, ishte kufiri që kishte shkelur Petrit Bajra dhe rregjimi nuk e toleronte më. Dy ditë më vonë, disa policë vijnë në shkollë dhe e prangosin mësuesin në sytë e fëmijëve. Teksa trupa policore po e çonte drejt makinës, që do ta përcillte për në burg, mësuesi ktheu dhe njëherë kokën drejt shkollës dhe fëmijëve, të cilët do ti mungonin

Petriti e priti me shumë kënaqësi pluralizmin dhe ardhjen e demokracisë. Ai ishte ndër nismëtarët e krijimit të partive politike shqiptare, duke qenë dhe në kryesi të tyre. Por shpejt e kuptoi se loja nuk shkonte ashtu siç e pati menduar. Liderët e tyre dhe jo vetëm, shpesh i humbnin rrugës idealet, linin në baltë luftëtarët, votuesit e kështu me rradhë. Ndaj ai u tërhoq në qetësinë e tij, për të mos e prishur atë dinjitet, për të cilin aq shumë kishte luftuar. As paratë që i afroheshin dhe as ndonjë post të rëndësishëm nuk e pranoi, në këmbim të baltosjes së karakterit të tij të paepur.

për një kohë shumë të gjatë. U dhuroi atyre një buzëqeshje të madhe, që ta kishin kujtim për gjithë jetën, si një simbol i rezistencës dhe qëndresës kombëtare.

Ndoshta do të vuante gjatë nëpër burgje, sikur të mos e ndihmonte një mik i tij. Vetëm dy muaj zgjati burgimi, por i kumtuan një vendim të ashpër: "Sa të jetë në këmbë shteti jugosllav, ti nuk do ti shohësh me sy dyert e shkollës". Vërtet, ashtu ndodhi. Ishte ky një mesazh i shtetit jugosllav për të gjithë ata arsimtarë, patriotë dhe atdhetarë, që do përpiqeshin në të njëjtën mënyrë si ai.

Një ekuacion me shumë të panjohura shpërfaqet përpara arsimtarit në lirim. Ku do të shkonte tani dhe me se do të merrej? Si do t'i ushqente tre fëmijët, që ishin akoma të vegjël? Ai kishte bërë plane dhe për ti shkolluar dhe planet nuk po i dilnin, por jo për faj të tij. I vetmi faj i tij kishte qenë se qe treguar më shumë patriot se duhej, më shumë trim se duhej dhe kish guxuar të ndeshej me një makineri ushtarake, që i kishte të gjitha në dorë.

Provoi punë të rëndomta, që nga bërja e betonit, deri tek ndërtimi i çative. U end nëpër Europë e jo vetëm. Provoi dhe të nxehtin e Irakut, ku punoi kompania, ku ishte punësuar. Shkoi dhe në Amerikë për katër vite, duke plotësuar gati një dhjetëvjeçar në emigracion. Malli për familjen e ktheu sërish në vendlindje. Kishte ardhur viti 1990 dhe kohrat po ndryshonin. Shteti jugosllav po shkërmoqej. Hapësira të reja po krijoheshin, ëndërra të reja po thurreshin.

Petrit Bajra inkudrohet sërish në armatën e arsimtarëve shqiptarë, i aftë dhe i gatshëm për të mësuar nxënësit, që aq shumë i kishte dashur dhe aq shumë kishte bërë për ta. Për tre vjet punoi në shkollën e fshatit Hamë, në kufi me Shqipërinë dhe më vonë transferohet në qytet, te shkolla Seit Najdeni. Kështu vazhdon për gati njëzetë vite të tjerë, derisa doli në pension në vitin 2011.

Petriti e priti me shumë kënaqësi pluralizmin dhe ardhjen e demokracisë. Ai ishte ndër nismëtarët e krijimit të partive politike shqiptare, duke qenë dhe në kryesi të tyre. Por shpejt e kuptoi se loja nuk shkonte ashtu siç e pati menduar. Liderët e tyre dhe jo vetëm, shpesh i humbnin rrugës idealet, linin në baltë luftëtarët, votuesit e kështu me rradhë. Ndaj ai u tërhoq në qetësinë e tij, për të mos e prishur atë dinjitet, për të cilin aq shumë kishte luftuar. As paratë që i afroheshin dhe as ndonjë post të rëndësishëm nuk e pranoi, në këmbim të baltosjes së karakterit të tij të paepur.

Petrit Bajra ka një vilë të bukur, diku në periferi të qytetit dhe një oborr gjigand. Ai është plot me kajsirë, lujthi, lajthi mollë e shumë pemë të tjera. Mbjell dhe pak perime, për të kaluar kohën dhe u shërben me përkushtim. Pret dhe përcjell miq të shumtë intelektualë, nga të gjitha anët në rezidencën e tij.

Zoti i fali tre fëmijë të mrekullueshëm. Gëzimi punon e jeton në Bolzano të Italisë, kurse Dritani është shef guzhine në një nga restorantet më të mira të Belgjikës. Vajza e tij, Besa, ka mbaruar për gjuhë letërsi dhe gazetari. Është e punësuar në ministrinë e arsimit në Bruksel, ku jep kontributin e saj modest. Petriti ka shumë dekorata të fituara me punë dhe shumë shkrime që flasin për jetën e tij të trazuar. Ai është një njeri me shpirt poeti dhe ndoshta shumë shpejt mund të nxjerrë një libër me poezi, që nuk janë tjetër, vetëm mbresa të jetës, ku ai dha më të mirën në dobi të shoqërisë dhe çeshtjes shqiptare.

Copëza nga krijimtaria e popullit tonë

Në këtë vëllim autori Shaqir Skarra, që është një mbledhës dhe studiues i zellshëm i krijimtarisë popullore, historisë dhe trashëgimisë kulturore të popullit tonë, ka paraqitur një tufë legjendash dhe anekdotash që kanë vlera artistike e gjuhësore, letrare, historike e folklorike të padiskutueshme. Këto do t'i kuptojë lexuesi që në faqet e para të këtij botimi. Nga shumë legjenda, tregime popullore, anekdota e fabula që i ka gjurmuar me pasion dhe i ka vjelë me kujdes te persona të moshave të ndryshme, nga ato që i përdor me aq kujdes konaku i Dibrës dhe i trevave të tjera të vendit, nga ato që ka dëgjuar në Odat e Dibrës kohë pas kohe, ai ka zgjedhur disa nga më të mirat, që ka menduar se janë edhe të nevojshme, edhe të këndshme për lexuesin. Ndonjëra prej tyre edhe mund të jetë e njohur ose pak e njohur, por që është thënë me ndryshe, duke pasur parasysh se subjektet që janë shfrytëzuar për këtë qëllim, kanë qenë ose janë gojëtarë e të mençur, për ta thënë sa më bukur mendimin. Prandaj, mendojmë, se botimi ka originalitet në llojin e vet.

Disa nga legjendat, ndonëse janë të përhapura gjithandej, nga mënyra se si tregohen, nga vendi ku zhvillohet ngjarja që lidhet me to, nga forma dhe mjetet artistike që janë përdorur, si dhe nga gjuha dhe mënyra e ndërtimit, tregojnë se kanë veçoritë e tyre. Le të kujtojmë se si futet elementi fantastik në disa prej legjendave, si tek “Brezi i ndrikullës”, “Kali i nuses”, “Përse nuk këndon bilbili në Vleshë”, etj.

Në grupin e legjendave janë futur edhe disa tregime historike, që kanë personazhe historikë realë e ngjarje reale, por që, me kalimin e kohës, janë futur dhe elementë mitikë ose fantastikë e përrallorë, por që mbajnë në vetvete ngjarje të përjetuara, disa jo shumë të lashta. Populli këto ngjarje e këto figura të rëndësishme historike i ka veshur me petkun e legjendave, për t’u dhënë përmasa më të mëdha, përmasat e heronjve legjendarë, ashtu siç ndodh edhe me heronjtë e eposit të kreshnikëve.

Të kësaj natyre janë edhe disa tregime të tjera legjendare si “Bolla e Boçevës”, “Leka i Lashkizës”, etj.

Në disa legjenda autori ka vënë në fund edhe këngën popullore që lidhet me ngjarjen, kur ka pasur mundësi ta gjejë një të tillë, pasi shpeshherë të tilla këngë nuk kemi, veç ndonjë fragmenti që ka mbetur. Të tilla këngë janë më së shumti për ato ngjarje që nuk kanë një të kaluar të largët dhe kujtesa e popullit ka mundur t’i ruajë, siç është rasti i këngës për Hase Has Kaloshin, “Kënga e dullakut të kuq”, etj.


Në pjesën e dytë autori ka mbledhur dhe botuar disa nga anekdotat që s’e kanë humbur aktualitetin, ndonëse shpesh kemi dhe persona e ngjarje të përjetuara kohë më parë. Çdonjëra prej tyre ka një vlerë morale, është, si të thuash, një tregim që të mëson, që jep atë përvojë, që brezat tanë i kanë provuar, që kanë nxjerrë një mësim prej tyre. Kemi anekdota për shoqërinë në përgjithësi, për ngjarje e shëmbëlltyra nga koha në kohë, tregime të shkurtra e koncize me një përfundim të qartë moral. Mes tyre ka dhe anekdota historike, por shumica e tyre, ndonëse kuptohet qartë për atë që e njeh Odën e Dibrës, personazhi mbetet anonim. Kështu i ka pëlqyer autorit, sepse ngjarje të tilla janë shumë të zakonshme e mund t’u vësh çfarëdolloj emri.

Një pjesë të rëndësishme të vëllimit zënë anekdotat. Tematika e tyre është e larmishme. Kemi anekdota për jetën shoqërore, për probleme sociale, për marrëdhëniet në familje e ato bashkëshortore, për ngjarje në jetën intime, për moralin në përgjithësi, anekdota historike me ngjarje reale e përvojë jetësore, pyetje problemore që ishin e janë akoma të pranishme në Odat e Dibrës etj. Disa herë këta anekdota marrin ngjyrimë satirike e humoristike, duke i bërë të ngjashme me barceletat e zakonshme. Autori është treguar i vëmendshëm që këta të jenë sa më aktuale dhe të shërbejnë edhe si mësim, sidomos për të rinjtë.

Shumica e anekdotave kanë brenda tyre persona realë, të njohur gjithandej për mençurinë e tyre, për veprimet e tyre, ku shquheshin në dhënien e mendimeve me vlera jetësore, me një gjuhë të bukur, të thjeshtë dhe lakonike. Të tillë mund të përmendim Mane Kacanin, Tafë Kolën, Elez Isufin, Salë Demirin, Selim Mandrin, Selim Sulën, Majrë Skarrën, Llan Kaloshin, Marka Brungën, Haki Memën, etj. Në shumicën e rasteve autori na jep dhe vendin ku lindi anekdota, si Luznia, Zeqani, Vlesha, Dardha, Reçi etj. Kjo mënyrë, mendojmë se u jep më tepër vërtetësi anekdotave, duke i bërë më tërheqëse dhe duke shprehur një mendim edukues.

Ashtu si në legjendat, por më tepër tek anekdotat, autori është munduar t’i qëndrojë sa më afër gjuhës, duke shmangur disa nëndialektalizma që e vështirësojnë kuptimin e tyre.

Por është pasur kujdes që të ruhet leksiku original,



Oda dibrane

Ende sot e kësaj dite ajo vazhdon të mbetet një thesar i pazbuluar, një arkiv i gjallë i historisë. Këtu dhe vetëm këtu në një odë mesatare, shtruar bukur me mutaf e herë-herë me sixhade shoshiteshin mendjet. Këtu dhe vetëm këtu ishin të gjitha bashkë alegoria dhe fjala e mençur, anekdota dhe tregimet historike, legjendat dhe pse jo edhe vetë përrallat. Padyshim institucioni i Odës dibrane është një nga vlerat më të mëdha të Dibrës. Shumë veta që nuk e njohin Dibrën, me të drejtë mund të shtrojnë pyetjen: Pse Oda dibrane? Çfarë domethënie ka kjo? Shqiptarë e të huaj e kanë quajtur Odën dibrane si një universitet. Universiteti i Dibrës e ashtu vazhdon të quhet përsëri. Të huajt kanë ardhur në Dibër e kanë pyetur të habitur: Ku është godina e Universitetit? Kush janë profesorët e tij? Përgjigjen e kanë marrë vetëm kur janë ulur shtruar në Odën dibrane me pleqtë qeleshebardhë ballë përballë.

Kuvendet në odat e Dibrës ishin skena e tribuna të thjeshta. Aty dhe vetëm aty shoshiteshin e siteshin mendjet, ngjarjet e ditës, historitë dhe heronjtë, alegoria e anekdotat dhe legjendat. Oda dibrane ishte tamam si një arkiv që ruante materiale me vlera, thesare dhe stoli që ishin dhe mbetën pronë e Dibrës. I vetmi burim i tyre në Dibër ishte dhe vazhdon të mbetet Oda dibrane. Sot nuk mund të themi se alegoria kishte lindur në Dibër dhe i përkiste vetëm asaj, dhe pse mjaft studiues që janë marrë kohët e fundit me alegorinë, lënë si vendlindje për të, Dibrën. Kjo nuk mund të jetë e vërtetë.

Unë autori i këtyre radhëve kam lexuar disa tregime ruse të Tolstoit dhe me të vërtetë më kanë mahnitur. Ato ishin të gjitha alegori. Alegori kam gjetur dhe në Kosovë, e cila praktikohej shpesh nëpër konaqe. Alegori ka dhe në Kukës, në ato fshatra që kufizohen në fakt me Dibrën.

Pleqtë tregojnë se para dhe gjatë epokës së Skënderbeut alegoria nuk përmendej në Dibër. Njerëzit atëherë ishin disi ndryshe. Nuk bënte efekt as çifligu, as paraja, por i kishin dhënë besën kryetrimin të shpormin njëherë e përgjithmonë murtajën e huaj nga trojet e tyre. Më vonë, kur dhe vetë njerëzia filluan të tjetërsohen, lindi dhe alegoria, që të huajt Dibrën e quanin një shkollë të vërtetë, një shkollë në të cilën nuk mund ta kalonin të gjithë klasën. Njerëzit me anën e alegorisë kuptoheshin qartë njëri me tjetrin edhe në një konak, ku aty kishte njerëz të dyshimtë apo të shitur te pushtuesi.

Bartësit e tregimeve alegorike ose, më saktë, profesorët e Universitetit të Dibrës ishin pleqtë, por nuk përjashtoheshin as moshat e reja.

Janë shkruar për Odën dibrane, për folklorin aq të pasur të Dibrës, janë botuar studime e libra mjaft me vlerë. Është gërmuar me kujdes në kujtesën e popullit për të dalë në dritë ai thesar që quhet sot folklori i Dibrës. Dhe unë nuk jam i vetmi që kam punuar për të mbledhur atë që ishte fshehur vite me

sidomos disa shprehje frazeologjike që janë tipike në të folmen e kësaj treve ose disa shprehje që tashmë janë bërë proverbiale e përdoren dendur në ligjërimin e zakonshëm. Kështu mund të përmendim: “Shorti jem - fati im”, “o një fjalë, o një djalë” (“Gruaja e mirë të le ose një fjalë të mençur, ose një djalë të zot”), “të mos lefshin (lindshin) në derë”, “mos shij në lamën e tjetërkujt”, ose siç e kemi në këtë dialog:

- A janë të rritur, a veç për mullë?

- Hem për mullë, hem për llullë.

Është pasur kujdes, veçanërisht në dialogje, të ruhet sa më shumë e folmja origjinale, duke përdorur një gegërishte të kuptueshme.

Le të sjellim disa vargje nga ato që i thotë e reja të vjehrrit, për t’i shprehur mendimin që ka për të shoqin tek “Gruaja e mençur”:

Ah, mor babë,

Shkove e vdiqe,

Kumonën si kishe

E kujt ia vare,

Se për gjal’ (djalë) si lae

Nuk të ban një pare...

Të tilla anekdota interesante me tematikë nga më të ndryshmet ka me shumicë vëllimi, i cili, veç vlerave që sjell në përmbajtje, sjell dhe vlera letrare e gjuhësore. Ne mendojmë se Shaqir Skarra me këtë botim të ri, që nuk është libri i tij i parë, ka sjellë disa nga krijimtaria e pasur e popullit tonë, nga proza e tij, e cila, sidomos në këtë gjini, pasurohet vazhdimisht duke sjellë risi dhe vlera artistike.

I urojmë autorit që të na sjellë të tjera botime, sidomos ato që burojnë nga gurra e pashtershme e popullit tonë.

Eraldë Skarra (Xhafa)

radhë. E kanë mbledhur, studiuar dhe botuar folklorin dibran pena të njohura si Haki Stërmili, Haki Sharofi, Xhelal Ndreu, Haziz Ndreu, Hilmi Kolgjegja, Naim Plaku, Xhafer Martini, Shaban Sinani, Agron Tufa, Hajri Mandri, Mevlud Buci, Sakip Cami, Sami Shehu e plot e plot të tjerë. Falë këtyre, që vërtet kanë punuar me përkushtim e profesionalizëm, sot shumë nga thesaret e Odës dibrane i kemi të botuara dhe i mbajmë si libra tavoline në shtëpitë tona. Por një fakt është në Dibër, se nuk ishin vetëm pleqtë, profesorë të alegorisë. Në të shumtën e rasteve kishte dhe mjaft gra fisnike, që mund t’ua kalonin dhe burrave për nga zgjuarsia. Në përgjithësi, arsimi u mungonte, por dhuntitë e inteligjencës popullore i kishin tepër të spikatura. Nëpër odat e Dibrës shprehej gjykimi dhe zhvillohej mendimi i pavarur, shprehej e folura me nëntekst të fuqishëm e me ngarkesë emocionale, përsosje kultura e parashtrimin të mendimeve. “Tematika e tregimeve alegorike është shumë e gjerë dhe e larmishme, pothuaj nuk ka sferë të jetës që ato nuk e rrokin. Të pastra dhe me nivel të lartë janë ato tregime alegorike që pasqyrojnë probleme të mprehta politike”⁻¹⁾.

Po të hulumtosh sot në “arkivin e Universitetit të Dibrës”, ato janë shumë. Aq shumë sa mund të mbushen vëllime të tëra. Disa nga profesorët më të njohur të odës dibrane janë Dine Hoxha, Tafë Kola, Maliq Nikolli, Sulë Dika, Selim Sula, Mane Kacani, Selim Dika (Mandri), Demir Skarra etj. Falë kësaj alegorie dhe fjalës së mençur dibrane, këto janë bërë të njohur jo vetëm në Dibër, por dhe jashtë saj. Thëniet e tyre nga kujtesa popullore nuk shuhën lehtë. Ato ende gjejnë përdorim në odat dibrane, pasi alegoria nuk ka fund. Ajo krijohet në çast në mexhelisin ku ndodhesh sipas situatës që krijohet. Kur gjakrat nxehe e muhabeti fillon e prishet, atëherë dhe tregimtari i alegorisë hesht. Hesht edhe kur tjetri që e ngacmon nuk kupton fare nga alegoria.

“Odat dibrane ishin mjedise, ku alegoria jo vetëm përdorej, por edhe prodhohej, përpunohej, afroheshin fakte dhe ngjarje rreth një ideje, dhe përzgjidhej, fiksohej në memorie rrëfenja më e bukur, më e përpunuar artistikisht”⁻²⁾.

Alegoria dhe tregimet popullore dibrane as janë shuar, as do të shuhën kurrë. Ato i ushqen përherë oda dibrane, ky “universitet popullor”, që ka mahnitur jo vetëm vendasit, por dhe të huajt. “Unë kam mbaruar universitetin e Oksfordit, por mbarova dhe një universitet të dytë, atë të Dibrës” - shkruan studiuesi anglez Riginald Hibbert në gazetën “Albania life”.

Në këtë “shkollë” u rritën breza të tërë burrash e grash, që veç trimërisë e zgjuarsisë, trashëguan në shekuj atë kulturë, atë pasuri të madhe të folklorit në tërë përmasat e tij, duke fituar kështu vlera të veçanta, që po i gjallëron për çdo vit “Oda dibrane”⁻³⁾

1-Xhafer Martini. “Dibra dhe etnokultura e saj”

2-Hajri Mandri “Shëmbëlltyra në folklor dhe letërsi”, faqe 56

3-Nga albumi “Oda dibrane”, botim i Qendrës Kulturore Peshkopi me rastin me rastin e dhjetë vjetorit të saj .Tiranë 2005

Shënim: Marrë nga libri me të njëjtin titull.

Tregim
nga Ramiz Gjini

Urrëjtja

Katundi ka atmosferë të zymtë kur qentë që mbahen lidhur me zinxhirë, qajnë me angullimë lirinë e mohuar. Edhe katundari, - ai që e ka lidhur veten vetëm pas bishtit të lopës dhe tokës, - lëshon me mënyrën e vet angullimat e tij. Ndonëse këto angullima jenë të përsosura nga forma, sepse janë gjuhë njerëzore, përmbajtja është e njëjtë me ato të qenit. Por, kur sedra e tij e sëmurë lëndohet deri në palcë nga i ngjashmi i tij, kjo angullimë kthehet në grindje. Veçse tashmë, burimi i kësaj grindjeje, është urrejtja. Në pamundësi për të këputur zinxhirin e hekurt, me të cilin e ka lidhur fati, ashtu si një egërsirë e rënë në çark, ai nis e bren me dhëmbë këmbën e vet. Një i tillë është edhe Hidër Dami, personazhi i këtij rrëfimi, i cili, teksa dridhej si në ethe nga inati, i kërkoi varrmihësit Lec Bumsi të hapte një varr për komshiun Jak Voskopi.


Ato çaste, varrmihësi Lec, i shkurtër dhe rrondokop nga shtati, gjithnjë i papërtuar, po nxirrte me kazëm gurë nga themelet e ish shtëpisë së tij të vjetër. Me të dëgjuar kumtin për Jakun, ai la punën dhe fort i çuditur pyeti:

- Ç’thua kështu, Hidër?! Paska vdekur Jaku?!
- Nuk ka vdekur, jo, - ia pat Hidri që vazhdonte të dridhej, - Por, do të vdesë shumë shpejt. Jemi grindur për një gardh që e ka futur maskarai një pëllëmbë në kopështin tim. Dhe iu betova që do t’i bëj varrin.
Varmihësit Lec Bumsi iu duk pak si e ngatërruar kjo punë. Po ai, nuk qe tip që e vriste shumë mendjen. Krejt problemin e kishte, sepse nuk dinte, çfarë çmimi t’i jepte Hidrit për të hapur varrin e Jakut; sepse nuk i kish ndodhur kurrë ndonjëherë të hapte ndonjë varr për të gjallët.

Hidër Dami, futi dorën në xhep, nxori një kartëmonedhë njëzetë mijë lekëshe dhe ia zgjati.
- Merre, - i tha, - Po të paguaj qysh tani.
Dukej ashikare që ishte bërë tym.
Po varmihësi Lec, ngurroi t’i merrte lekët.
- Jo, jo! - kundërshtoi ai, - Nuk mjaftojnë aq lekë, Hidër! Unë marr njëzetë mijë lekë për t’u hapur varr të vdekurve; kurse për të gjallët... Tani, po më vjen zor ta them, por e kam më të lartë pazarin.
- Njësoj është, bre Lec! - ngulmoi Hidri, teksa tentoi sërish t’i fuste me pahir kartmonedhën në xhep,
- Jo, jo, - tha sërish Leci duke u zbrapsur, - Nuk është hiç njësoj!

- Si nuk qenka njësoj, Lec?! - kërceu përpjetë Hidri, - Kur Jak Voskopi të varroset, do të jetë i vdekur.
- E kuptoj, e kuptoj, ku e ka fjalën zotnia juaj, - tha nxitueshëm Leci, teksa i largonte dorën, në të cilën Hidri mbante kartmonedhën, - Por Jaku, o byrazer, tani është i gjallë! Mund të më dalin telashe! Tjetra që dua të them është, sepse gjithnjë, unë paguhem nga njerëz që e kanë dashur të vdekurin në të gjallë të tij. Kurse për ata që hapin varre për të gjallët nga urrejtja, kam çmim më të lartë.

Hidër Dami, po e vështronte në heshtje, pa ditur ç’të thoshte.
Ato çaste u dëgjua e pallura e një gomari.
Hidri, që e njihte zërin e gomarit të tij, u kujtua që e kish harruar lidhur qysh një ditë më parë në një djerrinë prapa shtëpisë; sepse pas gjithë asaj shamate



që bëri me komshiun Jak Voskopi, - dreqi ta hajë, - kuptohet që do ta harronte.

Ai bëri të largohej për të shkuar që t’i ndërronte vend gomarit, por u kthye e tha:

- Pa më thuaj, Lec, - se ndoshta rregullohem bashkë, - sa e ke pazarin për t’u hapur varr të gjallëve?

Pasi u mendua njëherë, Leci tha se donte njëqind mijë lekë.

- Bah! - ia bëri Hidri, kësaj here duke u zgërdhirë hidhur, - Nuk ia vlen hiç të paguash kaq para për varrin e një maskarai si ai!

Dhe, phu, pështyu.
- Po sa lekë mendon të japësh zotrote? - pyeti varmihësi.

- Dyzetë mijë lekë, - tha Hidri, - Mjaft i ke!
- Dyzetë mijë?! - u skandalizua tjetri, - Seriozisht e ke zotrote?! Unë as qenit tim nuk do ia bëja gropën për dyzetë mijë lekë, e jo t’ia bëj Jak Voskopit. Dhe të mendosh që Jaku, mund të më paguajë mua për varrin tënd, ndoshta, dyqind mijë të thata në dorë!

Ky hamendësim i varmihësit Lec për Jakun që mund të paguante më shumë për varrin e Hidrit, e bëri këtë të fundit ta ngrinte pazarin.

- Atëherë, po të jap gjashtëdhjetë mijë, - tha ai.
- Më jep tetëdhjetë dhe e mbyllim këtë punë, - tha Lec Bumsi, - Nuk janë shumë, besomë!
- Jo, jo! - kundërshtoi Hidri, - Besomë ti: tetëdhjetë mijë janë shumë! Si mund të paguaj unë kaq para për atë që, as emrin nuk dua t’ia zë me gojë?! Ai, thjesht, një qelbanik është! Megjithatë, ja ku po ta shtoj edhe një dhjetëshe. Po t’i bëj shtatëdhjetë!

- U bë! - tha varmihësi Lec. Dhe, duke e vështruar shtrembër me kokën e rrëzuar mbi supin e djathtë, pyeti: - Për kurë e doni zotëria juaj të jetë gati varri i Jakut?

Hidër Dami nisi të bënte me mend një llogari: nesër, mendoi ai, kam për të vajtur në pazar që të ther viçin dhe mishin ta shes; sepse po më arrestuan, gruas do t’i duhen para për avokatin. Pasnesër do më duhet të thur planin, si dhe të mpreh sëpatën për t’i larë mirë hesapet me Jakun.

- Varrin e dua që të jetë gati për tjetërpasnesër, - tha Hidër Dami pas llogarisë që bëri me mend, - Veçse, dëgjo këtu ç’po të them: - i tërhoqi vëmendjen ai duke i tundur varmihësit gishtin tregues mu para hundës, - Varrin, dua t’ia bësh shumë të thellë.

- Deri në brez, - tha Leci duke shënjuar me dorë një gisht poshtë kërthizës e duke e vështruar sërish vëngër me kokën e rrëzuar në sup. - Kaq është si rregull për burrat. Nëse zotrote, do që të jetë më i thellë, do paguash më shumë.

- Hë, tani, Lec! - e nxiti Hidri, - Të mos prishemi për pak gjë! Bëje, vetëm edhe një pëllëmbë më të thellë. Mos ma prish qejfin!

- Ç’thoni kështu, zotnia juaj?! - kërceu menjëherësh përpjetë Leci, - Aq shumë gurë ka ajo tokë sa, për të hapur varrin, do më duhet të përdor më shumë levën dhe tokmakun, se kazmën dhe lopatën. Harrove zotrote që unë e kam ndërtuar shtëpinë e rë me gurët që kam nxjerrë nga toka duke hapur varre?!
- Mirë, pra! - u dorëzua Hidri, - Edhe gjer në brez, mjaft e ka ai!

Dhe si pështyu sërish, nëpërdhëmbi:

- Maskarai i mutit!
Hidri i dha varmihësit Lec, vetëm njëzetë mijë lekë si kapar, sepse nuk i pati të gjitha me vete.
- I paska ikur mendja për lesh të shkretit! - tha me vete varmihësi Lec Bumsi, kur Hidri qe larguar, - Ky u dashka dërguar urgjent në çmendinë!

Të nesërmen, Hidër Dami u ngrit nga shtrati në zbardhëllim të agut të mëngjesit.

- Ku shkon, Hidër?! - e pyeti përgjumësh e shoqja e tij, Mara, sepse e ndjeu që po dilte nga shtëpia.

- Në Pazar, të shes viçin, - tha ai.
Gruaja brofi menjëherë nga shtrati dhe zuri vend ndenjor.

- Të lutem! - i tha, teksa picërronte sytë e përgjumur, - Nëse njeh zot, mos na e shit viçin! Kam parë në ëndërr sikur po na digjej shtëpia!

- Këto punë i di unë, - ia pat përnjëherësh ai, - Ti merru me ëndrrat.

Dhe doli duke përplasur gjithë inat derën nga prapa.

Si doli nga shtëpia, ai vajti dhe hyri në ahur duke e lënë derën hapur dhe u përpoq të nxirrte viçin jashtë. Por viçi nuk po i bindej. Sillej rrotull i trembur, ngjishej pas lopës dhe nuk donte të dilte. Atëherë, Hidri i rراسi në qafë një litarë dhe e tërhoqi pothuajse zvarrë, derisa e nxori në oborr. Aty e vuri para dhe mori rrugën për në pazar, që ta therte dhe ta shiste si mish.

Viçi qe, - si i thonë një fjale, - viç për kokën e viçit! I njomë, i bardhë me njolla të zeza; kurse sytë i kishte të mëdhenj, paqësorë e të pafajshëm - kopje e vogël e së ëmës. Ecte viçi para të zotit, urtë e butë, duke lëvizur herë bishtin, herë kokën për të larguar mizat, pa e ditur që po shkonte ta therrnin.

Rrugës, ndodhi që Hidri u takua me nunin e tij, Dino Emirin. Kishte bujt një natë te vajza e vet në qytet dhe po kthehej në shtëpi. Me t'u përshëndetur, Dino i nguli vështrimin viçit e tha:

- Marshalla, çfarë viçi paske, Hidër! Duket rracë fort e mirë!

- Racë hollandeze, - tha Hidri.

- Për më tepër, qenka edhe femër!

- Po, femër është.

- Çfarë ke ndërmend të bësh me të, Hidër?

- Do ta ther, o nun.

- Pashë Zotin, mos e ço në thikë këtë krijesë aq të bukur! - iu lut me keqardhje Dino Emiri.

Hidër Dami pështyu një fije bari që e mbante mes dhembëve, pastaj ofshani e tha:

- Halli, nun, halli! Ashtu e kam një hall!

Dhe u zymtua në fytyrë mu si t'i kishin prekur një plagë të maisur.

- Po ç'hall na paske, Hidër?!

Tjetri nuk foli.

- Nejse! - u tërhoq Dino, - Ti e din vetë këtë punë! Por të ishte për mua, nuk do gjendej hall që do më bënte të ther këtë bukurosh! Aq i mirë qenka, aq i pafajshëm, aq i ëmbël sa, tani po më vjen ta përqafoj.

Dino u përkuul dhe i dha viçit një përqafim.

Pastaj, dy burrat i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe u ndanë.

Përqarimi që i dha viçit nuni Dino, si dhe fjalët plot dhembshuri që ai nxori nga goja, ngjallën tek Hidri keqardhje të madhe. Filloi të dyshonte: mos ndoshta, për shkak të inatit që e kish mbërthyer, nuk i pati bërë mirë hesapet?! Por, sapo çonte ndër mend komshiun Jak Voskopi, edhe pse nuk ishte i sigurt nëse duhej ta vriste apo jo, e kapte inati më fort. I bëhej sikur Jaku kish lindur vetëm për të zezën e tij, ndaj nuk duhej të jetonte; sikur gjithë hapsira ku e shkonte jetën qe ngushtuar; madje, edhe ajri qe pakësuar për shkak të ekzistencës së komshiut. Atëherë, i thoshte vetes:

“Shumë mirë i kam bërë hesapet! Më duhen paratë për avokatin. Fundja, edhe pse i bukur e i dashur, një viç është ky. Do më pjellë lopa një tjetër”.

Kur Hidri mbërriti në pazarin e gjësë së gjallë, vendina gëlonte nga njerëzit. Pazarit kutërbonte gjithandej nga era e plehut, nga avujt e shurrës dhe hukama e lopëve që ripërtypnin në heshtje ushqimin. Nën diellin përvëlues të fillimgushtit, vapa qe kthyer në një ufëm, dhe ajri qe rënduar e bërë si pelte e tejdukshme.

Ata që shisnin, qëndronin në këmbë pranë kafshëve të tyre. Por kishte edhe të ulur në ndonjë samarë, apo në kosha të kthyer përmbys, që i kishin përdorur për të sjellë aty pula, pata dhe rosa. Shumica prej tyre tymosnin duhan me të dredhur. Nganjëherë më të rrallë, i hidhnin ndonjë fjalë tjetrit përbri, ndërsa përpiqeshin të largonin mizat me duar. Dhe, sapo afrohej aty ndonjë myshteri, s'u pushonte goja duke lavdëruar mallin që donin të shisnin.

Dhe ja ku ju afrua Hidrit një kasap tullac fytyrëkuq me sy të dalë, që i pati përveshur mëngët e këmishës së tij të zezë gjer në bërryla. Duart i kishte të ndotura me gjak bagëtish dhe mbante në brez një biçak të hatashëm kose. Quhej Telat, por të gjithë e thërrisnin “Xhelat”! Kundrejt një pagese, “Xhelati i pazarit” i therte dhe rjepte bagëtitë në prezencë të të zotërve në një kohë rekord.

- Për shtatë minuta, ta jap lëkurën e viçit në dorë, - i tha ai Hidrit, teksa i kishte ngulur kafshës vështrimin e syve të tij të dalë gëlldëq nga zgavrat.

Po Hidër Dami, që i kumbonin ende në vesh fjalët e nunit të tij, nuk i bënte zemra ta shikonte viçin të jepte shpirt në duart e këtij njeriu.

- Jo, - ia ktheu Hidri, - Viçin kam vendosur ta shes në këmbë, kështu siç është i gjallë.

- Afrohu këtu, byrazer! - e ftoi aty për aty një zë i trashë burri nga e djathta që sapo kish dëgjuar fjalët që Hidri i tha kasapit fytyrëkuq, - Tërhiqe viçin sa të shkelë në peshore, merr paratë dhe ik. Mos humb kohën kot; sepse të ngulesh këtu si gurë varri deri në darkë, nuk ta blen kush me çmimin që të jap unë.

Ky qe një burrë trupmadh e kaba, i cili përhapte aty rrotull një duhmë kafshe të egër. Ai i blinte viçat të gjallë, i ngarkonte në një kamion dhe i çonte në kryeqytet ku ua shiste pronarëve të dyqaneve të mishit.

Në fillim Hidri hezitoi, por kur foli me të, u bind që t'ia jepte viçin.

U deshën dy burra për ta shtyrë viçin që të hipte në atë peshore të madhe, sepse nuk bindej. Teksa e shtynin, kafsha e re nxori një zë ankimtar mu si të kish ndjerë biçakun në fyt. Pasi e hipën në peshore, ai

ktheu kokën dhe i nguli të zotit vështrimin e pafaj të syve të tij të bukur. Qe një vështrim pyetës dhe lutës njëherësh, athua se kërkonte të dinte, çfarë po ndodhte me të. Ato çaste, Hidër Dami iu bë, sikur dikush ia kapi zemrën me dorë. Qe dora e zgjatur e komshiut të tij, Jak Voskopit, të cilin e urrente dhe i qe betuar se do t'i hapte varrin.

Gjatë gjithë rrugës së kthimit për në shtëpi, Hidri e dëgjoi edhe qindra herë të tjera zërin ankimtar të viçit, si dhe kujtoi momentin kur kafsha e vogël i pati hedhur për herë të fundit atë vështrimin pyetës dhe lutës njëherësh! Aq shumë iu dhimbs, sa iu mbushën sytë me lot. Nganjëherë, ai mendonte që, me atë çmim që i dhanë, nuk e kishin paguar keq. Dhe ky qe për atë një fakt ngushëllues. Por, me të kujtuar ato që thamë më sipër, i dukej sikur, sapo kish bërë një krim. Kurse paratë, sikur nuk ia kishin dhënë si pagesë për mallin e shitur, por ia kishin dhënë si pagesë për krimin. Por tashmë, kjo punë kish mbaruar kështu. Nuk mund të zhbëhej më, për t'u ndrequr tjetërsoj.

Në gjysëm të rrugës, qielli erdh' e u murrëtye. U bë si një mapë e lagur me ujë të nxehtë. Pastaj shumë shpejt nisi një shi i rrallë, pikat e mëdha të të cilit godisnin xhadenë duke ngritur një pluhur që kundërmonte erë të rëndë dheu. Po nuk zgjati shumë dhe shiu pushoi, duke ia lënë vendin një fladi të freskët që frynte luginës.

Kur Hidri hyri në oborrin e shtëpisë, qeni nisi të lehte dhe angullinte. Ai pati një parandjenjë të keqe, sepse kjo qe për atë diçka që nuk kish ndodhur kurrë më parë. Veç kësaj, çuditërisht, ai vuri rë që, komshiut i tij, Jaku, e kishte shkukur dhe hequr krejt gardhin!

Si ndenji një copë herë duke përtypur me mendje atë që kish bërë Jaku, u ul galiç rrëzë murit, vuri duart në kokë dhe ra në mendime të thella.




E shoqja e tij, Mara, që kish dëgjuar angullimat vajtuese të qenit doli jashtë dhe e pa të shoqin teksa rrinte i ulur galiç me shpinën e pështetur për muri. Iu afrua dhe i tha:

- Ngrihu dhe futu brenda, Hidër se nuk u bë hataja! Fundja, shesim një copë tokë dhe blejmë lopë tjetër.

- Ç'po më thua kështu, moj grua?! - pyeti duke hequr duart nga koka, - Çfarë e ka gjetur lopën?!

- Ngordhi, - tha ajo, - Herët në mëngjes, kur more viçin, e kishe harruar derën e ahurit hapur. Lopa ka dalë jashtë dhe ka gjetur e ngrënë pleh kimik nga thesi që pate blerë para një jave dhe e pate lënë te qoshja e avllisë. Të kujtohet?

Ai u bë meit në fytyrë. Iu mblodh një lëmsh në grykë dhe nuk mundi të nxirrte asnjë fjalë nga goja. Vuri sërish duart në kokë e nisi të qante me zë.



Nga XHAFER MARTINI



Shumica e atyre që sulmojnë Skënderbeun dhe “duan ta zbresin nga kali”, thonë që ai është një figurë mitike, një figurë e ekzagjeruar, e pambështetur në realitet, gjithnjë e mbështjellë me mjegull, më shumë një imazh krijuar në përfytyrimet e njerëzve se sa një njeri konkret, një njeri që i janë atribuar aq shumë bëma sa nuk ka mundësi t’i bëjë askush. Historiani Oliver Jens Schmitt në vepërën e tij “Skënderbeu”, Tiranë 2011, i vërsulet ashpër Skënderbeut, sidomos akuzon traditën poetike gojore, por edhe atë refleksive që e ngritën lart figurën e Skënderbeut duke e nxjerrë jashtë çdo perceptimi realist. Ja si shkruan ai: “Krijimi i modeleve të reja të të menduarit dhe përpunimi i tyre në kulturën gojore si dhe mbeturinat e një kujtese që vinin nga mesjeta e vonë u shkrinë së toku dhe u bënë një epokë e kalimit nga identitetet fetare në ato etnike, në një mënyrë mjaft produktive. ...Në mënyrë të veçantë eposi i Skënderbeut i Naim Frashërit shënon këtë ngritje të Skënderbeut (1989). Frashëri ishte bektashi, e pra një jo i krishterë, por së bashku me përfaqësues të tjerë të lëvizjes kombëtare propagandoi përfytyrimin e një ndjenje kombëtare shqiptare që qëndron mbi fetë dhe besimet, të cilën Pashko Vasa e ngjeshi në formulën “feja e shqyptarit asht Shqyptaria”, moto që shprehte një objektiv, por nuk pasqyronte një realitet shoqëror-kulturor, një parullë që megjithatë i nixti elitat kombëtare të krijonin realitete përkatëse. Në këtë perspektivë simboli i shqiptarisë nuk duhej të përmbante komponente fetare. Lufta e Skënderbeut kundër osmanëve myslimanë, në fund të shekullit 19 u riinterpretua në një luftë çlirimtare kundër sulltanëve, të zhveshur nga çdo ngjyresë fetare. Në këtë mënyrë interpretimi aktual i heroit u përgjigjet pjesëve të caktuara të traditës së mpakur gojore në Ballkan, e cila të Skënderbeu shihte mishërimin e idealit të heroit, ndërsa kundërshtarët e tij i linte në gjysmërrësirë të çuditshme dhe nuk thoshte as se kundër kujt luftonte heroit. Kështu Skënderbeu u bë syprinë për projektimin e dëshirave nacionale, mishërimin e virtyeve kombëtare; në të njëjtën kohë abstragohej gjithmonë e më shumë prej figurës historike. ...Skënderbeu u vështroi si një mbrojtës i qytetërimit evropian, në një variant shqiptar të imazhit të murit mbrojtës për krishterimin, i cili edhe në rastin shqiptar lidhej me mitin e sakrifikimit të shqiptarëve që luftonin për shpëtimin e Renesansës italiane, mirëpo pastaj ishin harruar. Pra, Europa u kishte borxh shqiptarëve mirënjohjen, dhe kjo mirënjohje duhej shprehur me ndihmë politike – një mendim që edhe sot është mjaft i gjallë”. (f. 434)

Në kundërshtim me këtë autor, krejt ndryshe e ka konceptuar Qosja figurën e Skënderbeut. Në analizën që i bën veprës së Naim Frashërit “Istori e Skënderbeu”, Qosja shkruan: “Sipas shkrimeve të Naim Frashërit, të gjitha luftërat që bën Skënderbeu kundër pushtimeve turke, në të vërtetë janë luftëra që i nxit ndjenja atdhetare e vetvetishme. Arsyet

SKËNDERBEU MITIK

sociale, klasore, dhe, më në fund fetare, nuk janë për të arsye që sadopak do të ndikojnë në atdhetarizmin e Skënderbeut.” (Rexhep Qosja: “Porosia e madhe”, , 1989, f. 208).

Që shqiptarët e kanë nxjerrë fenë në plan të dytë apo edhe të tretë kur është fjala për liri e atdhe, kjo dëshmohet edhe me faktin që ata e ka ndërruar fenë, në radhë të parë, për interesin kombëtar. Edhe pse e kanë ndërruar fenë, ata aspak nuk janë tjetërsuar nga pikëpamja etnike, nuk janë bërë as sllavë, as grekë, as turq. E pra, nëse këtu ka një mit, ky është miti i lirisë dhe miti i atdheut, gjithsesi mite përparimtare, që e shtojnë përpara rrotën e historisë.

Ka studime të plota dhe të pjesshme për mitet. Pra, nuk jemi në një truall bosh, por në këto tridhjetë vjet e fundit miti u nxor jashtë vetes, u zhvesh nga përmbajtja e caktuar që ka dhe iu atribuan tërë dështimet dhe të metat e letërsisë së realizmit socialist dhe u bë si bazë për të sulmuar edhe historiografinë e periudhës së diktaturës në një plan të gjerë. Tejkallimet janë gjithnjë të panevojshme, madje të dëmshme. Ruajtja e masës është kryesore në çdo studim. *Kalvino thotë: “me mitet nuk duhet të jemi të nxituar; është më mirë t’i lëmë të depozitohen në kujtesë, të ndalemi e të reflektojmë mbi çdo hollësi, të arsyetojmë për të dalë nga gjuha e imazheve të tyre. Mësimi që mund të nxjerrim nga një mit qëndron në trajtimin e tij besnik dhe jo në atë që e shtojmë jashtë tij”.* (Italo Kalvino: “Leksione amerikane”2011: 53)

Por deri këtu, siç e pamë, flitet për mitet e vjetra, mitet tradicionale, ata që burojnë nga muzgu i historisë dhe i kulturës kombëtare. Por për mitet flitet edhe në një kuptim tjetër, për mitet e reja që janë krijuar ose në analogji me mitet e hershme ose si reflektim i kërkimeve të reja në fusha të ndryshme të jetës, sidomos në fushën shpirtërore. Studiuesi Shaban Sinani në librin “Letërsia në totalitarizëm dhe “Dosieri K”, Tiranë 2011, ka edhe një kapitull me titull: “Mitet dhe demonët në letërsinë e realizmit socialist”. Dukuri të tilla si mitet janë studiuar edhe në periudhën e diktaturës dhe njeri prej këtyre studiuesve (A. Uçi), që ka qenë më në korrent të zhvillimit të letërsisë dhe të arteve ka arritur në përfundimin se “çdo përpjekje për të ringjallur mendimin mitologjik brenda artit të realizmit socialist kishte për të qenë në kundërshtim me synimet njohëse të kësaj metode”. Sh. Sinani, përkundrazi, thotë se “letërsia shqipe e realizmit socialist në tërësinë e vet mund të lexohet edhe si letërsi mitologjike” (Shaban Sinani: 2011:43) Ky autor thotë se letërsia shqiptare edhe më herët ka qenë mitologjike, por shqyrtimi më nga afër i letërsisë së realizmit socialist evidentoi mite të reja si “miti i komandantit, miti i armës, miti i partisë udhëheqëse, miti i drejtpërdrejtë e komunizmit”, për të shkuar pastaj që në fillimet e kësaj letërsie “që u paraqit si letërsi heronjsh dhe bëmesh heroike. “Miti i Gjergj Kastriotit u përhap në Europë e në Azi përmes kësaj letërsie duke e bërë të njohur botën shqiptare prej Islandës në thellësitë kontinentale aziatike”. (Sinani: 2011: 44)

Letërsi mitologjike qe edhe ajo e Rilindjes Kombëtare, thotë ky autor, që prej fillimeve të saj e deri në fund, duke nxjerr në pah mite të tilla, si mitin e “motit të madh”, mitin e “Dheut të Arbërit”, mitin e prejardhjes prej lashtësisë, mitin e gjuhës shqipe, të virtyeve shqiptare etj. (Sinani: 2011:45) Poetët më të njohur të kësaj periudhe si De Rada me “Rapsodi e një poemi arbëresh”, Naim Frashëri me “Istori e Skënderbeut”, Fishta me “Lahuta e Malcis” shënuan si të thuash mitin e epopesë. Po unë me atë “naivitetin” tim pyes: çfarë ka të keqeje kishte në letërsinë e Rilindjes? Si thoni, ju, është gjë e keqe apo gjë e mirë që, në kushtet e popullit shqiptar që ende nuk e kishte fituar

lirinë dhe pavarësinë, a mund të kishin një sjellje tjetër shkrimtarët e këtij kombi, përveçse asaj që patën, domethënë duke glorifikuar “motin e madh”- kohën e Skënderbeu-, që ishte me të vërtetë i madh, mitin e prejardhjes së lashtësisë, sepse në të vërtetë ishim dhe jemi popull i lashtë, të paktën më të lashtë se ballkanasit e tjerë, se edhe grekët; të mos i këndonin Gjuhës Shqipe që është në të vërtetë një nga gjuhët më të bukura të botës, por që, për fatin historik të keq të shqiptarëve është shkruar vonë; dhe, më në fund, të mos u këndohet virtyeve shqiptare, të shqiptarëve të asaj kohe që janë mburrur edhe nga të huajtë? E pra, lind pyetja përfundimtare: ku qëndron e keqja këtu? Pse t’i ndërlikojmë dhe t’i labirinthojmë gjera kur i kemi të qarta si në dritën e diellit?

Kur them se letërsia e Rilindjes Kombëtare mund të ishte vetëm ajo që ishte, jam dakord



Për Skënderbeu mungojnë siç dihet burimet e shkruara që të na kënaqin plotësisht. Por nuk mungojnë burimet popullore. Skënderbeu ka qenë i popullit, në radhë të parë, një prijës që i doli në mbrojtje dhe ja rriti nderin e lavdinë jo vetëm sa qe gjallë, por edhe sot e kësaj dite. Është e pamundur që gurra popullore të ketë heshtur për Skënderbeun me të gjitha format me të cilat ajo e pasqyronte realitetin. Populli, me pak fjalë, ka krijuar imazhin e Skënderbeut të vet.

me studiuesin që letërsia e realizmit socialist, nuk duhej të ishte ajo çka ishte, sepse ashtu si ajo qe, ishte një letërsi regresive, jo në interes të popullit dhe të kombit shqiptar, një letërsi përdalluese nga ajo evropiane e botërore, që e humbi rrugën e zhvillimit dhe kjo jo për interes të kombit shqiptar, por të një klike të caktuar. Prandaj jam plotësisht i një mendimi me studiuesin se letërsia e realizmit socialist krijoi mbi të gjitha mitin “e njeriut të ri”, që është një nga gënjeshtrat më të mëdha të njerëzimit, por që partisë në pushtet i shërbente për të kontrolluar, programuar, përshtatur dhe kodifikuar gjithë jetën shoqërore në përputhje me synimin që kishte. Në shërbim të ideologjisë komuniste u vunë re edhe paradigma të reja si “ideologjia socialiste”, “rendi socialist”, “shoqëria socialiste”, “moralit socialist” deri tek “Atdheu socialist”. Nuk mund ta përmendje me konotacion pozitiv fjalën “Atdhe”, nëse me këtë kuptohej thjesht

atdheu tradicional, dheu i të parëve, nëse nuk shtojte atë socialist që kishte kuptimin e një “atdheu” të ri me një përmbajtje të re dhe i “krijuar rishmi” në periudhën e socializmit.

Një mit ishte “heroi pozitiv” në letërsinë tonë, një shpikje e kësaj metode që edhe vetë nuk ngrihej mbi bazën e një estetike të caktuar, por një konglomerat parimesh që buronin nga praktika të ndryshme krijuese. “Në kushte e ndarjes nga bota, - shkruan Sinani, - krijimi i njeriut të ri mori trajtën e një mitologjie etnike. Miti i njeriut të ri u kthye në një qëllim themelor të letërsisë së realizmit socialist, deri në atë shkallë sa, edhe kur mungonte dhe nuk gjendej nga kritika, shpikëj si “hero pozitiv”, edhe diçka jonjerëzore, mjafton të plotësohej kushti i mitologjisë së realizmit socialist: një qytet, një kantier apo edhe një “kështjellë që përbën heroin pozitiv”(rasti i romanit

“Kështjella”). (Sinani: 2011: 48)

Kështu me këto zhvillime dhe me këto konstatime dhe analiza të drejta të studiuesit Sinani, mund të vazhdonim më gjatë, se ky problem pothuaj gjen shterim të plotë në veprën e tij në lidhje me dukuri të ndryshme të letërsisë së realizmit socialist. Por dhe këtu është tepruar, sepse përmenden si mite edhe miti i malit, miti i armës, miti i traditave historike e të tjera mite. Kështu duhen parë si mite edhe poemat “Përse mendohen këto male”, “Alarme të përgjakura”, “Nënë Shqipëri” . Po të mos kishte “Nënë Shqipëri, fjala vjen, figurën e Enver Hoxhës, të ndarë, të specifikuar e të glorifikuar, këtë libër secili duhej ta kishte në bibliotekën e vet për shkak të vlagës poetike dhe të mençurisë që e përshkon. E pra, kur nuk jemi në gjendje të bëjmë një studim përzgjedhës, diferencues, ta ndajmë, si thotë ajo fjala e urtë, “shapin nga sheqeri”, nuk bëjmë gjë të mirë kur hedhim poshtë letërsinë më të vyer të asaj periudhe.

Por le të kthehemi tek qëllimi i kemi vënë vetes: tek miti mbi Skënderbeun. Të thuash mit për Skënderbeu do të thotë se është një krijim, një fantazi, si në rastin e parë të konceptit për mitin që buron nga tradita historike , por edhe përgjithësi tha studiuesi për mitin në letërsinë e realizmit socialist. Por kjo nuk është e vërtetë, mbasi Skënderbeu ka ekzistuar dhe gjithçka që është thënë rreth tij nga historiografia shqiptare dhe ajo e huaj, në mos qoftë plotësisht e vërtetë, ka pjesë të mira nga e vërteta. Kështu, si shembull, me argumente shkencore jo të mjaftueshme janë dhënë mendime përfundimtare për vendlindjen e Skënderbeut, për vitin e lindjes, për vendndodhjen e betejës së Torviollit, për ririnë e hershme të Skënderbeut etj.; por këto nuk e cenojnë vërtetësinë e figurës, ekzistencën e saj.

Shumica e atyre që sulmojnë Skënderbeun dhe “duan ta zbresin nga kali”, thonë që ai është një figurë mitike, një figurë e ekzagjeruar, e pambështetur në realitet...



Për Skënderbeun mungojnë siç dihet burimet e shkruara që të na kënaqin plotësisht. Por nuk mungojnë burimet popullore. Skënderbeu ka qenë i popullit, në radhë të parë, një prijës që i doli në mbrojtje dhe ja rriti nderin e lavdinë jo vetëm sa që gjallë, por edhe sot e kësaj dite. Është e pamundur që gurra popullore të ketë heshtur për Skënderbeun me të gjitha format me të cilat ajo e pasqyrore realitetin. Populli, me pak fjalë, ka krijuar imazhin e Skënderbeut të vet. Autori i këtij shkrimi, duke gjurmuar në popull, ka mbledhur një tufë me legjenda, që tashmë janë botuar në librin “Dasma me treqind nuse”, Tiranë 2010, rreth njëqind faqe tekst. Në këto gojëdhëna është Skënderbeu mitik, legjendar, sepse nuk kemi ngjarje të vërteta, por nganjëherë e pavërteta, legjendarja, fantastikja flet me një gjuhë më të fuqishme se e vërteta. Vetëm në këto krijime dhe në këtë kuptim Skënderbeu është një mit. Le të na lejohet që nga këto dhjetë legjenda, të paraqesim shkurtimisht përmbajtjen e njërës prej tyre: “Dhitë e Skënderbeut”. Këtu si personazh është një ish-luftëtar i Skënderbeut, që, meqë ka marrë plagë të rënda në luftë, ka mbetur invalid, i paafte për të luftuar më si dikur me shpatë në dorë. Tani ai është çoban dhe ruan dhitë. Kur dëgjon zërin e tij dhe këmborët e bagëtive, një ditë Skënderbeu shmanget ta takoj trimin e dikurshëm. Mbasi pyeten e përshëndoshen siç e kanë burrat, trimi thotë se do të marrë pjesë në luftë kundër turqve. Ai nuk e le shumë kohë Skënderbeun të habitet se thotë “do të marr pjesë me ushtrinë time” dhe ushtria e tij ishin dhitë. Kur ushtria e Skënderbeut do t’i dilte në ballë ushtrisë madhe turke në fund të luginës, si të mbaronte ajo përlëshja e parë, nga krahu i majtë i ushtrisë së Skënderbeut, fshehur thellë në pyll, do t’i vinte në ndihmë ushtria rezervë, kurse nga krahu i djathtë, si ushtri do të ishin njëmijë dhi, me kunja pishash të ndezura

Dibranët, krejt ndryshe nga çfarë i cilëson ky historian sharlatan, kanë qenë të lavdishëm jo vetëm në luftërat me Skënderbeun në krye, por edhe pas vdekjes së tij. Ndonëse të islamizuar, ata, siç e thotë Miftar Spahia, nuk u turkizuan. Nga 54 kryengritje kundër turkut pas vdekjes së Skënderbeut deri në shpalljen e Pavarësisë, 12 të tilla janë zhvilluar në truallin e Dibrës.

tek brirët, që to të binin si rrufe tatëpjetë malit. Ushtria turke kur ta shikonte gjithë atë mal zjarresh, duke e pandehur si ushtri të vërtetë, do të merre arratinë. Ndodhi pikë për pikë ashtu si e kishte menduar ishi-luftëtar i Skënderbeut dhe fitorja edhe kësaj radhe, e ndihmuar edhe nga kjo dredhi, i buzëqeshi kryetrimin shqiptar. Por kjo është njëra prej legjendave për Skënderbeun. Dhjetëra dhe qindra të tjera sigurisht e plotësojnë figurën e Skënderbeut, secila me mënyrën e vet, duke e dhënë këtë figurë më të plotë, plot dinamizëm dhe plastikë.

Por për ta kritikuar *mitizmin* e Skënderbeut na ndihmon njeri prej autorëve që duke qenë se mendimi i tij buron nga një interviste, e ka më të qartë dhe më të specifikuar se ku qëndron miti të Skënderbeut. E kam fjalën për Artan Puton, i cili, në intervistën “Nga Skënderbeu mitik në atë historik” (Gazeta “Shekulli”, 18 janar 2009), e mbështet plotësisht Schmitt-in. Ai shkruan: “Skënderbeu zbret nga lartësia e figurës legjendare dhe vjen si një personazh tokësor. Ky aspekt i dytë në duket i rëndësishëm, sepse vetëm dekonstruktimi i figurave mitike mund të ndihmojë në njohjen e historisë”. Sipas tij “Miti është një mënyrë me anën e të cilës komunitetet të caktuara përcaktojnë themelet e ekzistencës së tyre, sistemin e tyre të vlerave morale”. Për mua mitet në radhë të parë kanë të bëjnë me botëvështrimin, me mënyrën se si mund të kuptohen disa dukuri nga një bashkësi shoqërore në një periudhë të caktuar. Për studiuesin e kësaj fushe “*Mitet janë rrëfenja, histori, përfytyrime të mbinatyrshme, të sendeve dhe dukurive të caktuara...mbijetoja të paganizmit, pasqyrë e rrugës së veçantë të zhvillimit etnik të bashkësive shoqërore të caktuara të popujve...ato flasin shumë për veçoritë e etnokulturës në tërësi të popujve ose edhe më gjerë, të marrë në kuptimin e shtrirjeve të arealeve antropogjeografike më të mëdha*”. (Mark Tirtja: “Mitologjia ndër shqiptarë”: Tiranë 2004: 7,8)

“Në mitologji, - thotë një studiues tjetër, -shkrihen njohja me aksionin, aspekti gnoseologjik me aspektin akseologjik, kuptimi mbi jetën dhe mbi botën, përfytyrimi artistik i realitetit, i njeriut dhe i mjedisit, riti dhe besimi, parandjenja emocionale dhe

didaktika, ndërgjegjja artistike popullore dhe psikologjia etnike, predikimi i virtutit dhe evokimi i vlerave kombëtare...Në mitologji ndërthuren kategoritë më të përgjithshme të dijes, përfytyrimit, fantazisë dhe ndjesive njerëzore, botëkuptimi, filozofia e jetës, arti, trashëgimi i përvojës dhe i shprehjes krijuese nga një brez në tjetrin”. (Shaban Sinani: “Mitologji në eposin e kreshnikëve”: Tiranë: 2000:37) Këto elemente mitikë, siç po i emërtojmë, jo vetëm nuk janë të dëmshëm, por janë të dobishëm, sepse plotësojnë më mirë ngjarjet dhe rrethanat, ndihmojnë “të sqarohen në një plan më të gjerë raportet midis artit popullor dhe zhvillimeve historike, vartësitë dhe pavarësitë ndërmjet kujtesës kolektive dhe dokumentacionit arkivor mbi këto zhvillime” (Shaban Sinani: “Mitologjia në eposin e kreshnikëve”, Tiranë 2000, f. 153)

E pra, kur mitologjia qenka e tillë, a mund të thuhet se ka figurë të madhe historike që nuk ka elemente mitikë? Kjo është e pamundur, sidomos figura e Skënderbeut që është kaq larg me kohën tonë dhe e padokumentuar sa duhet. Për mua figura e Skënderbeut vuan nga trajtimi i deritanishëm, por jo pse në të ka mit. Vuan për të kundërtën, pse është trajtuar pa plasticitetin e nevojshëm, pse në të nuk janë shkrirë ato përfytyrime dhe emocione, parandjenja dhe besime që do ta bënin këtë figurë konkrete, tokësore më të afërt dhe më të dashur. Historia operon me dokumentin, por përtej dokumentit nuk ka hapësirë boshe, përkundrazi, është jeta e gjallë, që ka diktuar ato dokumente.

Puto tregon se tek figura e Skënderbeut është mishëruar edhe “Miti i vlerave morale. Skënderbeu luftoi për atdhe dhe jo për interesa mesquine. Legjenda e tij përmbledhet tek thënia: “Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta midis jush”, me rastin e rikthimit të tij në Krujë”.

Këtu nuk ka asgjë për të qenë mit. Skënderbeu vërtet nuk luftoi për interesa personale, ai vërtet i gjeti shqiptarët të etur për liri: Lirinë nuk mund ta sjellë kurrë një njeri, po që se ajo nuk ekziston tek vetë populli që lufton për liri.

Gjithashtu Puto shkruan se në lidhje me Skënderbeun ekziston “Miti i vuajtjes dhe të trajtimit të padrejtë historik. Sakrifikimi për Europën dhe në këtë mënyrë justifikohet “ribashkimi” i Shqipërisë me Europën dhe njohja e kombit shqiptar si kthim i një borxhi historik”.

Kjo thënie nuk ka të bëjë fare me mitin. Ne, shqiptarët, kemi të drejtë ta themi me zë të lartë se populli shqiptar me Skënderbeun në krye, bëri shumë për qytetërimin Perëndimor, duke e pruarjtur atë nga invazoni i hordhive osmane, që nuk kishin tjetër pengesë veç Skënderbeut dhe popullit shqiptar.

Diplomati i shquar Ulliams i ka folur hapur botës për këtë padrejtësi të madhe që iu bënte Shqipërisë gjatë historisë: “...prenë copa me rëndësi nga tokat shqiptare dhe ua dhanë fqinjëve në veri, në jug dhe në lindje...dhe copën që mbeti, e quajtën shtet të pavarur-

Shqipëri” (“Drita”, f. 5, 13 qershor 1999)

Tjetër mit sipas Putos, është “Miti i ndjenjës fetare të cekët ose i unitetit përtej feve, meqë Skënderbeu ndërroi fenë disa here, që u hyjnë në punë si veprimtarëve nacionalistë shqiptarë të kohës së Lëvizjes Kombëtare për të tejkaluar ndarjet fetare midis shqiptarëve, monarkisë zogiste për të krijuar shtetin e tij laik të ndarë nga fetë, ashtu edhe ateizmit të E. Hoxhës”.

Edhe këtu nuk mund të bëhet fjalë për mit. Shqiptarët nuk e kanë pas as të cekët, as të thellë ndjenjën fetare. Kanë qenë dhe janë fetarë si të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit dhe të Europës. Ishin rrethanat historike që i bënë një pjesë të tyre ta ndërronin fenë. Ndërrimi fesë është shkaktuar nga shumë faktorë historikë, por më kryesori është ky: shqiptarët u islamizuan se nuk donin të kishin një fe me fqinjët grabitqarë, donin të diferencoheshin edhe nga pikëpamja fetare me sllavët dhe grekët. Feja islame që një shpëtim historik. Miftar Spahia thotë: “...u islamizova se s’desha me u serbizue, se s’dashta me u ba serb, dashta me mbet shqiptar e që ku jam shqiptar në tokën temë...Kërkush të mos më qortojë, kërkush të mos bajë shoje, kërkush të mos më shtie mend. U islamizova në fe të turkut, por nuk u turkizova, nuk u bana turk, nëpërmjet islamizimit ruajta gjuhën atë gjanë ma të vetën qi ka nieri”. (Hasan Spahia: “Miftar Spahia, korife i Lumës”, f. 92, Prishtinë 1995)

Tjetër mit sipas Putos që ka lidhje me Skënderbeun është “Miti i guximit dhe natyrës luftarakë të popullit shqiptar. “Shqiptari e ka çare rrugën e historisë me shpatë në dorë”.




Fjala e parë qëndron e patundur si konstatim, duke hequr fjalën mit, sepse nuk ka kurrfarë miti. Populli shqiptar vërtet ka qenë një popull luftarak. Kjo është një e vërtetë dhe nuk ka sit ë jetë mit. Fjala e dytë është një citat, që mund të hiqet për atë që e ka thënë dhe jo për të vërtetën që shpreh.

Një pjesë e madhe e librit të Schmitt-it, thotë Ardian Ndreca, është bazuar mbi hamendje dhe ai i numëron një për një: (Ardian Ndreca: “Kur Skënderbeu” nuk asht historia e Skënderbeut”, f. 32, Onufri 2008). Hamendje ka edhe për Dibrën, por ajo që na çuditë dhe na le pa mend qëndron në faktin që për dibranët thuhet: “Në njërën anë trupa mbrojtëse e tregoi veten me një disiplinë të forte dhe besnikëri të patundur, nuk ndodhi asnjë tradhti, pasi Kruja mbrohej nga luftëtarë të shumët me besim të krishterë e jo prej ndonjë trupe rezerviste nga Dibra e sipërme që llahtarisej nga pamja e sulltanit”. (Oliver Jens Schmitt: “Skënderbeu”, Tiranë 2008, f. 102)

Dibranët, krejt ndryshe nga çfarë i cilëson ky historian sharlatan, kanë qenë të lavdishëm jo vetëm në luftërat me Skënderbeun në krye, por edhe pas vdekjes së tij. Ndonëse të islamizuar, ata, siç e thotë Miftar Spahia, nuk u turkizuan. Nga 54 kryengritje kundër turkut pas vdekjes së Skënderbeut deri në shpalljen e Pavarësisë, 12 të tilla janë zhvilluar në truallin e Dibrës. (Dibra dhe dibranët, Peshkopi 1981, f. 28).

Ja, pra, me pak fjalë, se për çfarë çmtizimi bëhet fjalë për figurën e Skënderbeut.

Libra të autorit Xhafer Martini, botuar nga Botimet M&B



Nga FATBARDH RUSTEMI

Ilir Spata, nga fshati Blliqe i Peshkopisë, sikurse shkruhet: më i persekutuari në Shqipëri, erdhi të bënte gjimnazin bashkë me ne në Lushnje, ku numëroheshin kampe internimi më shumë se kudo tjetër. Nga banga e shkollës përfundoi në bangën e të akuzuarit. Pas shumë e shumë vitesh, si nga fundi i botës më vjen një kërkesë prej tij në fb. “Pastaj erdhe ti tërë ikje.”-do thoshte poeti Reshpja. Në statusin e Ilirit shihja vazhdimisht poezi të postuara, nuk e dija që shkruante, të cilat: i lexoj sistematikisht, ngaqë janë të tijat, shtyrë dhe prej detyrimit moral për të njohur kalvarin e një shoku të klasës, që sipas regjimit nuk i përkisnim së njëjtës klasë. Edhe ai më ndiqte po me të njëjtin interes. Gjëja e parë që më ra në sy: poezive u mungonte “uni”, ku si zakonisht nënkuptohet hero i lirik apo autori, por jo se i mungon individualiteti, që tek ai shfaqet në forcën e karakterit, sfidant: si ndaj totalitarizmit ku askushi bëhej dikushi dhe demokracisë së tranzicionit, ku tjetri bëhet krejt tjetër. Në poezinë e tij sheh vendlindje, vuajtje shokësh të burgosur, heronj baladash, legendash, figura historike, fatet e kombit, ku autori e fsheh veten si për t`na thënë: më latë vetëm në fatin tim, më llogaritët tek të zhdukurit, nëse u ha meraku për mua, më gjeni ndër vargje. Fundja u mësuar pa praninë time. Është po ajo vështirësi që të krijohet tek panteizmi i Naimit, ku e ke të vështirë të gjeshe se ku ndodhet zoti dhe ku poeti i fshehur.

Këto ditë shihja shumë shkrime përkujtimore në nderim të poetëve të vvarë Genc Leka dhe Vilson Blloshmi, ndërkohë që Ilir Spata riposton pas 12 vitesh poemën “Heshtja që vrau”, ku ndihet revolta ndaj të gjithë atyre, të cilët bëjnë marketing me dhembjen. “O heshtja ime,/Sa jetë ka vvarë!/Dhe heshtja juaj,/Vrarë po ka?”-një padi kjo, për të gjithë ata të kohës së “gojës së kyçur”, që u morën me ekspertiza, letra anonime, fjalë në vesh, që, tek “komploti i heshtjes” gjetën mjetin komod, për të hequr qafesh sa e sa, pa e ditur se kush i vrau. (Ma do mendja se tek “komploti i heshtjes” duhet ta kenë origjinën armët me silenciatorë.) “Të vrasin shokët se u bën hije”-do shkruante Kuteli në letërën amanet lënë së shokes. Nëse dje fabrikohesh heroi, tani fabrikohen autorë. (Personalisht nuk e quaj akt nderimi ndaj poetit të varur Havzi Nelaj, veçse një shembull se si abuzohet me dhembjen, duke bërë marketing me të, sikurse e ka për zakon politika e ditës, e cila e përdori poetin për të sulmuar kundërshtarët. Poeti kuksian u var në kohën e Ramiz Alisë, të cilit, Lubonja dhe Ngjela i shkruanin letra nga burgu, ndërsa Meta dhe Saliu s`kanë reshtur së komplementuari, si presidentin e parë të pluralizmit shqiptar.) “Pa vlerë të bëhet,/Ndjenjë e pendesës./Ndaj dole Ti/Lart në tribunë;/Turma amorfe/Mbledhur përreth.../Ti i zgjedh fjalët,/Të mprehtat fjalë,/Të shpojnë e vrasin/Ku dhemb në shumë.”-shkruan Ilir Spata me vargje shpotitës kundër ndjesës hipokrite të atyre që me lot krokodili përgërin altarin. Ai që reflekton është më i besueshëm kundrejt një tjetri, i cili e përdor ndjesën, sikurse përdorej dikur autokritika. Si reflektim mu duk një shkrim i Sazan Golikut kushtuar poetit të përndjekur Pano Taçi, ndërkohë që Pandeli Koçi njihet si nënshkrues i ekspertizës, që u përdor si akt-akuzë për dënimin e poetit Visar Zhiti. I vendosur midis dy poetëve të përndjekur: ku njërit i shkruan letër lavdëruese, dhe tjetrit ekspertizën e kthyer në gjëmë?! A duhej marrë shkrimi i tij, si një reflektim apo thjeshtë një marketing me dhembjen? Unë i qëndrova besnik parimit tim, reagoj nëse një shkrim më pëlqen, pavarësisht autorit, ndërsa humoristi i njohur, Jani Duri, do komentonte: “O Pano, o djallë, sa ishe gjallë nuk t`i thanë këto fjalë”,-duke i dhënë të drejtë autorit të poemës “Heshtja që vrau”. Mos vallë morali më shumë predikohet se sa



ushtrohet? (45 vjetori përkujtimor i vrasjes së poetëve Genc Leka dhe Vilson Blloshmi, nën përkujdesjen e një poeti, i cili s`ka reshtur së shkruajturi për ta, si i nderuari Sadik Bejko, ia ndërroi faqen nderimit: ku nga një ceremoni zyrtare, sikurse ishim mësuar të shihnim, duke e kthyer në një përshpirtje. Dikur kërkohesh që dhembja të kthehej në forcë, ndërsa grekërit e vjetër me katarsin e famshëm: me dhembjen kërkonin të pastronin shpirtërat.)

Kur lexon poemën e Ilir Spatës nuk mund të mos na kujtohen sallat dhe sheshet që oshëtinin dikur nga kënga “Enver Hoxha mprehu shpatën, edhe njëherë, o për situatën!”, ku gëzimi pervers se po afronte fushata e spastrimeve me “koka turku”, të ngjethet mishtë. Përkundër gëzimit të klakeve, shpataraku ankohej: “Të mos e dëgjoj këtë këngë që më ndjek pas, ngado që shkoj.” Halli i merrej për modesti. Meqë i priste shpata nga të katër anët, kënga me mprehje shpate u jepte krimeve autorësinë e tij. Në një farë mënyre po damkosej, duke i kënduar e mburrur. Kënga duhet të ketë qenë makthi i tij, pavarësisht ngazëllimit që krijonte tek brohoritësit. Edhe pse kishte qëllim lartësimin e tij, ajo po e damkoste si vrasës. Pikërisht këtyre brohoritësve u drejtohet Ilir Spata në poemën “Heshtja që vrau”, pasi janë po të njëjtët që brohorisnin në sallat e gjyqeve, ku dënoheshin “armiqtë” e sajuar me dëshmitarë të rremë. Këta duhet të jenë etërit e fake njazit. “I doje turmat,/Dhe prapë i don./Të frymëzojnë/Që të bësh art./Dikur mbërthyer/Për idealesh;/Sot “disidenca”/Të vjen për shtat./...Çast mallëngjyes,/U preke shumë.../Kërcitje eshtreve/Çfarë të kujtoi?/Duartrokijet/Dikur në sallë./Mësuar ishe,/S`bëje pa to;/Vite kariere,/Brenda e jashtë./Vargjet mes tyre/I recitove,/Me afsh e shite/Atë tëndin art.” Dihet që arti mediokër është brohoritës, njiheshin poetët kalendarik të kohës, avazexhinjtë e pushtetit, të gjithë ata që merrnin bekimin e autoriteteve, ata që botonin libra pa i penguar kush, që lavdëroheshin nga kritika dhe merrnin çmime, sikurse kishte dhe të tjerë, që ngecnin në sirtarët e redaksive për “gabime ideologjike”, apo u ktheheshin librat në karton. Nëse duam të jemi të drejtë me shkrimtarët dhe artistët e kohës së socializmit, së pari: nuk duhet të përdorim dy standarde, që, njërit t`i kujtohet krijimtaria kompromentuese me regjimin dhe të tjerët të anashkalohen. Së dyti: nuk të falet t`i shohësh bardhezi, sikurse u panë dhe nga kritika e kohës. Meqë shembulli Kadare është bërë bozë, ata që e tregtonin bozën në Stamboll ishin shqiptarët, po marrë dy autorë të tjerë. Nëse do i referohesh romanit “Përsëri në

Nëse poetët do të kishin heshtur, nuk do t`i burgosnin, nuk do t`i pushkatonin, nuk do t`i çonin për riedukim në gjirin e klasës punëtore dhe kooperativiste, nuk do t`ua hiqnin të drejtën e botimit, nuk do t`i kritikonin në plenum famëkeqe, nuk do t`ua kthenin librat në karton, nuk do t`i frikësonin me gabimin e mundshëm ku mediokrit flisnin sa për të qenë brenda, nuk do t`i akuzonin për gabime ideologjike, lakra në kokë apo të ndikuar nga arti borgjezo-revizionist, duke dëshmuar kështu një përballje dhe jo nënshtrim...

këmbë” të Dhimitër Xhuvanit e ke për kollaj ta quash shkrimtar të realizmit socialist, por, nëse ndalesh tek “Tuneli”, rast unikal në historinë e artit botëror, ku bashkë me autorin të dënohet dhe personazhja e tij, shtrohet pyetja: në ç`lloj letërsie do e përfshish?! Po kështu dhe për Fatos Arapin, poetin e rivierës që shkroi poemat “I përkasim komunizmit” dhe “Alarme të përgjakura”?! Enver Hoxha për t`u treguar zemërgjerë këshillonte censorët e tij: “Të mos ia japim armikut” Ndërsa ju me kollajllëkun më të madh ia jepni diktatorit, mjafton të gjeni një krijim që i shkon për hosh regjimit?! Heshtja nuk vret vetëm në diktaturë, ajo vret dhe tani në demokraci, nëse ti bën sehir se si denigrohen shkrimtarët, poetët dhe artistët.

Prometeu u kryqëzua në malet e Skithisë, sikurse dihet: ngaqë u dhuroi njerëzve zjarrin, por, të heshturit, ia bënë edhe më të rëndë dhembjen, duke çuar dhurata dhe bërë flijime në tempullin e Zeusit, ndaj i kryqëzuari lëshon rënkimin që vjen deri në ditët tona: “Unë që ndjeva dhembje për të gjithë, askush për mua dhembje s`ndjeu.” Dhembja ka kohën e vetë. Nuk qahet i varuri apo i pushkatuari, pasi vdes xhelati, ndaj poeti Frederik Reshpja shkruan: “Unë për fatin tim pikëllohem vetë/S`duhet që dikush të pikëllohet për mua.” Por, kjo nuk të ndal ty, të reflektosh. (Iliri krahas poezive publikon dhe të dhënat e krimeve të komunizmit. Unë zgjodha t`i ndërthur mes tyre: statistikë dhe vargje. 6800 varre të humbura. “Turma e mbledhur,/Gjithë sytë në vaj;/Një grumbull eshttrash/E dheu i zi./Pikojnë ca plumba/Që dikur vranë;/Zinxhirë të ndryshkur/Kërkëllojnë përsëri.../Pikojnë përdhe/Plumbat që vranë./Në vend të lotëve/Që s`i lëshuat.” Nëse loti nuk lëshohet atëherë kur duhet, tani është lot krokodili, por për ndjesën dhe reflektimin koha nuk ikën. 6023 persona të ekzekutuar. 1065 persona të vdekur në burgje. “Kam mall t`i mbush këto shkretina;/Nga jeni e s`jeni t`ju sjell këtu!/Po s`më lenë korbata, suferina,/E dashunia që kam për ju./Po rojat vallë ku i kanë nisun?/Kapteri roje pse s`gërrhet?/Mbi derën thyer e rrëzuar/Një korb që endet e krraket./Postblloku anash s`don t`ja dijë;/Se hyj e dal, askush s`më flet?/-kujton poeti në një vizitë në godinën e shkatërruar të burgut. 34.135 të burgosur. 260 u çmendën nga torturat. 59.517 të internuar deri në 1954-ën. 100 mijë të internuar deri në 1990-ën. 9.000 të vdekur në internim. 23 burgje në kohën e diktaturës. 48 kampe internimi. “Kungim i fundit,/Lave gjynahet/Me lotë që motesh/Shteruar, tharë;/Hodhe, vërtite,/Turmës pa sy/Të gjithë gjynahet/Veç me një fjalë:/”Më falni se heshta/Kur ju u vranë!”Ti kurrë s`ke

heshtur./Ishe në ballë/Është e natyrshme/Të reflektosh./Se si më vjen/Pendesa jote.” Në vend që të ngrenë gurin e pendesës, gurin e provës e hedhin në lum. Duke parë shifrat tmerruese, dhe pas 30 vitesh dëgjon të flitet për dënimin e krimeve të komunizmit, kur krime të padënuar ndodhin dhe në demokraci. Mos duhet që reflektimin të mos e shohim vetëm tek mëkatarrët, por tek e gjithë shoqëria, që ende sillet me egërsi? “S`gjen një vend të botës ku katili të nderohet si në Shqipëri.”-thotë Konica. (Kam ndjekur intervistën e pilotit që hodhi bombat atomike në Hiroshima dhe Nagasaki. Ai ndjehej krenar për detyrën që kishte kryer, bile falenderues, që atë ditë qielli ishte i kthjelltë duke ia lehtësuar kryerjen e detyrës.) Krime monstruoze po ndodhin në Ukrainë. Droneve që vrasin u ngrihen këngë. “Kur flasin spiunët më vjen të përzier;/Dijka më mbështillet e ngelet në fyt?/Mes makthesh, vegimeve, një nofull e shqyer/Gjakosun lëshon hijen mbi murin e ndytë.../Bien fasadat./Kultet rrëzohen./Buste të thyer;/Rrëmuje e zhurmë./Të gjithë heronj/Na trimërohen:/”Unë e përmbysa,/Tiranin, unë!”/Gjokset gufosin/Lart në tribunë.” Jo çdo varg duhet të komentohet, pasi dhe komenti më i gjetur veçse ua zbeh fuqinë. (Në jetën time kam marrë pjesë vetëm në një proces gjyqsore, ku dikush akuzohej si vjedhës pulash nga fqinji i tij. Në atë kohë salla e gjyqit dhe biblioteka ishin në një vend. Ende s`ishin hequr avokatët mbrojtës. Lake quhej avokati, një burrë i hijshëm, studiuar jashtë, i cili e mbrojti klientin e tij dhe ai u lirua në sallë. Bashkë me të tjerët e përqafova dhe unë. Kisha fobi për gjyqtar, ngaqë në fëmijëri radio Tirana i jepte seancat gjyqësore me orë të tëra. Të gjithë vraponin në stadium ku varën një ushtar, i cili vrau dhunuesit e të atit. Edhe pse stadiumin e kisha afër shtëpisë, nuk shkova. “Lave gjynahet/Me lotë të vonë;/Qenë të shpëlarë,/Ishin pa shije./Se patën rrjedhur/Në salla,/sheshe,/N`qarje masive.” Nëse poeti Trifon Xhagjika kërkoi një top t`i binte komitetit qendror, i biri i hetuesit që e dënoi u bë deputet i PD-ës.)

Nëse një hetues, sekretar partie, gardian burgu do ti lexonte poezitë e Ilirit, ish të burgosurit të tyre dhe të ballafaqoheshin kundrejt të qenit patriot, armiku do u rezultonte atdhetar? Në këtë moral të përmbysur na gjeti demokracia, ku ia hodhën paq të gjithë ata që bënë marketing me dhembjen. “Sa shumë mbledhur!/?Mbledhur sa shumë!/?Ku qenë atë ditë/Gjithë këto vallë;/Kur gjallë i çonin/ Në pushkatim?” Nikoll Lesi tregon se kur politikanëve u tha të ngrinin gurin e pendesës në Vatikan, ata e morën për makinën e së vërtetës dhe e shmangën. As Lesi vetë nuk guxoi ta ngrinte. “S`të lënë demonët;/Ndaj s`ke si hesht?/Po heshti Poeti/Ku t`i marrim zërat?/Thirrjet e buçimat,/Këngët plot zjarr?/Meloditë e ëmbla/Që bredhin me rimat?/Vallëzimet e hijshme/Që enden në varg?” Nëse poetët do kishin heshtur, nuk do i burgosnin, nuk do i pushkatonin, nuk do i çonin për riedukim në gjirin e klasës punëtore dhe kooperativistëve, nuk do ua hiqnin të drejtën e botimit, nuk do i kritikonin në plenum famëkeq, nuk do ua kthenin librat në karton, nuk do i frikësonin me gabimin e mundshëm ku mediokrit flisnin sa për të qenë brenda, nuk do i akuzonin për gabime ideologjike, lakra në kokë, apo të ndikuar nga arti borgjezo-revizionist, duke dëshmuar kështu një përballje dhe jo nënshtrim, ndaj në fund të kësaj beteje: dështoi metoda dhe jo letërsia. Letërsinë e shpëtuan të talentuarit. Ky është dhe mesazhi që vjen nga poema e Ilir Spata, “Heshtja që vrau”, si një akuzë ndaj të gjithë atyre që bëjnë marketing me dhembjen.

Marrë nga profili i autorit në FB

prof. Qazim Xhelili mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Historike” dhe titullin “Asistent Profesor”.

Profesor Qazim Xhelili u lind në Dibër në vitin 1941. Pasi mbaroi me rezultate të shkëlqyera shkollën pedagogjike, punoi për disa vjet si mësues në rrethin e Dibrës.

Shqipëria sapo kishte mbyllur plagën e madhe të analfabetizmit dhe para mësimdhënësve në vendin tonë u shtrua një detyrë e madhe, që nuk njihje orare, por kurajo dhe përkushtim dhe falë këtyre njerëzve kurajozë të dijes, u ngrit një sistem i organizuar i arsimit dhe përgatitjen shoqërinë për një një sistem të ri shoqëror.

Profesor Qazim Xhelili në vitin 1967 përfundoi studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologji, dega Histori- Gjeografi në Universitetin e Tiranës. Falë punës së tij me shumë pasion dhe përkushtim dhe rezultateve të larta në mësim, fitoi të drejtën e mësimdhënies në Universitetin e Tiranës. Aty u hap rruga e tij akademike, në studimin e shkencës së Historisë.

Në fillimet e tij u muar kryesisht me metodikat e studimit të Historisë dhe përgatitjen e mësuesve të rinj. Ka kryer një sërë studimesh shkencore, ka referuar në shumë shkolla të larta brenda dhe jashtë vendit për tema të rëndësishme të Historisë. Ka marrë pjesë në grupet e punës të historianëve në përgatitjen dhe botimin e Historisë së Shqipërisë.

Krahës punës së tij shkencore dhe të mësimdhënies prof. Qazim Xhelili ka qenë edhe një aktivist i shquar shoqëror. Ai në vitin 1978 drejtoi në një turne të gjatë jashtë shtetit Ansamblin Artistik “Migjeni”, ku korren sukses të jashtëzakonshëm, falë artistave të rrallë që kishte ky ansambël, ku për nga përmasat artistike vinte pas Ansambllit të Shtetit.

Falë punës së tij shkencore prof. Qazim Xhelili mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Historike” dhe titullin “Asistent Profesor”.

Pas shumë botimesh në disa organe shkencore dhe të shtypit të përditshëm periodik, prof. Qazim Xhelili doli para lexuesit me monografinë mbi jetën dhe veprën e personalitetit të shquar të lëvizjes sonë kombëtare dhe të teologut të devotshëm, Vehbi Dibra.

Duhet theksuar se prof. Qazim Xhelili ka qenë një hulumtues i rregullt i historisë së lavdishme të Dibrës, trevave prej të cilit ai vjen, ku ai ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, me studimet e tij shkencore, bazuar në prova dhe fakte për luftën në Dibër dhe krejt krahinës së Pollogut.

Veprimtaria patriotike e Vehbi Dibrës ishte lënë disi në harresë dhe ka qenë vlerësuar në mënyrë të njëanshme nga historiografia jonë, ashtu siç ka ndodhur dhe me mjaft figura të tjera të ndritura të pavarësisë, luftëtarë të shquar, atdhetarë e demokratë të tjerë dhe kështu prof. Qazim Xhelili bën një thirrje që më në fund historia jonë duhet të reagojë dhe t’u japë vendin e merituar këtyre njerëzve që dhanë gjithçka për pavarësinë e Atdheut.

Ngjarja më e rëndësishme në jetën dhe veprimtarinë patriotike të Vehbi Dibrës është pjesëmarrja e tij në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, që shpalli Pavarësinë e Shqipërisë dhe që e zgjodhi këtë burrë të nderuar të Dibrës e të mbarë vendit kryetar të Pleqësisë

Profesor **Qazim Xhelili**, një jetë në shërbim të arsimit në Shqipëri



Pas shumë botimesh në disa organe shkencore dhe të shtypit të përditshëm periodik, prof. Qazim Xhelili doli para lexuesit me monografinë mbi jetën dhe veprën e personalitetit të shquar të lëvizjes sonë kombëtare dhe të teologut të devotshëm, Vehbi Dibra.

(Senatit) të parë shqiptar. Caktimi i Vehbi Dibrës si delegat për në Kuvendin e Vlorës, nuk qe thjeshtë një gjest nderimi si misionar i fesë, por ishte një barrë e madhe që i ngarkoi populli i krahinës për të çuar fjalën e maleve të Dibrës në Vlorë.

Vehbi Dibra u bë bashkëpuntori më i afërt i Ismail Qemalit. Akti i parë që mori Vehbi Dibra në qeverinë e Vlorës ishte që çdo dokument do të nxirrej në gjuhën shqipe. Në kohën kur Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, dom Nikoll Kacorri e të tjerë ishin në udhëtime jashtë vendit, në kancelaritë e Europës për njohjen e shtetit të ri, Vehbi Dibra drejtoi shtatë mbledhje të Qeverisë, ku mori shumë akte e vendime të rëndësishme në ruajtjen e kufijve të Shqipërisë.

Interesante na e sjell prof. Xhelili “Fetfanë”, që i jep Vehbi Dibra për shpalljen e Pavarësisë, ku e bekon atë. “Fetfaja” e mbajtur në kuvendin e Vlorës nga Vehbi Dibra nuk ishte një lutje fetare, as një përshëndetje e thjeshtë, por një dekretim i aktit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë e shkëputjes së saj nga perandoria dhe kalifati osman, një thirrje për të ngritur e mbajtur lart flamurin kombëtar. Vehbi Dibra nuk i reshti përpjekjet për ngritjen dhe fukisionimin e shtetit shqiptar. Ai e urrente anarkinë, prandaj luftoi gjithë jetës së tij që shqiptarët të kenë shtetin e tyre ligjor dhe të pavarur.

Mbas vitit 1912 dallgët e luftës për Shqipërinë shtohen: lufta e parë botërore, lufta ballkanike vërshojnë për të copëtuar trojet shqiptare. Në këtë periudhë Vehbi Dibra është i angazhuar i tëri në veprimtari patriotike.

Prof. Qazim Xhelili në këtë periudhë të pasluftës së parë botërore, Vehbi Dibrën e sjell si një proamerikan të devotshëm. Principet e Ullsonit nuk janë veçse një të shfaqur i vullnetit të zotit që predikonte me forcë Vehbi Dibra para shqiptarëve. Ai luftoi për vendimet e Kongresit të Lushnjës, bashkëpunoi me qeverinë e Suljeman Delvinës, ku duket fare qartë fryma e patriotizmit, në të cilën ai donte që të ishin të pajisur njerëzit e qeverisë,

Duhet theksuar se prof. Qazim Xhelili ka qenë një hulumtues i rregullt i historisë së lavdishme të Dibrës, trevave prej të cilit ai vjen, ku ai ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, me studimet e tij shkencore, bazuar në prova dhe fakte për luftën në Dibër dhe krejt krahinës së Pollogut.

Veprimtaria patriotike e Vehbi Dibrës ishte lënë disi në harresë dhe ka qenë vlerësuar në mënyrë të njëanshme nga historiografia jonë, ashtu siç ka ndodhur dhe me mjaft figura të tjera të ndritura të pavarësisë, luftëtarë të shquar, atdhetarë e demokratë të tjerë dhe kështu prof. Qazim Xhelili bën një thirrje që më në fund historia jonë duhet të reagojë dhe t’u japë vendin e merituar këtyre njerëzve që dhanë gjithçka për pavarësinë e Atdheut.

që t’i shërbenin si duhet vendit dhe popullit.

Edhe në rolin e tij si klerik e kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar, prof. Xhelili na e bjen Vehbi Dibrën si një ideolog i fesë islame evropiane. Ai ka luajtur një rol të veçantë me kontributin e tij për organizimin mbi themele kombëtare të fesë muslimane në Shqipëri.

Si një klerik patriot dhe veprimtar politik-shoqëror, aktivitetin e tij fetar ai e vuri në shërbim të vendit, duke mos hequr dorë e duke zhvilluar një veprimtari të gjithanshme për çështjen kombëtare. Kjo lidhje e ngushtë e misionit të tij fetar me aktivitetin patriotik, për vetë kushtet që kalonte vendi, ishte për ‘të një domosdoshmëri për momentin dhe për të ardhmen e shtetit shqiptar.

Edhe pse nuk e jetoj sistemin totalitar komunist Vehbi Dibra bënte pjesë në plejadën e dijetarëve muslimanë që i bënë një kritikë të goditur ideologjisë komuniste, sigurisht në kushtet e Shqipërisë së atëhershme, kur idetë dhe lëvizja komuniste ishin në fillimet e veta.

Prof. Qazim Xhelili ka meritën e tij se na e sjell veprimtarinë patriotike e teologjike të Vehbi Dibrës, të bazuar në një studim të hollësishëm shkencor e të dyja këto cilësi i vuri në shërbim të Atdheut në ditët më të vështira të tij.

Jona Demiri, mësuese historie
Shkolla 9-vjeçare Kolegji “Turgut Ozal” Tiranë.

skice letrare


Nga Besnik LAMI

Është mesi i gushtit. E diel. Dielli përvëlon nga kupa e qiellit. Larg në horizont, atje ku duket se malet puqen me qiellin ka re që sjellin freski e shpresë për shi nga thatësira e zgjatur tremujore. Rugët e qyteteve dhe të qendrave të banuara gumëzhijnë nga njerëzit e sidomos nga karvanët e makinave. Këto ditë të nxehta gushti i zbukurojnë më tepër autokolonat e gjata të veturave që lëvizin pa mbarim nëpër rrugët e qyteteve tona, kudo nëpër Tiranë e Durrës, në Elbasan e Berat, në Peshkopi e Shkodër. Ngado që të shikosh në këtë të diel gushti sheh vetëm autokolona veturash të zbukuruara me lajle e lule. Janë autokolona që kanë ë brenda dasmorë, kanë brenda çiftet e reja që martohen në këto ditë të bukura vere. Para 30-40 vitesh nusët i merrnim me kuaj. 12-15 kuaj të zbukuruar me sixhade e krushq të veshur me kostume kombëtare venin te miku i ri të merrnin nusen e mbuluar me duvak të kuq. Një kalë i mirë i zbukuruar më tepër se tjerët ishte caktuar enkas për të kalëruar nusja e re.

Dasmorët udhëhiqen nga daja e dhëndrit, nga një djalosh i ri që mban në dorë flamurin kombëtar dhe ahengxhinjtë që u bien lodrave e curleve. Po kohët tash kanë ndërruar dhe në Shqipëri. Jemi në gjysmën e dekadës së parë të shek. Të 21-të. Shqipëria ka ndryshuar, ka bërë hapa përpara në ekonomi, në mentalitet, në politikë e kudo. Karvanët e kuajve që venin të merrnin nusen e re tash i ka zëvendësuar autokolona e veturave të bukura me targa të vendit e të huaja që i kanë siguruar të rinjtë tanë të blera me mund e djersë në vendet ku ata kanë emigruar si Itali, Greqi, Gjermani, etj. Ahengxhinjtë tash i kanë zëvendësuar kasëtofonët e altoparlantët e makinave që buçasin nga këngët e bukura të muzikës shqiptare. Në krye të autokolonës prin vetura që mbart kameramanin, i cili fikson në celuloid këto çaste kulmore të jetës së çiftit të ri të shoqëruar me pamje të bukura të natyrës e të qyteteve tona. Pastaj vjen taksia e çiftit të ri e drejtuar nga dhëndri i ri i veshur me kostumin e dhëndërisë dhe nusja e re e veshur me vellon e bardhë. Prapa veturës së çiftit të ri vijojnë 10-12 vetura të mbushur me dasmorë, me goca e çuna të rinj që këndojnë e kërcëjnë për gëzimin familjar.

Në boritë e stërzgatura e muzikën e bukur shqiptare që buçet në ajër, autokolona e dasmorëve kërkon të hapet rruga. Këmbësorët ndalojnë në çast, hapin rrugën e shikojnë gjithë habi e gëzim autokolonat e gjata të veturave që mbartin dasmorët e gëzuar, çiftin e ri që ripërtërin jetën, ripërtërijnë kombin. Autokolonat e veturave që kanë brenda dasmorë e çiftet e reja janë pa mbarim. Sa janë jato? Janë 10- 15, ndoshta 20 e më tepër. Këto

Dasma



Dasma- Pikturë nga Zaim Elezi/Zaya

autokolona veturash me lajle e lule zbukurojnë qytetet e rrugët e atdheut në këto ditë të bukura vere. Ata u japin gjallëri rrugëve të Shqipërisë, fshatrave e qyteteve të saj. Janë shumë. I shikon këto autokolona e të kënaqet shpirti. Martohen çiftet e reja. Trashëgohet jeta. Nga këto martesë të bukura shqiptare gjallërohet e rilind Shqipëria, kombi. Janë të rinjtë që kanë punuar për vite të tëra në Angli, Itali apo Greqi dhe tash në një moshë të pjekur kthehen në vendlindje të martohen me vajza shqiptare, me ato që u ka dash zemra që të trashëgojnë jetën, të gëzojnë familjet e tyre, nënë e babë, motra e vëllezër. Martohen me vajza të bukura shqiptare për të mbajtur të pastër racën tonë, gjakun tonë, traditat tona. Ja, në këtë ditë të bukur gushti bëhet një dasmë e bukur dhe në lagjen treg të qytetit të Peshkopisë. Thuhet se martohet një i ri që ka jetuar që 7-8 vjet si emigrant në SHBA dhe tash kthehet në Shqipëri për t'u martuar me një vajzë të bukur shqiptare. Kjo është tradita shqiptare, instinkti i shqiptarit, të martohet me njerëz nga raca e tij, për të mbajtur gjallë zakonet tona të mira.

Padashur të del nga zemra urimi : Jetë të lumtur, o çifte të reja! U trashëgofshi e shumofshi Shqipërinë për jetë e mot! Çdo martesë rilind jetën, lind një familje e re. Këto të rinj që u martuan sot, nesër përsëri do të marrin rrugët e kurbetit për të punuar, se hë për hë atdheu i tyre s'u siguron punë. Me vete shumica do të marrin dhe familjet e tyre të reja për të trashëguar jetën e për të mos harruar kurrë nënë e babë e familjet e tyre, nënën e madhe Shqipëri.

Udhë të mbarë, o çifte të reja në jetë e në punë! Punoni, mësoni e mos harroni kurrë nënën e madhe Shqipëri! Ajo u pret kurdoherë me krahë hapur e dashuri nënë. Ajo pret gjithmonë më shumë nga ju, që ta forconi e ta zbukuroni atdheun tuaj. Dasma paç përherë, o nënë Shqipëri!

KRITIKË Libri i ri

“Pëllumbat nuk janë të qetë”, libri i ri poetik i Naim Berishës

Nga Halil RAMA

Njëmbëdhjet vëllime me poezi për të rritur, katër libra me poezi për fëmijë, pesë libra me fabula e poema, tre me hajke, dy me sonete, një me tekste këngësh, tre libra me përkthime të soneteve të Shekspirit, gjashtë romane dhe dy vëllime me tregime, si dhe tre albume me këngë, padyshim që përbëjnë një bilanc mjaft të pasur të poetit, prozatorit dhe kanautorit të mirënjohur Naim Berisha. Kësisoj, nga laboratorit i tij krijues, në tridhjet vite janë botuar e promovuar 37 libra, të cilët zënë vend nderi të fondin e artë të letrave shqipe.

Botimi më i ri tij, vëllimi poetik “Pëllumbat nuk janë të qetë” me 138 vjersha dhe një poemë, në 206 faqe, për vetë tematikën mjaft të larmishme, vjen si një befas në tregun tonë të librit.

Ritmi në poezitë e këtij libri lëviz për shkak të përdorimit të natyrave të ndryshme strofore. Në të hasim pa ndonjë rregull të caktuar poezi dyshe, treshe, katërvargëshe apo monokolonë, ka edhe të përziera, etj. Për këtë shkak ato kanë edhe veçori të ndryshme. Poezia dyshe “Brenda bukurive” është më koncize, ajo treshe “Pa dashuri” ndërtohet me pak subjekt, ndërsa të tjerat, si ato të titulluara: “Ish mëngjes a mbrëmje”, “Në qytetin e Budit”, “Gjer te parku i pëllumbave”, e ndonjë tjetër kanë dimension kohor dhe vendor. Disa poezi, here pas here, janë si këngë të vogla gazmore, jo nga motivet, por nga gazmimi që përcjellin. Sikur luajnë fushave, fshatrave, etj, sikundër ato të titulluara: “Malli për bregun”, “Do vish një ditë” dhe “Pse ngadalë”, e të tjera, ku kemi peizazhe fshati lëvizës dhe ku jeta, vdekja, ëndrra, rendja, qetësia, koha, garojnë së toku. Më së miri këto reflektohen në poezinë e faqes 50-të: “Do vish një ditë”, “Sa shumë vjersha për ty kam thurur/ Bri lumit Drin, fushës së gjerë/ Se të kam dashur, jo për t'u mburrur/ për ty pëmbysja një mal të tërë ...”

Një nga poezitë më të bukura është ajo “Letër motrës” ku përditshmëria, jeta e gjallë, janë vizioni i botës për Naim Berishën. Ndaj dhe shkruan vargjet: “Ndaj, motër/ të të mos mbetet hatri/pse bos s'më bëka as Anglia/ S'thosh kot/ I madhi Sartri/ -Tek e thjeshta asht dhe madhështia”.

Nga leximi i këtij libri mrekullohesh gjithashtu nga dhjetëra poezi, ku lirika e tij është filozofia e jetës, e kultit të së bukurës e çastit ekzistencial, e lindur nga mrekullimi i njeriut të thjeshtë përballë paradokseve dhe mrekullive të natyrës, si te “Lektisje”, “Kur e bukur asht zemra”; “Para teje zbehet hëna”, “Loti i dashurisë”, etj. Naim Berisha, të cilin në qarqet letrare të kryeqytetit shqiptar, por edhe në Londër, ku jeton familjarisht prej më se dy dekada, e cilësojnë si një poet të pajisur me talent dhe dije, i gatshëm estetikisht për të rivitalizuar, midis të tjerash, lirikën shqipe të dashurisë, me librin e tij të 37-të “Pëllumbat nuk janë të qetë”, shënon një ngjitje të dukshme në shkallaren e letërsisë.

Lexo shkrimin e plotë në lidhjen më poshtë ose skano QR Code:

<http://www.panorama.com.al/nga-driteroi-te-laco-e-arapi-si-e-vleresojne-poezine-e-naim-berishes/?fbclid=IwAR2wuY10hEy3VdWogbulJfTJBwOJyDtkLpLrZ6RUXcl5Yhmp7rE4XWsyTY>



Poetja e drithërimave, ngjyrave dhe lirikave të shpirtit

Nga **SHAQIR SKARRA**

Në fakt nuk e prisja kaq shpejt ku brenda vitit poetja, tashmë e afirmuar dhe e njohur nga lexuesi i shumë shqiptarë, për lirikat e bukura dhe plot kolorit, Sulbije Shehu(Tota) do të na jepte si dhuratë librin e saj të tretë me titull “I fola hënës me pika loti”.

Tre libra, që të tre me poezi e që të tre me lirika. Dhe po thuaj nga fjala në fjalë, nga vargu në varg, nga strofa në strofë, lotët në poezitë e saj janë të ngrohta e plot dashuri.

Një ansambël i bukur në arkitekturë, plot sharm në vargëzim, plot zjarr në frymëzim, kur muza e poetes rri përherë ndezur. Vargjet poetike, Sulbije Shehu (Tota) i ngre jo mbi hirin e ftohtë që lënë prapa kohërat e përjetuara, sipërfaqësisht, por mbi flakën që mban ndezur, përjetësisht krijuesin e vërtetë.

Në mënyrë të sintetizuar poezia e Sulbije Shehut mund të klasifikohet si poezi e harmonive të shumta e mjaft të mëdha. Kjo poezi është harmonike në botëndijim dhe botëperceptim, në strukturimin sintaksor dhe atë ritmik, në akordet muzikore dhe imazhe.

Në poezinë shqipe, zëri i saj është i një cilësie të veçantë, ku tingëllon butësia e lirizmi, që kur e kur ndryshon modulohet, dallëzon bashkë me botën përreth dhe prapë e pranishme mbetet matura në shprehjen e mendimeve poetike dhe ndjenjave. Libri me lirika “I fola hënës me pika loti” jo që është ndryshe nga të parët por vetë vargu i poetes Sulbije Shehu të rrëmben, të tërheq si me magnet e nuk të lëshon deri sa e lexon librin nga poezia e parë e në të fundit.

Forma e të krijuarit poezi e poetes Sulbije Shehu(Tota), dallohet për nga rezultati i mëvetshëm poetik dhe në rezultatin e vlerës poetike. Zgjerimi i tematikës e lidh tematikën kuptimore në mënyrë organike, pasi llojshmëria është krijuar nga autorja me mjaft mjeshtëri dhe përpikmëri.

Dashuria është universi poetik më i plotë i Sulbije Shehut. Do të ishte me mjaft interes të hetohej në mjaft detaje se cila është në fakt përqasja e fakteve me shprehjen mjaft emocionale të vargjeve që mbruhën me këtë ndjenë të madhe fisnike, njerëzore e kaq të fuqishme në poezinë e poetes. Pa tjetër duhej të na shfaqej diku një Beatrice, një Xhulietë, një Romeo që trazon ëndrrat e poetes, për të mbetur ashtu, si një ëndërr e bukur e të gjitha moshave.

Po për poeten pak rëndësi ka vasha tek kroi i fshatit, djali çoban të cilët iu shfaqën në jetë për të mbetur përgjithmonë në poezinë e saj. Rëndësi shumë kanë emocionet e përfituara si rrjedhojë e përjetimeve të tilla, sepse, vasha, djali dhe dashuria në poezinë e saj janë një dhe një.

Universi i dashurisë është kaq tokësor, është një puthje, një përkëdhelje diku në krua apo lëndinë, një lot i ngrohtë që tradhton sytë e të dashuruarve, por që ngërthen hapësirat kozmike të të gjitha kohërave qysh nga antikiteti; është kufiri i dhimbjes me kënaqësinë, kufiri i jetës me vdekjen. është në fund të fundit mundësia e realizuar ose. pikërisht në këtë të dytën, revolta e brendshme e poetes, shpërfaqet me çiltërsinë e vet të skajshme:

“Asnjë fjalë ti nuk fole,
Sytë e zinj mbuluar lot’.
Hapa krahët nëpër ëndërr,
Desha të të përqafoj fort’”.

Poeti është poet kur identifikohet në fakt me poezinë e vet, me çdo varg, me çdo fjalë. në poezitë e Sulbije Shehut kjo është e pranishme kudo, e shpallur si kredo. Në poezinë e saj, vërejmë qartë interesimin e saj



me tendencë për të dëshmuar ekzistencën e njerëzve të thjeshtë të kohës që po kalojmë këtë proces ajo arrin ta nxjerr me realitet, sepse përqendrimi i vëmendshëm i autores bën që ajo ta hetojë vargun e saj, të prek situata të caktuara kohore gjer në realitetin aktual të kohës.

Poetja shfaqet në poezinë e saj me një shkallë të lartë ndjeshmërie, perceptimi e gjykimi për vetë fatet historike dhe njerëzore të bashkësisë shqiptare. Në këtë rrafsh do ta quaja me plot të drejtë një nga poetet më autentik dhe origjinal.

Në lirikat e bukura të saj jeta është shumë e shtrenjtë, njeriu është ai që ndërton të ardhmen, natyra e frymëzon, e zbut, i përkëdhel ndjenjat, dashuria i pasuron shpirtin. Lotët në poezitë e saj janë të ngrohta e plot dashuri. Dhe në poezinë “Ku shkoi vajza me trëndafil” ja si do të shprehet:

“Çdo mbrëmje, vajzën prisja me padurim,
Ajo shfaqej e bukur, me trëndafil në duar.
Vajza me trëndafil, e trazonte shpirtin tim,
Mos vallë dhe unë me të isha dashuruar?”

Poezia është vetë shpirti, produkt i një vuajtje dhe i një shtërzimi të madh shpirtëror. megjithatë, unë duke lexuar dhe rilexuar lirikat e Sulbije Shehut, disa herë përpiqem e rrëfej se çfarë ndiej e shikoj brenda shpirtit të poetes. Në atë mister ku nuk hyn dot mendja, shoh dhuntinë dhe ndjesinë e lindur.

Në laboratorin e poetes, thuajse çdo ndijim, së pari shfaqet në formën e ngjyrës, mandej ajo i jep mundimshëm trajtën e

fjalës. Pra e para është ngjyra, jeshilja e përgjumur, gjelbërime shpresash, pjalm tërfili ngjyer...Raporti i poetit lirik me piktorin nuk është i njëjtë. Poetja i ka ngjyrat e drithërimat e tyre të kyçura brenda shpirtit dhe i nxjerr ato për të ngjyer dhe zbukuruar sendet dhe shpirtat e njerëzve me ngjyrat e shpirtit të saj. Në poezinë “Kafja me ty” autorja shkruan:

“Eh! do i mbledh ca copa kujtimesh,
Të gjitha gjer në imtësi.
Beto hem që kurrë s’do të harrohet,
E bukur vërtet, sot dita me ty”.

Ngjyrat e lirikave të poetes Sulbije Shehu(Tota), janë ato të vendlindjes, të virgjëra, të freskëta dhe të papërsëritshme, ashtu siç janë ngulitur në shpirtin e saj qysh në fëmijëri.

Peizazhi i bukur i Vilës në të gjitha stinët e vitit, si mall fëmijërie, qielli i spërkatur me qumësht hënë, lëndinat ku kullosin bagëtitë, kroi i bukur i vashave, gjithë i venitur i lisit të moçëm që bie si lot i vajzës që humb dashurinë, uturima e Drinit plak, puthja e cucës në stan, bryma e vjeshtës. E poetja i kthen ngjyrat në simbole, në fjalë, në vargje, në poezi ndjesish emocionesh të pa shlyera.

Poezitë e librit më të ri “I fola hënës me pika loti” të poetes Sulbije Shehu, provojnë qartë se lirika nuk mund të shpallet kurrsesi dalë mode. Lirikat janë pjesë e krijimit botëror në të gjitha kohërat. Mendoj se lirikat dhe vëllimi me poezi i poetes Sulbije Shehu (Tota) ndihmon ndjeshëm në pjalmimin e shpirtit tanë.



THËLLËZË RRITUR NË KORAB

Sa e ëmbël po më dukesh,
Thëllëzë rritur në Korab.
Nga momenti që të njoha,
Dua me t’pas vetëm ngat.

Unë i brodha malet,
Kodra edhe shkrepja.
Oh sa shumë u lodha,
Deri sa ty t’gjeta.

Lule m’lule shkova,
Nektarin tuj provue.
Në bjeshkët kuksjane,
Gjeta atë që me shpirt due.

Borën do ta shkri,
Dimrin ta bëj verë.
Që për ne të jetë,
Pranverë për çdo herë.

CUCË E BJESHKËVE TË MIA!

Çbukuri moj të ka rënë,
Si një gonxhe larë me vesë.
Mos je diell apo je hënë,
Që shkëlqen nëpër mëngjes.

Ah’ sa shumë të qesh fytyra,
Ata sy ylber me harqe.
Trëndafil i larë me vesë,
Për ty bëj një mal me vargje.

Ti je lulja ma e bukur,
Je shkëndijë e mençurisë.
Dhe në shtigjet e errësirës,
Ti je dritë e urtësisë.

Si pranverë lule çelur,
Më je bërë vargje për shpirtin.
I a jep ndryshimin stinës,
Në mes dimrit çel filizin.

S’do e ndal vargun, as këngën,
Për ty varg malesh do bëj.
Nëpër vite do të ruaj,
Dashurinë që nuk ka faj.

DRITË PËR SYTË E MI

Në mes të errësirës, dritë për sytë e mi,
Ndaj dhimbjeve të zemrës, ilaç për shërim.
Larg teje kur jam, më keq se në vetmi,
Me prezencën tënde, ngrihem fluturim.

Dhe po nuk fole e s’më the asnjë fjalë,
Mjafton të shikoj, tek ti frymë të marrë.
Më qetësohet shpirti, zemra kërkon t’dalë,
Nga magjia jote dehje e pa parë.

Ti ma dinë dobësinë, ndaj luan me mua,
Herë më largohesh, më ndjek me bisht syri.
Dhe fare pa folur, shpesh m’thua të dua,
Pranverë bëhet dimri me ty lule prilli.

Kontribut të veçantë Mulla Tafiku ka dhënë në hapjen e shkollës së parë shqipe në Ploshtan në tetor-nëntor 1922, ku ai ishte sekretar komune e imam në Ploshtan.

Nga ISMEN BRIKA

Tafik Gjorllaku lindi në fshatin Ploshtan të nënprefekturës së Bice në vitin 1865 dhe ka ndërruar jetë në vitin 1971. Ai është njeriu më jetëgjatë në fshatin Ploshtan e në gjithë zonën e Kalasë së Dodës.

Rrjedh nga një familje patriotike, klerikale. Ai ka bërë emër për fe, atdhe, për zhvillimin e arsimit në Ploshtan e në Kala të Dodës. Ai gëzonte veti si njeri me karakter të fortë e me shumë dhunti, gëzonte kulturë fetare me dije të thella të filozofisë islame, si dhe kishte veti të veçanta të një udhëheqësi shpirtëror. Ai gëzonte zgjuarsia oratorike, kishte kulturë në komunikim, urtësi e sjellje shembullore, ishte njeri me vullnet e me dëshirë për profesionin e Hoxhës e të administrimit të punëve në Komunën e Ploshtanit. Mulla Tafiku ishte një organizator i zoti në punët e fshatit e të komunës, të xhamisë e më gjerë të zonës. Ishte besimtar i përkushtuar ndaj fesë, Zotit, atdheut, burrë trim e besnik. I dashur me banorët e zonës e bashkëfshatarët. Këtë dashuri e kishte dhe me nxënësit e xhematin. Ai zotëronte shumë mirë gjuhën shqipe, turqisht dhe arabisht.


Mësimet e para i mori në mejtepin e Ploshtanit nga mësues mulla Sadik Dani e mulla Sejfullah Sefa nga Carenit. Në Ploshtan mbaroi shkollën Rruzhdije me rezultate shumë të mira nga viti 1886 deri në vitin 1890.

Duke parë përgatitjen shumë të mirë, ai dërgohet në mejtepin e Prizrenit me profil Hoxhë, por dhe për administratë publike, shkollë të cilën e mbaroi shumë mirë. Pas mbarimit të shkollës caktohet sekretar në Komunën e Ploshtanit nga viti 1893 deri në vitin 1898 dhe drejtues i shkollës lptadije në Ploshtan. Familja dhe administrata turke e dërgon me studime në Stamboll për teologji e administratë, shkollë të cilën e mbaroi shumë mirë. Ai caktohet përsëri sekretar komune në Ploshtan nga viti 1902 deri në vitin 1923. Qenia e tij si sekretar komune dhe imam në fshatrat Ploshtan, Shulla, Bejshe e Dode bëri që ai të njihet me shumë figura të fesë islame, të Mifterisë së Prizerenit si Qazim Laçi, Bedri Pojani e Hoxhë Memeti i Shtiqnit. Ky qe dhe shkaku që ai bleu shtëpi e tokë në Prizren për të jetuar me familjen. Mulla Tafiki ishte njeri me vullnet e dëshirë në profesionin e Hoxhës, ai përgatiste të rinjtë e të rejat në zbatimin e riteve fetare, ishte një ligjërues i vajzave para xhematit, ai qe një komentator i shkëlqyer i Kuranit në gjuhën shqipe.

Mulla Tafik Gjorllaku ka dhënë mësim në shkollën Rruzhdije të Ploshtanit nga viti 1902 deri në vitin 1912 së bashku me Mulla Sadik Potja e Mulla Gafur Brika.

Sa herë që fatet e atdheut kanë qenë në rrezik, Mulla Tafiki ka luftuar me armë në dorë kundra forcave turke nga viti 1890 deri në vitin 1912. Ka marrë pjesë në betejën e Kolesianit kundra serbëve nga data 14 deri me 17 nëntor. Ky qe dhe shkaku që forcat serbe vranë në Caren babën e tij Shaban Gjorllaku e shumë të tjerë ploshtanas e carenas. Molla Tafiki në luftërat e zhvilluara me 1913 kundra serbëve ka kryer dhe rolin e korrierit midis forcave të Lumës e Anes se Epër. Ky qe shkaku që me 5 tetor 1913 u mor peng nga serbët bashkë me Vehap Brikën, Hasan Hidrin e Molla Gafurrin

Mulla Tafik Gjorllaku



Mulla Tafiki është një ndër themeluesit e shkollës së parë shqipe Ploshtan. Ai do të kujtohet si njeri arsimdashës e kontribues në zhvillimin e arsimit, si njeri trim, patriot e atdhetar, si njeri me edukatë e kulturë, si njeri i besës, si predikus, zbatues i riteve fetare në Ploshtan e ne gjithë zonën e Kalasë së Dodës. Ai do të mbahet mend edhe si drejtues në Komunën e Ploshtanit, si njeri që nuk ju nënshtrua asnjëherë pushtuesve e sidomos atij serb.

Mulla Tafiki mbahet mend si sekretari i komunës më jetëgjati, 30 vjet, dhe 70 vjet imam në Ploshtan e Palushe të Bushtricës. Ka falë xhenaze në Ploshtan e në gjithë zonën e Kalasë së Dodës.

Mulla Tafiki ka qenë një ndër themeluesit e “Klubit Bashkimi”, që u krijua në komunën e Ploshtanit, pas Kongresit të Manastirit.

Ai ka qenë anëtar i komisionit të zgjedhjeve në vitin 1923, ku deputet i Lumës u zgjodh Avni Rustemi.

Mulla Tafiki ka qenë përkrahës i qeverisë së Nolit. Ai ka qenë një nga organizatorët për takimin që do të bënte Bajram Curri me kuadrot e komunës së Ploshtanit e me popullin e fshatit Ploshtan në shtëpitë e Hakik Ademit.

Mulla Tafiki bashkë me nipin e tij Rufatin, Malikin ka qenë anëtar i komisionit të zgjedhjeve të këshillave nacionalçlirimtare në Ploshtan në vitin 1944.

Nipi i tij Rufati ka qenë kryetari i parë i Frontit Demokratik në Ploshtan.

Ka qenë kryetar i bashkësisë islame për Kalanë e Dodës dhe anëtar i bashkësisë islame me qendër në Bice.

Ka qenë kryetar për ruajtjen e mirëmbajtjen e objekteve të kultit në zonën e Kalasë së Dodës, si dhe kryetar i komisionit të xhamisë së Ploshtanit dhe i administrimit të tokës Vakuf që Ploshtani ka, 74 dynymë arë.

Ka qenë një ndër organizatorët e vendosjes së itifakteve në Ploshtan e merita e tij qe kur u kthyen nga muhaxhirliku ploshtanasit vendosën që të mos ketë martesë brenda fshatit dhe të gjithë janë motra e vllazër.

Pasardhësit e Molla Tafikit qenë organizatorët e rikonstruksionit të xhamisë së Ploshtanit në vitet 1990.

Mulla Tafiki është një ndër themeluesit e shkollës së parë shqipe Ploshtan. Ai do të kujtohet si njeri arsimdashës e kontribues në zhvillimin e arsimit, si njeri trim, patriot e atdhetar, si njeri me edukatë e kulturë, si njeri i besës, si predikus, zbatues i riteve fetare në Ploshtan e ne gjithë zonën e Kalasë së Dodës. Ai do të mbahet mend edhe si drejtues në Komunën e Ploshtanit, si njeri që nuk ju nënshtrua asnjëherë pushtuesve e sidomos atij serb.

Puna në Kala të Dodës e bëri me shumë miq e shokë që e donin dhe çmonin për atë çfarë bënte dhe marrëdhëniet me këta njerëz të mirë e fisnikë do t'i ruante deri në frymën e fundit të jetes ...

Nga DUKAGJIN HATA

Në ata vite të trazuar që lame pas, ku gjithçka tollavitej në vorbullë ankthi dhe depresioni kolektiv, të paktë ishin ata që me modelin e sjelljes së tyre lanë gjurmë të mira dhe do të përkujtohen me mall e dashuri nga të gjithë ata që i njohën dhe përfituan nga shërbimet e tyre.

Një ndër ta është dhe Rexhë Rexha nga Sllatina, mjeku i përkushtuar dhe pasionant, që gjithçka e vuri në shërbim të njerëzve ku shërbeu me përgjegjësi e dashuri.

Bir i një familje të ardhur herët nga Gjakova e më tej në Sinë të Dibrës, familja Rexha gjeti në Sllatinë, ku erdhi dhe u ngul, përkrahje e respekt dhe vetë i dha ato me tepri, duke u shquar si familje bukë e besë, arsimdashëse e lirisdashëse.

Rexha u rrit në një familje me tradita të ngulitura atdhetarie e ku sofra e bukës dhe mikpritjes ishte sofër dinjiteti dhe projekcion i hijes që lëshonte dera e Rexhëve në prehër të maleve.

I ati, Rexhepi, ishte një burrë me sqimë, i etur për dije, siç kishin qenë të parët e tij, të shkolluar në Europë e Perëndim. Ai ishte njeri i ngritur për kohën dhe punonte në Peshkopë, në sektorin e Tregtisë. Donte që i biri të bëhej dikush në jetë, ndaj e nxiste dhe inkurajonte që të mësonte sa më shumë, gjë që djaloshi Rexhe Rexha e bënte me zell e pasion.

Pas përfundimit me rezultate të shkëlqyera të ciklit fillor e shtatëvjeçar, me shumë vështirësi për shkak të konjunkturave partiake të kohës, i ati ia doli ta regjistronte të birin në Shkollën e Mesme Mjekësore në Tiranë, me dëshirën që ai të bëhej mjek i shquar dhe t'u shërbente me zemër në dorë bashkëfshatarëve të tij.

Në shkollë Rexha shkëlqeu për zgjuarsin dhe intuitën, për zell në përvetësimin e dijeve e veçmas të atyre dijeve që lidheshin me profesionin për të cilin studionte... Por, megjithëse ia doli ta mbaronte këtë shkollë me rezultate shumë të mira dhe me gjithë dëshirën dhe këmbënguljen e të atit që i biri të vazhdonte studimet e larta për Mjekësi, konjunkturave partiake të kohës, me ndasitë dhe paragjykimet e një kohe të sëmurë, nuk e lejuan. Por djaloshi energjik dhe plot zell për dituri, nuk e ndali asnjë çast hapin dhe kudo që e çuan për të shërbyet, pati si busull jo vetëm dashurinë për njerëzit, por dhe leximet e thelluara dhe gjithë pasion në librat dhe dijet mjekësore.

Muhabetin e bënte “me rrotulla’ ose “nën mutaf”, duke prekur me intuitën e tij të hollë telat e shpirtit njerëzor... Lexonte shumë dhe me intuitën për të vështruar tej fasadave të epokës, në çdo bisedë bëhej zëdhënës i një mendësie të re për kohën dhe njerëzit.

Rexha Rexha, një jetë me stetoskop dhe zemër në dorë...



Ai ishte i dashur, i çiltër me njerëzit, këmbëngulës dhe pasionant në punë, duke e konsideruar mjekësinë më shumë se sa një profesion, një mision.

Në fillim e emëruan në Muhurr, ku shërbeu një vit, vitin e stazhit. Më tej e çuan në Kalanë e Dodës, një zonë në prehër të maleve e ku nevojat për dorën e mjekut ishin më urgjente se kurrë.

Ishte fillimi i viteve 1960 dhe për të kryer punën e tij, Rexhës do ti duhej të bridhte derë më derë, me çantën dhe stetoskopin në dorë, duke u ngritur mbi mjaft paragjykime të kohës që kishin ngritur krye, dhe qenë kthyer në mendësi në këtë trevë të largët dhe disi të izoluar për kohën.

Bie fjala, një mentalitet prapanik ishte refuzimi që i bënin ofertës mjekësore femrat, veçmas vajzat dhe gratë e reja, për shkak të mendësive frenuese zakonore. Mjekut të ri do t'i duhej të ushtronte jo vetëm profesionin e tij, që ai e konsideronte mision, por edhe atë të agjitorit për iluminimin e këtyre banorëve, që të mos kishte tabu dhe barriera midis tij dhe atyre.

Puna në Kala të Dodës e bëri me shumë miq e shokë që e donin dhe çmonin për

atë çfarë bënte dhe marrëdhëniet me këta njerëz të mirë e fisnikë do t'i ruante deri në frymën e fundit të jetes ...

Aty nga mesi i viteve '70, pas një kohe të gjatë vështirësishë e sprovash larg shtëpisë, e emëruan në Shumbat. Në këtë fshat të madh gjeti besë e mikpritje në çdo derë dhe ai ua shpërbleu shumbatasve me gadishmëri për të qenë pranë tyre në çdo kohë, shpesh duke sakrifikuar gjumin dhe hallet e tij familjare. Vinte shpesh në shtëpinë tonë, jo vetëm për nevojat tona mjekësore, por dhe për shkak të miqësisë me gjyshin tim Zane Hata, me të cilin flisnin për orë të tëra me gjuhën nën mutaf, që përmbante kode që vetëm ata dinin ti zbërthenin. Rexha ishte me intuitë të hollë dhe dinte të dallonte në morinë e gjërave që e rrethonin ato çfarë qenë të qenësishme dhe çfarë sekondare e kalimtare. I donte njerëzit dhe sakrifikonte për to, duke u bërë i dashur për të gjithë. Nuk u përzie kurrë në qerthullin e intrigave të kohës, ku shpesh mplekseshin kuadrot e paaftë e mediokër, por mbeti gjithmonë demokrat në shpirt dhe idealist në marrëdhënie me profesionin

Rexha kishte një besim të madh në profesionalizmin e tij, aq sa thoshte shpesh se po të kishte mundësitë dhe kushtet minimale teknike mund të kryente operime sado të vështira edhe këtu, në këto vise nën këmbë të maleve... Ai punoi çdo ditë të jetës së tij me një përkushtim shembullor, duke bërë gjithçka që mundi për të kuruar e parandaluar sëmundjet, për t'ua lehtësuar dhimbjet të sëmurëve.

dhe njerëzit që e rrethonin.

Megjithë diferencën e moshës, jam ulur shpesh në kafe me Rexhën, sidomos në Sllavë, ku unë vajta mësues në shkollën e mesme në fund të viteve '80, dhe ai punonte në spitalin e Sllavës. Dinte të bënte muhabet të përzgjedhur dhe me një zgjuarsin natyralë që të surprizonte, respektonte më të rinjtë dhe nuk anashkalonte as dhe një fëmijë...

Muhabetin e bënte “me rrotulla’ ose “nën mutaf”, duke prekur me intuitën e tij të hollë telat e shpirtit njerëzor...

Lexonte shumë dhe me intuitën për të vështruar tej fasadave të epokës, në çdo bisedë bëhej zëdhënës i një mendësie të re për kohën dhe njerëzit.

Rexha kishte një besim të madh në profesionalizmin e tij, aq sa thoshte shpesh se po të kishte mundësitë dhe kushtet minimale teknike mund të kryente operime sado të vështira edhe këtu, në këto vise nën këmbë të maleve...

Ai punoi çdo ditë të jetës së tij me një përkushtim shembullor, duke bërë gjithçka që mundi për të kuruar e parandaluar sëmundjet, për t'ua lehtësuar dhimbjet të sëmurëve. Pas daljes në pension, për shkak të lodhjes e stresit pas një periudhe të gjatë e të vështirë sprovash shërbimi orar e pa orar, pësoi paralizë të plotë pas një ataku në zemër dhe qëndroi rreth dhjetë vite i shtrirë në krevat, nën shërbimin e përkryer të bashkëshortes dhe të tetë fëmijëve të tij.

Ndërroi jetë në paqe të plotë me veten dhe me të gjithë, në Tiranë ku patën ardhur për të jetuar familjarisht, duke lënë pas nderimin dhe respektin e të gjithëve, një emër midis njerëzve, të cilët nuk do ta harrojnë kurrë dhe do ta kujtojnë me dashuri për gjithçka që ai ishte dhe bëri për ta...

Ndrëttë kujtimi yt brez pas brezi,
vëllau dhe miku ynë i shtrenjtë NEHAT DACI!

in memoriam

S'më bindet dora të shkruaj për ikjen n'amshim të shokut tim të vegjëlisë, të rinisë dhe të gjithë jetës, Nehatit tonë të dashtun! Na hidhërove shumë, na pikëllove me këtë ikje të beftë e të papritur! Ti që gjithnjë je shquar për karakter të fortë dhe korrektësi në marrëdhënie me njerëzit, Ti që i ke dashur qaq shumë Grevën dhe njerëzit, të gjithë pa dallim, nga Grevë në Reç dhe nga Reçi në Peshkopi e nga Peshkopia në Tiranë e Durrës, në ditën e fundit "na preve në besë"! "Më thuaj që nuk është e vërtetë" i lutesha mes lotësh Shqipërisë, shokut tonë të mirë, që i duhej të më jepte lajmin e hidhur! "Për fat të keq, është e vërtetë", më thotë ai, po ashtu, mes lotësh. Vetëm 3 ditë para ditës fatale, u takuam si zakonisht, dhe diskutuam për shumë gjëra, por kryesisht për raportin e veçantë që kishe me Grevën, të cilës para pak kohësh, me librin tënd enciklopedik, i ngrite një monument pavdekësie. Me një kënaqësi të veçantë dhe dritë që të buronte nga shpirti yt i bardhë dhe sytë e qeshur, më tregove që kishe qenë në Grevë dhe në Peshkopi, se kishe takuar dhe ishe çmallur me shumë njerëz të dashtun, të cilëve u kishe dhuruar librin tënd mbi Grevën e bukur, se ishe ngjitur deri në Kuplane, ku Hamzai ka krijuar një bllok të ri pemësh frutore. Sikur kishe shkruar të përshëndoshesh me vendlindjen dhe me njerëzit! Aspak nuk fole për shëndetin tënd, që shihej se nuk ishte ai i duhuri. Sepse ti nuk dije të ankoheshe kurrë! Edhe pse kishe vështirësi në ecje të gjata dhe lodhja vinte shpejt. Vetëm ku të pyetëm për shëndetin, na tregove se mjekët e kardiologjisë, të kishin caktuar datën 29 korrik për të bërë një coronarografi. Por nuk qe e thënë të arrihej kjo ditë! Në takimet dhe kafet e përditshme me shokët e lagjes, sikur vetë ata me dhimbje kujtojnë, biseda do të fokusohet vetëm tek puna me librin e Grevës, ecuria, vështirësitë, burimet historike, fusnotat dhe bibliografia. Kishe shkruar me dhjetëra herë në Grevë, kishe takuar me dhjetëra herë banorë të shumtë të saj, vetëm për të marrë apo për të verifikuar nga burime të sigurta qoftë edhe një informacion të vetëm, që i shtojnë shumë vlerat e këtij libri të mrekullueshëm.

U gëzove shumë shoku dhe miku ynë, Nehat, kur më në fund, e botove librin enciklopedik mbi Grevën, fshatin tënd që e deshe më shumë se veten! U ndjeve shumë i gëzuar dhe i lehtësuar! Dhe gëzimi ishte më se i kuptueshëm! Që kur lindi shkrimi (rreth vitit 750 para Kr.) e deri më sot, botimi i një libri kishte qenë një ngjarje e gëzuar dhe njëherësh e rëndësishme. E gëzuar pasi autori, pas një pune të gjatë e të lodhshme, shpesh here rraskapitëse, kishte arritur më në fund, të pasqyroj në një libër, një copëz historie. E rëndësishme pasi në këtë libër memorizoheshin ngjarje zulumuese dhe histori drithëruese, që do t'i mësonin dhe t'i dinin brezat më të rinj. Libri vinte pas një pune sistematike shumëvjeçare gjurmuese e hulumtuese. Që kishte filluar me marrjen me shkrim të kujtimeve nga brezi i gjyshërve dhe i prindërve tanë, që prej kohësh kanë ikur n'amshim! Kujtime që sot janë baraz me një thesar historiko-etnologjik! Thesar që s'do ta kishim patur kurrë, po të mos ishte puna jote skrupuloze vlla, e përditshme, sistematike! Duke filluar nga Nëna Betë, mjekja popullore duartë Beta e Dacit, që ne vërsnikëve të tu, na ngjante me teze Betsin e Dikensit. Një grua e urtë, fjalë pak dhe punë shumë, një doktoreshë e vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës. Nuk kishte mbetur fëmijë dhe i ri nga Grevë dhe nga fshatrat përreth dhe ato më të largëta, që të mos ishte mjekuar më se njëherë nga gjyshja jote e mirë, duartara teze Beta. Pastaj vinin kujtimet nga brezi i prindërve tanë, pa dallim, i të gjithë atyre që arrite të kapësh, në rrugëtimin e tyre drejt pafundësisë. Dhe këto janë shumë,

Dy fjalë për **Nehat Dacin**, mikun tonë të hershëm dhe të vyer



shumë, thuajse të gjithë përfaqësuesit e gjeneratës së vjetër. Historitë dhe trimëritë e tyre, tashmë pjesë e historisë së Grevës, do të kishin mbetur krejt të panjohura, pa punën tënde profesionale dhe skrupuloze. Janë histori lufrash dhe qëndrese për të mbrojtur truallin e të parëve dhe identitetin tonë historiko-kulturor.

Përveç këtyre, ti, si një shkencëtar i vërtetë, shfrytëzove arkivat dhe burimet historike dhe gjithë literaturën e nevojshme për një botim të tillë akademik! Një libër i shkruar me të gjitha kriteret akademike, me aparatin shkencor, fusnotat, bibliografinë, fjalorthin e termave etj, një botim për të cilin, çdo institucion shkencor, do të ishte i nderuar të të vlerësonte me më shumë se një gradë shkencore! Ti i shkruajtë të gjitha këto dhe shumë e shumë të tjera, pa menduar për tituj e grada, dhe botimin e librit e konsiderojë si një mision të shenjtë. Ashtu si e konsiderojë të shenjtë arsimin, ndriçimin e mendjes dhe edukimin shkencor dhe patriotik të brezave të rinj.

E shkruajtë dhe e botove librin, e plotësive misionin dhe ike! Një ikje e beftë dhe e papritur për të gjithë ne! Edhe pse Ti, në të vërtetë, na kishe lajmëruar me librin tënd, na kishe folur me gjuhën qiellore...

Dhe ashtu në heshtje, pasi kishe pirë kafën e fundit me shokun tënd të jetës, me Zanën fisnike, në mesditën e 21 korrikut, pa i thënë askujt, u ngjite në qiellin e yjeve të ndritshëm, për t'i dhënë Grevës më shumë dritë...

Dritë që buron nga vetë jeta jote e ndershme dhe pasionante si dhe nga libri yt që i bën nder Grevës, nga mesazhet që përcjell në ardhmëri... Dhe ike! Ike duke lënë të pikëlluar familjen dhe gjithë të dashurit! Ike kur kishe shumë punë të tjera të rëndësishme në duar!

E shkruajtë dhe e botove librin, e plotësive misionin dhe ike! Një ikje e beftë dhe e papritur për të gjithë ne! Edhe pse Ti, në të vërtetë, na kishe lajmëruar me librin tënd, na kishe folur me gjuhën qiellore... Dhe ashtu në heshtje, pasi kishe pirë kafën e fundit me shokun tënd të jetës, me Zanën fisnike, në mesditën e 21 korrikut, pa i thënë askujt, u ngjite në qiellin e yjeve të ndritshëm, për t'i dhënë Grevës më shumë dritë...



Do të ndjejmë përjetësisht mungesën tënde, miku ynë i hershëm dhe i vyer, që ike kaq papritur n'amshim! Dhe Ti, sikur ta parandjeje këtë ikje të shpejtë e të parakohshme, shkruajtë testamentin tënd për Grevën, dashurinë tënde të përjetshme. Për të na dhënë një mesazh lamtumire, jo vetëm ne shokëve të tu, që të deshëm shumë, por të gjithë banorëve të Grevës, të gjithë nxënësve të tu të shumë gjeneratave, të gjithë miqve e bashkëpunëtorëve të shumtë.

Dy ditë para këtij largimi, Dori ishte kthyer nga Kanadaja, ndërsa Klodi mezi priste që të mblidheshit në shtëpi të gjithë bashkë! Si një familje e plotësuar dhe e lumtur! Lumturi që ishte shtuar shumëfish nga ardhja në jetë e fëmijëve të Dorit, Endit dhe Mishelës, drita e syve të tu, Nehat! Të gjithë prisnin me ankth datën 29 korrik, analizën e coronares, dhe pastaj të festonin të gëzuar, të gjithë bashkë! Por nuk kishte qenë e thënë! Natën e fundit të jetës tënde në këtë botë të rrejshme, në mbrëmjen e 20 korrikut, kur kishe folur të telefon me vëllain në Peshkopi, Hamzain, për të parën dhe të fundit herë, i kishe thënë se "nuk ndjeheshe mirë!".

Më kot mundoheshim ne, shokët e tu, të të bindim, se duhet të bënim një promovim të këtij libri të mrekullueshëm. Nuk ia dolëm! Sepse Ti nuk doje tamtame dhe publicitet, edhe pse ato i meritoje më shumë se shumë e shumë të tjerë.

Do të na ndjejmë përjetësisht mungesën tënde, miku ynë i hershëm dhe i vyer, që ike kaq papritur n'amshim! Dhe Ti, sikur ta parandjeje këtë ikje të shpejtë e të parakohshme, shkruajtë testamentin tënd për Grevën, dashurinë tënde të përjetshme. Për të na dhënë një mesazh lamtumire, jo vetëm ne shokëve të tu, që të deshëm shumë, por të gjithë banorëve të Grevës, të gjithë nxënësve të tu të shumë gjeneratave, të gjithë miqve e bashkëpunëtorëve të shumtë. Ashtu si shkruante i madhi Dritëro, "dhe kur të jesh mërëzitur shumë, në raft të librave kërkomë, aty i fshehur do të jem unë, në ndonjë fjalë a ndonjë shkronjë". Dhe libri "GREVA E DIBRËS" me autor NEHAT DACI, gjendet sot si një testament në bibliotekat e shumë banorëve të Grevës, me banim në Grevë, Peshkopi, Tiranë, Durrës, Elbasan etj si dhe atyre në SHBA, Britani, Francë, Itali, Gjermani, Suedi, Danimarkë, Finlandë etj. Kudo ku ka familje nga Grevë.

Ndrëttë kujtimi yt brez pas brezi, vëllau dhe miku ynë i shtrenjtë NEHAT DACI!

Allahu xh.sh. të shpërbleftë me xhenetin Firdeus për gjithë dashurinë e fortë dhe përkushtimin tënd të pafund për njerëzit dhe vendlindjen!

Adem Bunguri, Rakip Dancë, Petrit Spahiu, Zabit Lleshi, Esat Ruka, Ismet Abdiu, Shqipërisë, Fejzullah Gjabri, Ahmet Çausi, Luan Kaba, Meleq Kaba, Esat Bunguri, Mevlud Buci, Reshat Kola, Elmas Lala, Demir Kica, Ymer Saraçi, Baftiar Çerra, Xhafer Shehu, Shahin Leka, Ramazan Kalia, Agim Prençi, Shahin Lazri, Idriz Bulku, Afrim Kurtaga, Lavdrim Shehu, Bujar Karoshi.

Nga SHAQIR SKARRA

Më fal miku im Nehat, që kafën e mëngjesit të datës 21 korrik nuk e pëmë bashkë! Unë të pashë nga larg që po vije drejt lokalit. Ishe me gjithë gruan (Zanën). Ecje ngadalë, me atë ecjen karakteristike tënden si gjithmonë. Ora ishte 10 para dite, piku i vapës dhe ti me një kapele në kokë as që doje të ia dije për vapën përvëluese të korrikut. Ishe i lumtur dhe lumturia juaj dukej në sy. Sapo kishe përfunduar analizat dhe kishe vendosur që kafën këtë mëngjes ta pije me gruan.

U takuam rastësisht bashkë dhe më ftove sinqerisht, ashtu siç dije të ftoje ti gjithmonë, me fisnikëri dhe bujari por unë nuk ndalova të pija kafën me ty. Kisha lënë një tjetër takim por më shumë doja që të mos ta prishja këtë lumturi, këtë gëzim që kishe të cilin e shprehje në mimikën e fytyrës. E ku ta dija unë se pikërisht kjo do të ishte kafa e fundit që do të pinim bashkë? Eh sikur ta kisha ditur!

Ndaj sot, edhe pse kanë kaluar më shumë se dhjetë ditë, mua ende më rëndon pesha e gabimit që bëra. Tek po hedh këto pak radhë për ty, miku im Nehat, lotët më tradhëtojnë e pesha e gabimit që bëra atë ditë, që nuk qëndrova me ty ende më rëndon mbi supë. Edhe po të qëndroja, nuk do ta besoja kurrësi se do të ishte kafa e fundit që po pinim bashkë. E pinim kafën çdo ditë në Laprakë, qëndronim me orë të tëra duke biseduar dhe as i ndienim orët që kalonin ashtu duke qëndruar të dy bashkë.

Atë ditë korriku si për çudi dhe inat të fatit nuk qëndruam bashkë. Kishe për të bërë koronaren më datën 29, por ja që vdekja tinzare nuk të priti më gjatë. Ajo kishte qenë fare pranë atë ditë të 21 korrikut, dhe ti miku im ndjeheshe pak i lodhur por i lumtur se po i jepje një kafe gruas. Ti ishe dhe mbete një familjarë i mirë, dilje shpesh me gruan dhe me vajzën për kafe.

Atë ditë të fundit të jetës tënde siç duket kërkove të rrije vetëm me gruan, ndaj dhe unë nuk ndalova. Tre ditë më parë ishe në Grevë, u çmalle me vendlindjen, me vëllanë e njerëzit e tu. Pas tre ditësh që u ktheve nga Greva dolëm dhe bashkë për kafe, dolëm vetëm me Ademin dhe Fejzën. Siç duket zemra ta ndiente e kërkoje të çmalleshe me të gjithë, se të gjithë i doje. I doje vërtet njerzit miku im Nehat, i doje dhe respektoje shumë të gjithë. Nuk dije të flisje e të shajë njeri se njerëzit për ty ishin të gjithë të mirë, nuk dije të kishe mllafe e të mbaje inate, jo, këto nuk ishin në natyrën tuaj.

Jo vetëm unë por jemi shumë që kur ti ike në parajsë, ne miqve të tu na mungon prania juaj, na mungon buzëqeshja, çiltërsia, mënyra e komunikimit, sinqeriteti.

Tek ti miku im ishin gërshtuar mjaft bukur të gjitha vrytytet më të bukura njerzore.

Kur dal vetëm në mëngjes në Laprakë, hedh shpeshherë sytë nga rruga, më duket sikur do vish, sikur të kam pranë dhe e paskam vështirë miku im, e paskam mjaft vështirë. prania jote si imazh është gjithmonë pranë nesh, kudo, në rrugë e kafene.

Afro dy muaj të ndanin nga përvjetori i lindjes, por vdekja tinzare nuk të priti ta festoje këtë përvjetor me familjen, me gruan, me djalin, me vajzën, me nipin dhe mbesën që ti i deshe fort. Jo, nuk ishte e thënë ta festoje edhe këtë përvjetor pa zhurmë e salltanete se i kishe merak shumë dum-dumet kur bëheshin në ditëlindje.

Linde më 23 shtator të vitit 1955 në Grevën e bukur të Dibrës, për të cilën ti miku im Nehat ishe i lidhur shumë, ishe i dashuruar me vendlindjen. Greva ishte dhe mbeti dashuria e madhe e jetës tënde. Për Grevën kohët e fundit botove dhe librin historik “Greva e Dibrës”, një libër ky mjaft voluminoz dhe shumë i arrirë. Kështu që ia dhe një mjet identifikimi vendlindjes tënde të dashur. Çdo rrjesht, fjali, fjalë, paragraf e faqe e këtij libri është

Kafja e fundit



shkruar me pasion e skrupulozitet shkencor. Në të gjen histori, gjeografi, filozofi, letërsi, etnografi, folklor dhe një mori dokumentash të pa ndriçuar ma parë dhe të pa trajtuara deri më sot, me përkushtimin e një mësuesi, kimisti, biologu e pse jo shkencëtari.

Me mjaft art e ke përshkruar relievën e natyrën e bukur të Grevës, lartësitë dhe pjerësitë, malet e bjeshkët, tokat dhe burimet, florën dhe faunën. Me një gjuhë mjaft të pastër e plot metafora dhe me mjaft ëmbëlsi të fut në botën e emocioneve e cila të ndjek nga rrjeshti në rrjesht, nga faqja në faqe deri në fund të librit.

Dhe nëse diku tjerr histori, nuk e bën aspak për nostalgji e as për të të shuar kureshtjen por për të treguar e mësuar se si e qysh e pse, është falur jeta nga banorët e Grevës pa hezitim kur atdheu ka qenë në rrezik. Për të thënë atë që dihet pak, apo aspak. për të nderuar dëshmorët, ata që dhanë jetën për këtë liri që gëzojmë ne sot.

Me modestinë tuaj na thua se ky libër është jo vetëm një vështrim i shkurtër gjeografik-historik por edhe etno-kulturor e etnografik. Në fakt është një libër i një lloji krejt të veçantë i cili do të shërbejë edhe si model nga shumë njerëz të penës. Siç duket është vërtet një libër i rrallë, i shkruar me mjaft kulturë, i cili lartëson dhe hijeshon krejt botën e brendëshme, si ideoartistike ashtu edhe psikologjike. Është një enciklopedi, që të ndriçon, lartëson, edukon e të pasuron mendjen e shpirtin dhe të zbukuron bibliotekën tënde.

Miku im Nehat! mbetesh objektiv si në përshkrimin bukur, por edhe në vlerësimin e plotë të figurave të ndryshme historike të Grevës. Nuk përpiqesh për të na dhënë me ca penelata bardh e zi, por ashtu në fakt siç kanë qenë në jetë.

Një analizë të përsosur dhe me mjaft fakte dhe argumenta shkencor, duke u bazuar në burime historike të botuara, autori analizon të gjitha luftrat kundër pushtuesve të huaj, të gjithë pjesmarrësit në këto lufta, të gjithë të rënë, humbjet, djegjet dhe masakrat e pushtuesve të huaj mbi popullsinë e Grevës.

Shkollën fillore e tetëvjeçare i përfundove në vendlindje. Shkollën e mesme në qytetin e Peshkopisë duke e bërë rrugën çdo ditë në këmbë nga Greva deri në qytet. Në vitet 1973-1976 përfundove me rezultate të larta Institutin pedagogjik Shkodër, dega bio-kimi.

Në fakt nuk e mendove se pas përfundimit të shkollës do të përfundojë në fshatin e thellë të Zall-Reçit në fillim si mësues në shkollën e mesme dhe pastaj drejtor po në këtë shkollë.

Ti nuk e dija se ku binte Zall-Reçi, nuk kishe qenë më parë, por duke punuar e drejtuar në këtë shkollë e fshat të largët të Dibrës, shpejt u familjarizove duke u bërë njeri më i respektuar nga vendasit, ndër të gjithë kuadrot jabanxhinj që ishin në ato vite në Reç. Në këtë shkollë punove edhe me gruan tuaj, Zanën. Të dy bashkë punuat e jetuat në këtë fshat më në skaj të Dibrës.

U largove nga Reçi me përshtypjet më të mira duke i mbajtur deri vonë lidhjet e tua të ngushta me prindër por dhe nxënës e ish nxënës. Nga Reçi erdhe në Melan, në Grevë, në Peshkopi dhe kudo punove me pasion e dashuri për profesionin e bukur të mësuesit por edhe si drejtues. Vetëm pesë vite punove si mësues e 23 vite me radhë drejtor në shkollë të ndryshme të Dibrës. Ti dhe modelin më të bukur e të qënit drejtues e menaxher i mirë në një institucion arsimor. Jo vetëm kaq por modelin tënd e dhe edhe në fushën e mësimdhënjes.

Për dy vite punove pranë Këshillit të Qarkut Dibrë. Për 4 vite (2006-2010) ishe drejtues i Entit Social Kulturor të Ushtrisë dhe i Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë Tiranë, institucione këto në mvarësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në vitet 2010-2014 ke punuar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Durrës.

Ke kryer një sërë kualifikimesh brenda dhe jashtë Shqipërisë në fushën e arsimit, pushtetit lokal dhe mjedisit. Për dy vite drejtove dhe botove “Gazetën e Qarkut Dibrë”, organ i Këshillit të Qarkut Dibrë (2004-2006).

Ke botuar mjaft shkrime e artikuj të ndryshëm në shtypin lokal, në gazetën e atëhershme “ushtima e maleve”. Që në ato vite u njohëm bashkë por njohja ma e madhe e jona vazhdojë pas viteve 2000 për të mos u shpëputur kurrë, veçse na ndau data 21 korrik 2022 por fizikisht se shpirtërisht nuk ka datë që na ndan ne. Do mbetesh në kujtesën time ai Nehat që ke qenë; i dashur, i respektuar, i kulturuar.

Ike shpejt Nehat, ike shpejt nga kjo botë e rrejshme. Ike pa i mbushur shtatëdhjetë vite, pa e festuar shtatëdhjetë vjetorin e ditëlindjes tuaj.

I lumtur është ai njeri që gjatë gjithë jetës së tij bën më të mirën e mundëshme dhe mbetet i nderuar e i kërkuar nga ata që e njohën.

Ti, miku im Nehat për aq sa bërë je një i tillë, intelektual emër mirë. Dhe për këtë nuk kishe nevojë për vlerësime e nderime nga qeveritë, nga institucionet.

Ty miku im Nehat ato ti kanë dhënë mijra e mijra nxënës që sot në fakt punojnë e drejtojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, brenda e jashtë vendit, dhe vlerësime të tilla nuk janë pak të cilët gjithmonë të thoshin “Mësues Nehati, dhe kështu do të vazhdojnë përsëri.

Dituria është pasuri që fitohet me përvojë, por edhe kur kërkesat ndaj vetes qëndrojnë të ingranuara, në lidhje të pa ndërprera me përparimin e teknikës dhe të shkencës në shkallë botërore. Dhe ti kurrë nuk u mjaftove me ato dije që more në shkollë por lexoje shumë, lexoje vazhdimisht libra të ndryshëm artistik, studime e enciklopedi.

Të vdesësh fare pa prituri, befasisht në një moshë të bukur ku ende prisnin të gjithë nga ti edhe më shumë, ndarja jote nga kjo botë gënjeshitare na la pa fjalë të gjithëve. Ashtu si për vetë moshën tënde që premtonte jetë e jeta, e them sot edhe nga dhimbja me pikëllim të thellë se me ty u tregua shumë e pa drejtë, shumë tinzare se të mori shpejt nga kjo botë krejt e rrejshme.

Ajo dita e 21 korrikut kur nga zëri i telefonit dëgjova Dorin që fliste me ngashërime e

zë të dridhur, dhe kur mora vesh për vdekjen tënde ishte e vështirë për mua. Më merrje shpesh në telefon e numri yt ishte bërë si një ndër numrat më të rëndësishëm të mi. Atë pasdite kur pashë se në ekranin tim doli emri yt u shtanga, u tremba dhe ende pa mbaruar bisedën Dori, telefoni im ra në tokë. E si mund ta besoja atë gjëmë që dëgjova nëpërmjet telefonit. Ne dy -tre orë kishte që ishim takuar bashkë. Po tani atë zile dhe atë emër të mirë e të dashur për mua në telefonin tim nuk do ta dëgjoj më, ndaj e kam të vështirë sot të shkruaj, ti them dy fjalë zemre, shpirti e malli Nehat!

Në këto momente që po mundohem të shkruaj dëshiroj të nxjerr në dritë jetën e një njeriu me kontribut të gjatë, në të mirë të vendit, të zhvillimit dhe të emancipimit të shoqërisë, të dibranit fisnik, bujar dhe intelektual i kompletuar Nehat Daci.

Karakter i njeriut formohet e forcohet në përpjekje për të arritur gjithmonë më të mirën, duke u kacafytur shpesh me të keqen e cila ka për detyrë “të zërë rrugën”, të të mundojë e të të lodhë shumë që ti të dorzohesh, por ti Nehat nuk ishe i tillë, nuk u dorzove kurrë nga rruga e minuar ku shkelle se e hidhje hapin me kujdes e maturi.

Miku im Nehat! E njohe mirë jetën, me uljet e ngritjet e saj, duke e filluar atë nga hiçi për të arritur më vonë shumë në formimin tënd, do ti falnin, për të ndërmarrë më pas veprime që në fund të fundit do të ishin si një shtërngatë për ti dhënë vetë jetës drejtimin e duhur.

Gjërat më të bukura apo ato që të dëshpërojnë në jetë nuk mund të dëgjohen, të shihen, as të preken. Ato vetëm mund të ndjehen. Brezi yt Nehat dhe i shokëve të tu ishte i vështirë, përjetuam kohra shumë të vështira por që në fund të fundit ato që dëshën të mbesin njerëz përsëri njerëz mbetën, ashtu siç mbete dhe ti Nehat.

Karakter në gjëra të vogla apo mëdha do të thotë të marrësh përsipër ato gjëra që ti ndjehesh i zoti ti bësh.

Je i vrytytshëm kur ndërmarjen e guximshme e bën vetiu e jo kur ta kërkojnë të tjerët. Në jetën me plot ngjarje të lakmueshme të Nehat Dacit, gjen njeriun e bindur për të kryer veprime të guximshme, pa e ditur se ai ato i bën nën trysinë e ndërgjegjes së pastër dhe të njeriut idealist.

Kam parasysh këtu veprimtari të tij, të cilat kur i sjellim e i ballafaqojmë me atë çka bëjmë ne të sotmit, për vendin, për flamurin të cilit i këndojmë nga mëngjesi në darkë e nga darka në mëngjes, të duket sikur atdheu është në dorë të intrigantëve të cilët të drejtë dhe idealistët i marrin për naiv e budallenj.

Jeta ka provuar se ai që shpërfill mundimin, vuajtjet, përgjithësisht sakrificën për të arritur diçka të vrytytshme, në fund ndjehet i lumtur dhe i plotësuar në shpirt e në ndërgjegje. Nehat Daci i ngjan pa dyshim i ngjan, është “binjak” me çdo njeri që i ngjit shkallët e karrierës me urrezi, duke e konsideruar pozicionin apo një detyrë të lartë qoftë partie, qoftë administrative si një premtim të mundimit për të arritur deri aty.

Janë vetë sfidat ata që e bëjnë jetën interesante e këto sfida nuk munguan as në jetën tënde Nehat. Ti nuk ishe vetëm një ëndërrimtar për ti kryer punët ashtu siç duhej. Kishe edhe bindjen se brenda vetes fshihej forcë, durim dhe pasion për të gjetur fjalën me të gjithë.

Sot imazhin e mirë të babait, fëmijët e tu nuk do ta shlyejnë kurrë nga kujtesa. Vdekja jote është thjeshtë vdekje fizike se shpirtërisht ti nuk ke vdekur, do të rrosh gjithmonë në kujtesën tonë.

BOTIME TË REJA

XHA FER MARTINI

100

PERSONALITETET E GOMARIT TË MADH

Roman

BOTIMET M&B

XHA FER MARTINI

100 personalitetet e gomarit të madh

Roman

Shtëpia botuese: M&B

Numri i faqeve 104

ISBN 978-9928-353-93-1

Çmimi: 600 lekë

Një roman satirik mbi shoqërinë e ditëve të sotme. Përmes karrierës në ngjitje të një gomari këmbëngatërruar, - nga mësues në një shkollë të provincës deri në gradimin si akademik, - pasqyrohet një histori shqiptare tranzicioni, që më shumë se të bën të qeshësh, të bën të mendohesh dhe të reflektosh.

Kronikën për promovimin zyrtar të librit, që ishte ai i sallës kryesore, do ta mësoni më vonë nga shkrimi përmbledhës në formë eseje filozofike që bëri Kau Zrrak në gazetën Ushtima e Zabeleve, kurse grupin e dytë që hyri në sallën tjetër, po e ndjekim nga afër, se ngjarjet rrodhën shumë më shpejt se ç'mendohej dhe me një zgjidhje të habitshme që erdhi nga ai që nuk pritej. Këtu nuk kishte as presidium, as referat, as diskutime. Dikush në këmbë, dikush ulur në një kolltuk, shanin me të madhe Gomarin e Madh dhe e ngrinin zërin në kupë të qiellit. Me këtë mënyrë sjelljeje komprometohej qëllimi dhe pjesëmarrësit kryesorë, ata që ishin tamam shkencëtarë dhe që në të vërtetë nuk e kuptonin përse kishin ardhur këtu. Ata vetëm rrinin si të hutuar. Mbështetësit e tyre bërtisnin dhe grindeshin, madje Derrkuci i Vogël dhe Ujku Qimendritur, që njiheshin për gjaknxehtësi, bënë thirrje që të shkonin në sallën ku ishte mbledhur grupi "zyrtar", t'ua prishnin mbledhjen dhe t'i shpërndanin me forcë. Nuk dihej si do të shkonte kjo punë, po të mos kishte shkuar Bufi i Kënetës të tryeza ballore dhe, si kapi mikrofonin, tha do fjalë që nuk do të harrohen kurrë:

- Mua më ka bërë nder Gomari i Madh që nuk më ka futur në atë palo librin e tij. Me të thënë këto fjalë, doli jashtë. Mbas tij dolën tërë personalitetet e larta shkencore e politike. Dolën edhe mbështetësit e tyre. Nuk u zhvillua as mbledhja tjetër për arsyen e thjeshtë se askush nuk e kishte lexuar librin e Gomarit të Madh...

(Fragment nga romani)

Librin mund ta porosisni online:

Email: mbbotime@gmail.com

Cel (Whatsapp) 068 65 08 441

BIGmarket

një epokë e re dashurie ndaj jush po nis tani

GJITHMONË ME OFERTA...

PESHKOPI MAQELLARË

NJOFTIME

- Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN janë pagesat PËRMES BANKËS. Për të dhënat bankare shihni njoftimin mw poshtv ose nw faqen 2.
- Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA tjetër apo rrjete sociale NUK KA PËRPARËSI botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!
- KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarin. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.
- Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

Rruga Arbërit

Aty ku fjalët nuk i merr era!

KRIJU AKTUALITET KULTURE TURIZEM SPORT DIASPORA NJOFTIME ARKIVA PËRÇORRINDHIMO

ARTIKUJT E FUNDIT

- Grupe shqiptare që mbledhen krom përballen me shfrytëzimin nga Bjori Sanonuka | BIRN
- Braktitja e Dibrës nuk duhet të rrezikojë
- Qeveria duhet të tregojnë e përsulur dhe e pengësojnë ndaj kërkesave të kampionit
- Nga Bujar Karoshi
- Raftingu në Dri, një risi e turizmit në Dibrë gjatë surpriza dhe adrenalinë

Nga raftingu në Dri, te ngjitja në majën e Korabit, mundësitë e zhvillimit të turizmit

Me daljen e ngathtë nga pandemia shpeshat për një rrugë të turizmit në vend po rriten. Dhe kjo po merr edhe shpatull për përgatitjen e guidave turistike dhe shërbimeve në turizëm. Më 24 maj 2021 në Parku Kombëtar Shërbime, lokalitetë të tjerë i pranojnë përvojat e tyre.

Qershor 2021

www.rrugaearbërit.com

Botim i pavarur

E vetmja e printuar për rajonin e Dibrës

Pajtohu dhe qëndro me gazetën Rrugë e Arbërit më pranë #Dibërit

rrugaearbërit f Rrugë e Arbërit Edit

Rruga e Arbërit

@gazeteeajonitDibres - Local business

Skano →

www.rrugaearbërit.com

Na ndiqni online, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: info@rrugaearbërit.com

Informacioni për versionin e printuar: rrugaearbërit@gmail.com

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin "NDIHMO EDHE TI" që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëëbsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rrugë e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rrugë e Arbërit", duke skanuar QR Code ose përmes lidhjes: <https://tinyurl.com/lcc3e2f>

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me 1000 lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK. PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE... BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.

Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. SWIFT code: SGSBALTX. IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640